monumentet



DO NOT COPY

20, 1980

DO NOT COPY

Kopertina e parë: Ujësjellësi dhe kalaja e Gjirokastrës, sipas një gravure të shek. XIX.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

20, 1980

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

ARTIKUJ

Gjerak KARAISKAJ

– Muret rrethuese të Butrintit në mesjetë shek. VIII-XV 5

Fatos IARTARI

– Elemente të rinj në Kalanë e Durrësit të shek. V-VI të erës sonë 37

Aleksandër MEKSI – Pirro THOMO

– Arkitektura pasbizantine në Shqipëri (Kishat me strukturë në formë kryqi me kupolë) 45

Valter SHTYLLA

– Ujësjellësi i vjetër i Kalasë së Gjirokastrës 69

Emin RIZA

– Banesa qytetare shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, deri rreth çerekut të parë të shek. XX 83

Fatbardha SHKUPI

– Tipari popullor i zbukurimores së banesës shkodrane 105

Fabian MIRAJ

– Për një interpretim të ri të monogrameve në tullat e murit rrethues të Durrësit 127

– Kronikë e punimeve restauruese për vitin 1979 137

Lazër PAPAJANI

– Pasqyrë bibliografike e serisë «Monumentet» Nr. 11-20 (1976-1980). 143

DO NOT COPY

TABLES DE MATIERES

Pages

ARTICLES

Gjerak KARAISKAJ

– Les murs d'enceinte de Butrint an Moyen âge (VIIIe–XVe s) 5

Fatos TARTARI

– Elements nouveaux dans la forteresse de Durrës du V-VI s 37

Aleksandër MEKSI – Pirro THOMO

– L'architecture postbyzantine en Albanie (Eglises à structure en forme de croix avec coupole) 45

Valter SHTYLLA

– L'ancien aqueduc de la citadelle de Gjirokastër 69

Emin RIZA

– L'habitation urbaine albanaise au cours de la seconde moitié du XIXe siècle, jusqu'au premier quart du XXe siècle environ 83

Fatbardha SHKUPI

– Le trait populaire de la décoration de l'habitation de Shkodër 105

Fabian MIRAJ

– Pour une interpretation nouvelle des monogrammes sur les tuils du mur d'enceinte de Durrës 127

– Chronique des travaux de restauration de l'année 1979 137

Lazër PAPAJANI

– Index bibliographique du «Monumentet» 11-20 (1976-1980) 143

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

DO NOT COPY

MURET RRETHUESE TË BUTRINTIT NË MESJETË shek. VIII–XV

Në këtë punim nuk përfshihen gjithë ndërtimet mbrojtëse mesjetare të Butrintit, por vetëm muret rrethuese të tij. Ndërtimet e tjera mbrojtëse, pranë kanalit të Vivarit, të cilat patën jo më pak rëndësi për periudha dhe rrethana të tjera historike, janë trajtuar shkurt në një kumtesë të mbajtur në vitin 1976[1]. Trajtimi i veçantë i mureve rrethuese mesjetare të qytetit e kufizon dhe në kohë shqyrtimin e problemit të fortifikimeve të tij, pasi pas shek. XV qyteti e humbet rëndësinë si një qendër e mirfilltë e populluar dhe ruan akoma dhe për disa kohë vlerën strategjike. Për pasojë nuk takohen edhe gjurmë ndërtimesh mbrojtëse pas kësaj periudhe në kufijtë e shtrirjes së qytetit, me përjashtim të një kulle të veçuar e cila i përket një kohe mjaft më të vonë dhe nuk lidhet me muret rrethuese, nga ana tjetër ajo nxjerr në pah se vetë teritori ku shtrihej dikur qyteti mesjetar ishte një zonë e pa sigurtë[2].

Me fortifikimet e Butrintit janë marrë mjaft studjues, të huaj dhe shqiptarë si Ugolini, Mustili, Hamondi, Budina, N. Ceka, etj.[3], të cilët nuk u kanë kushtuar vëmendje fortifikimeve mesjetare me gjithë shtrirjen e madhe të tyre por janë marrë kryesisht me ato të periudhës antike. Ndërsa Ugolini i cili qëndroi një kohë të gjatë në Butrint i shmanget këtij problemi, duke u shprehur se: «Ndërmjet gjithë periudhave të historisë së Butrintit, ajo mesjetare është padyshim më e errëta... muret e rrethimit të epokës mesjetare.... nuk na ofrojnë të dhëna arkeologjike por vetëm se sa të shumta kanë qënë rindërtimet e tyre»[4]. Nga ana tjetër në planimetritë e dhëna prej tij, shënohen apriori si të periudhës venecjane shumica e fortifikimeve të Butrintit, si muri rrethues i jashtëm i qytetit ashtu dhe kalaja përballë tij në bregun jugor të kanalit të Vivarit[5] dhe po ky autor nuk mundi të dallojë midis «teknikave murale shumë të ndryshme», fazën e kohës së pushtimit romak për të cilën ishte po aq i interesuar sa dhe për ndërtimet venecjane[6]. Duke parë se qyteti i Butrintit nuk e humbi rëndësinë sidomos si një qendër e fortifikuar edhe gjatë gjithë mesjetës, e gjetëm të dobishme dhe të nevojshme të analizojmë me kujdes ato trakte të mureve mbrojtës që na kanë mbetur nga mesjeta. Muret mbrojtëse mesjetare të Butrintit deri në shek. XV tregojnë jo vetëm se sa të shumta ishin këto ndërtime, por edhe kujdesin e veçantë e të përhershëm që është treguar për mbrojtjen e qytetit në çdo kohë. Gjithashtu prej tyre del se në cilat periudha historike këto ndërtime ishin më in-

---

1) Gj. Karaiskaj, **Fortifikimet mesjetare pranë kanalit të Vivarit** në Butrint dhe restaurimi i tyre, Monumentet 11, 1976. 147-153.

2) Po aty.

3) L. M. Ugolini, **L'acropoli di Butrinto,** Roma 1942. D. Mustili, **Relazione preliminare sugli scavi archeologici in Albania** (1937-1940) «Rendiconti della classe di scienze morali e storiche» VI, II, 1941 N.G.L. Hammond, **Epirus,** Oxford 1964, Dh. Budina, **Harta arkeologjike e bregdetit Jon dhe e pellgut të Delvinës,** «Iliria» I, 1971, N. Ceka, **Fortifikimi antik i Butrintit dhe i teritorit të Prasaibëve** «Monumentet», 12, 1976.

4) L. M. Ugolini, **Butrinto, Il mito d'Enea, Gli scavi,** Roma 1937, f. 95.

5) **Po aty,** f. 171.

6) Shih për këtë Gj. Karaiskaj, **Fortifikimet në Shqipëri gjatë periudhës së sundimit romak,** Monumentet 17, 1979.

tensive, gjë që nuk mund të kuptohet nga të dhënat e pakta burimore të cilat në ndonjë rast mund të krijojnë edhe ide të gabuara.

* * *

Që nga përmendjet e fundit të Butrintit në antikitetin e vonë si qytet dhe qendër Peshkopate në vitet 458, 519 dhe 535 e deri nga fundi i shek. IX kur ai përsëri del si i tillë, nuk kemi të dhëna historike. Që nga fillimi i shek. X e deri në 1014, vit që shënoi fitoren përfundimtare të Bizantit kundër bullgarëve, Butrinti ka qënë vazhdimisht nën kërcënimin e këtyre të fundit të udhëhequr nga Car Simeoni, Pjetri dhe më në fund Samuili[7].

Në vitin 1020 Butrinti përmendet si qendër peshkopate bashkë me Cërnikun, Himarën, Durrësin dhe Adrianopojën[8]. Pas një periudhe krize dhe kryengritjesh për Perandorinë Bizantine e cila filloi që para mesit të shekullit XI, nga fundi i këtij shekulli perandoria kërcënohej nga sulmet e Normandëve. Në maj të vitit 1081 ushtritë normande të kryesuara nga i biri i Guiskardit, Boemundi zbarkuan në gjirin e Vlorës, pushtuan Vlorën, Kaninën, Jerikon dhe arritën në Butrint ku u bashkuan me Guiskardin. Për këtë rast nga «Kënga e Rolandit» janë nxjerrë të dhëna që vërtetojnë pjesmarrjen në luftë kundër normandëve të disa reparteve nga Butrinti[9]. Guiskardi e kish marë Butrintin me sulm dhe kishte vendosur atje kampin e tij. Pranë Butrintit u zhvillua një betejë detare midis normandëve dhe venecjanëve ku të parët u mundën[10]. Akoma në shek. XII, në vitin 1185 udhëtari arab Al-Idrizi, e përmend Butrintin si një qendër tregëtare të popullur.

Pas kryqëzatës së IV Butrinti u përfshi në Dhespotatin e Epirit, i cili me gjithë shtrirjen e tij të gjerë në jug ishte një shtet që kishte më tepër një karakter shqiptar se sa grek. Në vitin 1258, Butrinti pushtohet nga mbreti Siqelisë, Manfred Hohenshtaufen. Ky pushtim nuk u kundërshtua nga despoti i Epirit Mihal II, i cili i kishte dhënë Manfredit për grua të bijën e tij Helena dhe si prikë, përveç Butrintit e Korfuzit edhe disa kështjella e vende të tjera si Durrësin, Vlorën, Kaninën, Beratin, etj. Manfredi ja le për ta qeverisur, Butrintin bashkë me kështjella e vende të tjera admiralit Filip Hinardit. Ky i fundit pas vdekjes së Manfredit, martohet me Helenën dhe vritet më 1266 nga Mihali II, i cili kërkonte ta kishte përsëri në dorë pajën e të bijës. Por kësaj rradhe Butrinti ra në dorë të perandorit të Bizantit Mihal VIII Paleologu i cili në vitin 1274 vendos aty një garnizon të fortë ushtarak[11]. Në vitin 1279 Butrinti u pushtua nga mbreti i Napolit Karli I Anzhu, pastaj nga Filipi i Tarentit dhe më 1386 zotërohet nga Venecjanët. Megjithëse si qytet Butrinti kishte filluar të binte ai ruajti vlerën strategjike duke qenë përballë Korfuzit dhe u mbajt si kështjellë. Kjo kuptohet qartë dhe nga fakti se në përpjekjet për të pushtuar Korfuzin turqit niseshin gjithnjë nga Butrinti dhe Korfuzi konsiderohej deri në shek. e XV nga venecianët si «Porta e Italisë»[12].

Këto ishin në vijat më të përgjithshme ngjarjet historike që prekën Butrintin gjatë mesjetës. Ato më kryesoret prej tyre pasqyrohen në një masë të konsiderueshme edhe në veprimtarinë ndërtuese në muret mbrojtëse të qytetit, të cilën do të përpiqemi ta vemë në dukje gjatë analizës së tyre.

* * *

Përsa i përket fortifikimeve mesjetare, Butrinti mbrohej nga një sistem i tërë ndërtimesh të tilla. Në rradhë të parë qyteti rrethohej nga një mur mbrojtës i jashtëm i cili ndiqte në pjesën më të madhe të gjatësisë së tij, bregun jugor të liqenit të Butrintit dhe atë verior të kanalit të Vivarit të cilët, përcaktonin kufijt e shtrirjes së qytetit dhe njëkohësisht një mbrojtje natyrore nga ana veriore lindore dhe jugore. Nga ana e tokës, më pak e mbrojtur nga natyra dhe ku qyteti ekspozonte vetëm 1/4 e perimetrit të tij, ndodhej një linjë e dyfishtë muresh të vendosur 15 – 20 m larg njeri tjetrit dhe të paisur me kulla. Muri i parë me gjithë kullat e tij ishte

7) **Historia e Shqipërisë** I, Tiranë 1967, 161.

8) I. Ivanov, **Bëllgarski starine iz Makedonia,** 558-559.

9) K. Luka, **Toponimia shqiptare në këngën e Rolandit, lidhur me disa ngjarje të viteve 1081-1085,** «Studime Historike» 2, 1967, 128.

10) K. Bozhori – F. Liço, **Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë shek. X-XV,** Tiranë 1975, 105.

11) C. Hopf., **Geschichte Grichenlands von Beginn des Mittelalters bis auf unsere Zeit (1821)** Leipzig 1870, 300,

12) G. M. Monti, **Corfu e le altre isole Joniche....,** Rassegna Italiana, Roma vol. LIV, fash. CCL XXVI, 320.

DO NOT COPY

më i ulët nga i dyti. Po nga perëndimi një mur i drejtë me një kullë dhe një hyrje bashkonte rrethimin e jashtëm të qytetit në anën veriore me bregun e liqenit. Gjithashtu në pjesën më të lartë të kodrës veçohej nga muret mbrojtës një teritor në formë elipsi me gjatësi 280 m dhe gjerësi mesatare 70 m, të cilin e kemi quajtur «akropoli» ashtu siç është bërë zakon të emërtohet për periudhën antike. Nga skaji juglindor i «akropolit» zbriste gjatë shpatit një mur deri tek «Porta e Liqenit» (Skea), i cili bashkohej në të majtë të saj me linjën e murit antik, ndërsa në skajin lindor të «akropolit» që është dhe vendi më dominus i krejt qytetit ishte ndërtuar një kështjellë me përmasa rreth 40 x 40 m me një kryekullë brenda saj. I gjithë ky sistem fortifikimi nuk u krijua në një periudhë të vetme. Këtë e tregojnë teknikat e ndryshme të ndërtimit që ndjekin njëra tjetrën si dhe format e përmasat e ndryshme të kullave e të mureve.

MURI RRETHUES I JASHTËM

Ana veriore e këtij muri ndiqte linjën e mureve antike, ndërsa nga jugu, lindja dhe perëndimi ai u ndërtua për herë të parë në mesjetë, duke e zgjeruar në këtë mënyrë sipërfaqen e mbrojtur të qytetit më se dy herë nga koha kur ai pati rrethimin më të plotë të kohës antike. Tani sipërfaqja e rrethuar arrinte në 16 ha, ndërsa gjatësia e përgjithshme e mureve mesjetare duke përfshirë këtu dhe ndarjet e brendshme në 2500 m.

Po ta nisim përshkrimin e fortifikimeve mesjetare të rrethimit të jashtëm nga «Porta e Liqenit» (Skea) në drejtim të perëndimit do të vërejmë se deri tek «Porta e Luanit» mbizotërojnë muret antike dhe ato të periudhës romake. Pas Portës së Luanit, deri në pikën e takimit, të murit që zbret në drejtim të liqenit vlen të përmendet nga ndërtimet mesjetare një trakt në pikën 1 (Tab. I). Muri mesjetar ngrihet direkt mbi bllоqet antike, ai është ndërtuar me gurë kave të madhësisë mesatare ku midis fugave vertikale të tyre janë vendosur horizontalisht copra tullash. E njejta teknikë konstatohet edhe në vendin e takimit të murit rrethues me atë që zbret në liqen si edhe tek kthesa që bën muri rrethues në pikën 2 (Tab. II, 2,3), vetëm se në këto të fundit janë ripërdorur bllоqe antike apo gurë me përmasa më të mëdha.

Menjëherë pas kthesës në pikën 2, një trakt muri është ndërtuar me gurë kave të vendosur në formë të çrregullt të lidhur me një llaç të fortë, por ku nuk janë përdorur tullat. Pas tij një mur me lartësi rreth 8 m është ndërtuar me gurë dhe rreshta të ndërprerë tullash të vendosura në mënyrë të çrregullt që ngjan me disa mure e kulla të rrethimit të jashtëm nga ana jugore si dhe me fazën e dytë të ndërtimit të murit që mbyll hyrjen midis kalasë dhe liqenit. Në anën e jashtëme të këtij muri është shtuar në një kohë më të vonë një ambjent i përzgjatur që ka formën planimetrike të një trapezi (pika 3, Tab. I) (Tab. III). Ambjenti ka një gjatësi prej 13,5 m dhe gjerësi 2,5 m me trashësi muresh 1,10 m, është i paisur me katër frengji dhe një nyje sanitare. Dy nga frengjitë janë të pjerrta dhe shohin nga jugperëndimi ndërsa dy të tjerat kanë në planimetri formën e një trekëndëshi dybrinjënjëshëm. Frengjitë (Tab. III, 1) përfundojnë nga jashtë me një të çarë me gjerësi 0,10 m nga brenda janë 1,05 m të gjëra dhe kanë një lartësi prej 1 m. Kthina sanitare (Tab. III, 3) ka formën e një gungoreje të thelluar në mur dhe është e paisur me një kanal të pjerrët me premje katërkëndëshe që përfundon në faqen e jashtme të murit.

Kuptohet qartë që ky ambjent ka shërbyer si fjetore dhe vend qëndrim i rojeve. Muret janë ndërtuar me gurë kave të lidhur me llaç ku janë futur në mënyrë të çrregullt mjaft copa tullash, teknikë që ngjan me periudhën e tretë të murit që lidh kalanë me liqenin.

Pas një ndërprerje prej disa metrash zbret në drejtim të Jugut një mur me gjatësi 90 m i pajisur me një kullë trekëndëshe dhe me disa kontraforte të vendosura në intervale të caktuara (Tab. IV). Nga teknika e ndërtimit duket që kemi të bëjmë me një dorë të vetme. Muri ka një gjërësi prej 1,50 m dhe në pjesën më të ruajtur ku shihen dhe gjurmët e murit të bedenave arrin lartësinë 5 m, kështu që bashkë me këto të fundit ai nuk i kalonte 7 m. Kontrafortat që përforcojnë atë nga ana e jashtëme janë me prerje katërkëndëshe dhe trekëndëshe. Të parat me gjerësi 0,80 m projektohen nga kurtinat 0,60 m ndërsa të dytat kanë një bazë prej 1,90 m dhe dalin 1,50 m. Gjatë murit në jug të kullës trekëndëshe ruhen tre frengji në lartësi 3,40 m nga toka. Frengjitë kanë seksion trekëndësh me gjërësi nga ana e brendëshme 0,85 m nga jashtë 0,10 m dhe lartësi 0,45 m. Në kurtina nuk janë përdorur breza druri, gjurmë të tyre hetojmë vetëm tek kulla (E) (Tab. I) (Tab. IV).

Kulla E (Tab. IV, 2) ka formën e një trekëndëshi të çrregullt, njera faqe më e shkurtër, bije thuajse përpendikular mbi kurtinën, ndërsa tjetra që bashkohet me kënd të gjerë me këtë të fundit ka formë të harkuar. Trashësia e mureve të kullës është 1,20 m. Nga ana e brendshme kulla përfundon me një faqe ballore të prerë drejt duke krijuar kështu në planimetri trajtën e një trapezi të çrregullt.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Si tek kurtinat ashtu edhe tek kulla janë ripërdorur shumë gurë antikë ose janë përdorur gurë me përmasa të mëdha, fugat vertikale të të cilëve janë mbushur me copra tullash të vendosura horizontalisht njera mbi tjetrën. Pjesët e sipërme të mureve janë ndërtuar me gurë më të vegjël, por duke ndjekur të njejtën teknikë.

Takohen në përgjithësi breza tullash të ndërprerë prej një rreshti, ndërsa në kurtinën që ndodhet në veri të kullës E kalon një brez i pandërprerë prej dy rreshta tullash gjatë gjithë gjatësisë së murit. Llaçi është i një cilësie të mirë me mbushës të trashë, rërë të ashpër dhe çakull.

Në drejtim të Jugut, pasi zbret pjerrësinë e butë të kodrës, gjurmët e këtij muri humbasin. Terenin e sheshtë që shtrihet para Akropolit, nga perëndimi e mbrojnë dy linja muresh, gati paralele me njera tjetrën të cilat shkojnë në drejtim të kanalit të Vivarit. Nuk mund të përcaktohet me saktësi se me cilën nga këto dy linja lidhej muri me kullën trekëndëshe. Por ka mjaft mundësi që ai të lidhej me linjën e jashtëme e cila përfundonte në bregun e djathtë të kanalit, në një kohë që ndoshta ana jugore e qytetit nuk ka qenë e fortifikuar. Në linjën e brendëshme të fortifikimit ruhet akoma një kullë drejtëkëndëshe (Tab. I, P) e cila ngjason me kullat e tjera të murit rrethues që kalon buzë kanalit të Vivarit, sidomos me kullën L. Faqja ballore e kullës P, e veshur nga bimësija ruhet në lartësi rreth 9 m. Në pjesën e sipërme dallohen gjurmët e dy frengjive, ndërsa në mure janë përdorur pak fragmente tullash të futura pa ndonjë rregull të caktuar. Po të ndjekim murin rrethues që shkon buzë kanalit të Vivarit, në fillim do të ndeshemi me një kullë të veçuar të shek. XVII-XVIII e ndërtuar në stilin venecjan. Kjo e fundit nuk ka të bëjë fare me murin rrethues të qytetit dhe është ndërtuar kur kjo pjesë e murit nuk egzistonte më. Pasi kalon kullën e veçuar rreth 50 m në drejtim të lindjes, një ndërtim i periudhës romake është përfshirë brenda trashësisë së murit rrethues.

Më tej muri rrethues bën një kthesë të fortë me kënd të drejtë në drejtim të kanalit të Vivarit, këtu ai ka një gjerësi prej 1,85 m dhe është ndërtuar me gurë dhe copra të rralla tullash. Pas kthesës gjurmët e murit humbasin për një farë largësie, pastaj takohen përsëri dhe përfundojnë me një kullë drejtëkëndëshe (L). Kulla L (Tab. X) kontrollonte murin rrethues vetëm nga ana perëndimore, pasi në anë të kundërt ajo nuk projektohet pothuajse fare nga kurtina.

Faqja ballore e kësaj kulle me dy frengji me prerje trekëndëshe, arrin një lartësi prej rreth 8 m (Tab. X, 1).

Frengjitë kanë një hapje nga brenda 0,50 m nga jashtë 0,15 m dhe një lartësi 0,65 – 0,70 m.

Muri rrethues që vjen nga lindja nuk lidhet organikisht me murin e kullës, por i mbështetet atij gjë që tregon se i përket një periudhe më të vonë. Kjo kuptohet dhe nga mënyra jo e natyrëshme e vendit të takimit.

Por edhe tek vetë kulla dallojmë dy faza ndërtimi. Në fillim ka qenë një kullë katërkëndëshe më e herëshme se muri rrethues që vjen nga lindja, mbi të cilën është ndërtuar me mure 0,60 m të trashë kulla që kemi sot e cila lidhet organikisht me vazhdimin e murit rrethues në drejtim të perëndimit, ndërsa nuk mund të përcaktohet se në ç'raport kohor qëndron ajo me murin që vjen nga lindja.

Teknika e ndërtimit të kësaj kulle ndryshon nga ajo e kullave I dhe G që do ti përshkruajmë më poshtë. Në faqet e mureve të saj janë ndërfutur në mënyrë të çrregullt shumë copra tullash, por predominojnë tullat horizontale, ka dhe nga ato që mbushin në këtë mënyrë vendosje fugat vertikale midis gurëve. Nga kjo pikpamje kulla është e ngjashme me disa rindërtime në murin jugor të akropolit si dhe me murin që zbret për tek Porta e Luanit (Skea). Pas kullës L hasim në gjurmët e një qosheje kulle (J), e cila ruhet në 5 m lartësi (Tab. V, 2). Teknika e ndërtimit të saj është e njëllojtë me atë të kullës G. Rreth 40 m pas kullës J, muri rrethues bën përsëri një kthesë këndrejtë, në drejtim të kanalit (Tab. I, 7) ku një ndërtim më i hershëm bizantin është përfshirë brenda tij. Pas kthesës muri mer drejtimin nga veriu duke ndjekur gjithnjë buzën e kanalit. Rreth 80 m në veri të kthesës ruhet në gjendje të mirë një kullë drejtkëndëshe (G). Kulla G (Tab. VIII, Tab. IX) është dy katëshe por kati i parë i saj është i mbushur deri në themberën e harkut të hyrjes, i cili është ndërtuar me tulla, përzjerë me gurë plloçakë. Kulla ka përmasa të brendshme 3,40 x 2,30 m dhe trashësi muresh prej 1 m.

Të dy katet e kullës nuk komunikonin midis tyre nga ana e brendëshme dhe ndaheshin me dysheme druri të mbështetur mbi trarë me seksion katërkëndësh 0,20 x 0,20 m. Ndërsa në katin e parë hyej nga jashtë prej portës që përmendëm, në katin e dytë hyrja me hapësirë drite 0,87 m e mbuluar me arkitra druri komunikonte me shtegun e rojeve. Kati II formohej nga një kthinë e vetme e pajisur me tre frengji që hapen në meset e mureve të jashtëm të kullës. Frengjitë kanë në prerje formën e një trekëndëshi me kulm nga ana e jashtme. Përmasat e tyre janë: lartësia 0,70 m gjerësia e brendshme 0,55 – 0,85 m dhe e jashtme 0,12 m.

Sikurse hyrja edhe frengjitë mbuloheshin me arkitrarë druri, gjurmët e të cilëve dallohen mjaft qartë.

POROTOMY

Kati II mbulohet nga një qemer cilindrik me formuese në drejtim të murit rrethues. Mbi qemerin ndodhej platforma e rrethuar nga bedenat prej të cilëve ruhen vetëm gjurmë të murit të tyre.

Muret e kullës janë ndërtuar me gurë dhe copra tullash të futura pa rregull por jo me shumicë dhe nuk ka breza horizontalë të ndërprerë tullash, ajo mund të jetë më e vonë nga faza e parë e murit me harqe tullash që vjen pas saj dhe e njëkohëshme me ambientin (3) në anën perëndimore të rrethimit të jashtëm. Tek kulla G muri rrethues bën një kthesë kënddrejtë në drejtim të pjesës së brëndshme të fortifikimit ku më tej vazhdon një trakt i murit rrethues, shtegu i rojeve të cilit formohet mbi një konstruksion me pilastra dhe harqe tullash (Tab. VI). Ky i fundit ka një gjatësi prej 23 m (Tab. I). Muri përshkohet dhe nga një hyrje me hapësirë drite 1.40 m dhe lartësi 1,85 m.

Hyrja është e mbuluar me një hark e bordurë tullash që kanë së bashku një lartësi prej 0,35 m. Trashësija e ilaçit midis tullave është 6 cm ndërsa e vetë tullave 3-4 cm (Tab. VII).

Në këtë pjesë të murit rrethues dallojmë qartë dy periudha ndërtimi. Porta me hark dhe bordurë tullash i përket fazës së dytë. Hyrja e vjetër ka qenë më e madhe dhe mbulohej me një hark tullash pa bordurë, gjurmët e këtij harku dallohen në të djathtë të harkut të ri nga ana e jashtme e fortifikimit (Tab. VII). Në fazën e dytë të ndërtimit janë eliminuar edhe disa qemerë mbi të cilët mbështetej shtegu i rojeve duke i mbushur ato me mur të plotë (Tab. VI), gjë që e dëshmon qartë gjysma e një qemeri që ka mbetur nga faza e parë. Në fazën e parë të ndërtimit edhe harqet me tulla të qemerëve kanë qënë pa bordurë. Këto harqe si dhe teknika me breza të ndërprerë tullash dhe copra të futura në mënyrë të çrregullt të kujtojnë teknikën e bazilikës së madhe bizantine (periudha e dytë e ndërtimit, mureve anësore të nefit qëndror), e cila ndodhet aty pranë. Pas murit me pilastra dhe harqe teknika e ndërtimit të murit rrethues ndryshon, ai është ndërtuar me gurë pak a shumë të mëdhej, të vendosur në rreshta dhe pa përdorim tullash që të kujton murin verior me kulla katërkëndëshe të akropolit (Tab. I, 6). Në këtë mur dallohen gjurmët e një hyrje (Tab. I,5). Mëtej në pikën 4 (Tab. I,4) dallohen gjurmët e një hyrje tjetër dhe të përkuljes së harkut që e mbulonte atë, ndërsa nga brënda kurtinës është mbështetur një mur masiv që duhet ti përkasi bazamentit të shkallëve. Trashësia e murit rrethues në këtë pjesë është 1,80 m ndërsa muri i bedenave 0,60 m. Nga ana e brendshme muri mbrojtës deri në nivelin e shtegut të rojeve ngrihet vetëm 1,5 m (Tab. V,1). Muret në vazhdim deri tek «Porta e Liqenit» paraqesin trakte të ulët pasi ato ngrihen vetëm pak në këtë pjesë të fortifikimit dhe i përkasin në pjesën më të madhe parapetit dhe bedenave dhe nga ana tjetër është vështirë të shihet teknika e ndërtimit të këtyre mureve sidomos në afërsi të «Portës së Liqenit» pasi ato bien direkt mbi liqen dhe janë të veshura me bimësi të dendur.

MURI QË MBYLL KALIMIN MIDIS KALASË DHE LIQENIT

Një mur tërthor bllokonte ripin e tokës që formohej midis liqenit dhe mureve rrethues të qytetit nga ana veriperëndimore. Ky ndërtim u realizua për herë të parë në mesjetë dhe kishte për qëllim ashtu si dhe muri i Demës në Ksamil, ta bënte sa më të efektshme mbrojtjen natyrale që i krijonte liqeni qytetit të Butrintit, i cili së bashku me kanalin e Vivarit e rrethonte atë me sipërfaqe ujore në të tre anët më pak të mbrojtura nga reliefi. Zgjedhja e vendit ku do të kalonte muri është bërë në mënyrë të tillë që ti ekspozohej sulmit të armikut një linjë sa më e shkurtër e mureve rrethuese dhe madje pjesa më e mbrojtur e tyre.

Muri ka një gjatësi prej 55 m të barabartë me largësinë nga muri rrethues i qytetit deri tek bregu i liqenit. Lartësia e tij rreth 10 m ruhet deri në nivelin e bedenave (Tab. XI,2).

Duke u nisur nga teknika e ndërtimit dhe të dhëna të tjera në këtë mur dallojmë tre faza ndërtimi duke vërejtur gjithashtu se periudha më e hershme është më e vonë nga ajo e murit rrethues në vendin e takimit (Tab. XI,1). Kështu që në këtë pjesë të ndërtimeve mbrojtëse të Butrintit dallojmë qartë katër faza mesjetare ndërtimi.

Faza e parë e ndërtimit zë pjesën më të madhe të murit duke kapur një gjatësi prej 35 m. Kjo fazë fillon tek muri rrethues i qytetit, të cilit ajo i mbështetet pa krijuar kurfarë lidhje dhe vazhdon në drejtim të liqenit. Ky fakt tregon se muri pengues është i një periudhe më të vonë nga gjithë fazat e mureve të kalasë të cilave ai i mbështetet.

Në rastin konkret muri pengues i mbështetet në pjesën e poshtëme të tij një konstruksioni antik me blloqe guri kënddrejtë dhe trapezoidalë, ndërsa në pjesën e sipërme muraturës mesjetare që vijon mbi këta blloqe e cila na paraqet një teknikë krejt të ngjashme me atë të kullave dhe kontraforteve trekëndëshe në anën perëndimore të kalasë. Këtu janë ripërdorur blloqe antike të lidhur me llaç, ku fugat vertikale janë mbushur me copra tullash të vendosura horizontalisht njëra mbi tjetrën (Tab. XI, 1) (Tab. II,3). Por edhe faza e parë e murit pengues që shkon

DO NOT COPY

në drejtim të liqenit është ndërtuar me të njejtën teknikë, këtu takojmë breza të shkëputur horizontalë me tulla si dhe copra tullash të vendosura në mënyrën e përshkruar më sipër në fugat vertikale midis gurëve, por vërehen tek tuk edhe tulla të vendosura vertikalisht (Tab. XI,4). Ndryshimi tjetër është se në rastin e dytë nuk kemi blloqe antike të ripërdorur.

Siç kemi vënë re dhe në pjesë të tjera të mureve të kalasë (në murin verior të akropolit) këtu kemi të bëjmë me një teknikë që vazhdon për një periudhë relativisht të gjatë, dhe njëkohësisht me dy faza të ndryshme ndërtimi, ku më e hershmja është ajo ku gjejnë ripërdorim blloqet antike.

Faza e parë e ndërtimit, të murit që lidh kalanë me liqenin përshkohet dhe nga një hyrje e mbyllur më vonë me mur (Tab. XI, 3). Hyrja mbulohet me një hark tullash dhe ka një hapësirë drite prej 1.20 m.

Disa metra në veri të hyrjes ruhen gjurmët e një palë shkallëve që të ngjitnin në shtegun e rojës.

Muri i fazës së dytë ka një gjërësi prej 1,46 m, në brendësi të tij nuk janë përdorur breza druri. Po kësaj faze i përket edhe një kullë katërkëndëshe e ruajtur në lartësi rreth 5 m. e cila del nga muri 2,80 m dhe ka një gjërësi ballore prej 4.40 m (Tab. XI,5).

Muri i fazës së dytë dallon qartë nga ai i së parës pasi është 0,30 m më i ngushtë se ky i fundit, duke e lënë këtë diferencë në formë shkallëzimi në anën e jashtme (Tab. XI,4).

Muri i fazës së dytë ruhet deri në lartësinë e gjurmëve të murit të bedenave i cili ka patur një gjërësi prej 0,45 m.

Edhe si teknikë ndërtimi po të vërehet me kujdes ai dallon nga faza e parë. Në faqet e mureve janë përdorur me shumicë tulla. Ato i takojmë në trajtën e rreshtave horizontale të ndërprerë, ose të tullave apo coprave të tyre të vendosura në mënyrë të çrregullt midis fugave horizontale të gurëve. Nga kjo pikpamje ky mur ngjan me disa kulla dhe trakte muresh në rrethimin e jashtëm jugor të qytetit si dhe me disa pjesë muresh në rrethimin jugor të Akropolit dhe të murit që zbret prej tij deri tek porta Skea.

Por nevoja i ka shtyrë banorët e qytetit të ndërmarin edhe njëherë tjetër punime në këtë mur. Kësaj radhe pjesa e murit që ndodhet më pranë bregut të liqenit dhe që i përket një faze të tretë ndërtimi, i mbështetet kullës katërkëndëshe, jo në drejtim të murit të saj të brendshëm siç mund të pritej, por të atij të jashtëm. Për këtë arsye edhe fuga që i ndan këto dy faza dallohet mjaft qartë (Tab. XI, 6). Ky mur ka një gjerësi prej 1,25 dhe ruhet në lartësi deri në nivelin e murit të bedenave i cili ka qenë 0,60 m i gjërë. Teknika e ndërtimit dallon gjithashtu qartë nga dy fazat e tjera të ndërtimit. Në mure janë përdorur shumë tulla dhe copra të futura në mënyrë krejt të çrregullt midis fugave ku një pjesë e madhe e tyre janë vendosur vertikalisht (Tab. XI, 6).

Paisja e këtij muri barierë me një portë tregon se ai shërbente jo vetëm për të mbrojtur anën veriore të fortifikimeve të qytetit por për të krijuar edhe një dalje të fshehtë e më tepër për manovrimin e forcave mbrojtëse në raste rrethimi.

FORTIFIKIMET MESJETARE TË AKROPOLIT

Në murin verior të akropolit dallojmë qartë dy periudha mesjetare në substruksionet e të cilëve nuk [illegible]ëm të konstatojmë as gjurmë prehistorike dhe as blloqe antike, qoftë dhe të ripërdorur. Periudha më e hershme e këtij muri ka një gjatësi prej rreth 50 m në skajin perëndimor. Në këtë trakt ruhet një kontrafortë drejtkëndëshe dhe një tjetër trekëndëshe mbi të cilën mbështetet periudha e dytë e ndërtimit që në këtë rast përfaqësohet nga një kullë drejtkëndëshe masive (D). Këto elemente arkitektonike si kontrafortat dhe kullat e vogla trekëndëshe i takojmë edhe në traktin e murit rrethues të jashtëm të fortifikimit në anën perëndimore të përshkruar më sipër (kulla E) i cili ndodhet fare pranë të parit dhe që duket të jetë vazhdim i tij, por teknika e ndërtimit midis këtyre dy ndërtimeve ndryshon. Në traktin e përmendur të murit verior të akropolit janë përdorur, në faqet e jashtme shumë copra tullash e tjegullash të vendosura në mënyrë të çrregullt; takohet gjithashtu rrallë ndonjë tullë e vendosur vertikalisht dhe në ndonjë rast, çifte tullash të vendosura në këtë mënyrë. Në anën tjetër takohen sipërfaqe të konsiderueshme ku nuk është përdorur fare tulla si p.sh. në faqen veriore të kullës trekëndëshe.

Pra siç duket këtu kemi të bëjmë me një fazë më të vonë ndërtimi nga ajo pjesë e murit rrethues të jashtëm në anën perëndimore që përmban të njejtët elementë arkitektonikë.

Kjo fazë ndërtimi tregon për degradimin e teknikës së vendosjes së coprave të tullave horizontalisht midis fugave vertikale të gurëve, megjithëse vazhdojnë të ruhen akoma elementët arkitektonikë.

Në pjesën që vijon në drejtim të lindjes teknika e murit verior të akropolit ndryshon krejtësisht. Në të nuk takojmë më tulla. Gjithashtu të katër kullat që projektohen gjatë këtij muri janë katërkëndëshe, masive, dhe të ndërtuara në të njejtën mënyrë.

Si kullat dhe kurtinat janë ndërtuar me të njejtën teknikë, me gurë kave të lidhur me një llaç të fortë të përzjerë me mbushës të ashpër. Gurët janë

DO NOT COPY

vendosur në rradhë të çrregullta. Nuk konstatohet përdorimi i brezave të drurit si në kurtinat ashtu edhe tek kullat.

Kulla D ka një gjërësi prej 6,70 m dhe dalje nga muri 4.50 m trashësia e mureve të saj është 1,35 m. Gjatë murit midis kullës D dhe C konstatohet në pjesën e poshtme dalja e disa mureve tërthor të rrënuar me gjërësi 0,80 m që mund të jenë mbeturinat e kontrafortave të murit më të vjetër mesjetar. Siç shihet edhe nga ky fakt muri mesjetar pararendës ka pësuar para rindërtimit një rrënim pothuajse të plotë. Kulla C (Tab. XII) ruhet në një lartësi prej rreth 5 m ka trajtë katërkëndëshe, por nuk mund të matet veçse gjerësia e saj prej 6,10 m pasi muret anësorë nuk ruhen të plotë; njeri prej tyre del nga muri rrethues 4,00 m ndërsa tjetri 3,50 m. Trashësia e mureve të kullës është e barabartë me ato të kullës D.

Në murin e prapmë të kullës ruhen gjurmët e hyrjes që ka patur një hapësirë drite 1,20 m. Në të djathtë të kullës ndodhet dhe një hyrje për në akropol. Në pjesën e sipërme porta mbulohet me një arkitra guri monolit të punuar trashë të mbështetur mbi dy konsola. Konsolat të kujtojnë mensolat e Portës së Liqenit, por janë punuar trashë dhe në mënyrë primitive. Konsola e krahut të majtë është thyer në pjesën e profiluar. Ndryshe nga kulla D dhe muri midis dy kullave, në kullën C vihet re përdorimi me pakicë i fragmenteve të tjegullave dhe tullave në faqet e jashtme të mureve të saj. Por kjo nuk ve në dyshim njëkohëshmërinë e ndërtimit të këtyre dy kullave.

Kulla B, ruhet në një lartësi prej rreth 8 m, del nga muret 5,30 m dhe ka një gjerësi prej 6,80 m. Në dy muret anësorë të saj, për shkak të rënimit dallohet struktura e brendëshme në gjithë lartësinë megjithatë ashtu si edhe në kullat e tjera nuk hetohen gjurmë brezash druri.

Kulla A (Tab. XII) është e fundit e kësaj periudhe ajo ruhet gjithashtu në lartësinë 8 m. Muret anësore kanë një gjërësi prej 1,35 m që është e barabartë me atë të murit rrethues pranë kullës. Në këtë të fundit ruhen edhe gjurmë të murit të bedenave i cili ka qenë 0,60 m i gjërë.

Në mesin e murit të prapëm të kullës hapet një hyrje me gjërësi 1,10 m mbulesa e së cilës nuk ruhet. Hyrja i takon lartësisë së katit të dytë, por ka mundësi që kjo të ketë qenë e vetmja hyrje e kullës pasi tereni brenda kështjellës ka qenë mjaft më i lartë. Në të djathtë të kësaj kulle ashtu si dhe tek kulla C ruhen gjurmët e një hyrjeje për në akropol. Hyrja ka pasur një hapësirë drite prej 1,30 m dhe mbulohej me një hark të thjeshtë tullash pa kornizë, por më vonë pasi harku i saj në pjesën më të madhe ishte rrënuar, ajo u mbyll me mur. Mbas kullës A muri kthen në formë të harkuar në drejtim të Jugut. Rreth 20 m në këtë drejtim, murit të akropolit i mbështetet një mur i cili zbret gjatë shpatit të kodrës në drejtim të Portës së Liqenit. Pas takimit me këtë mur teknika e kullave katërkëndëshe ruhet edhe për pak metra por më tutje asaj i mbivihet një mur tjetër në të cilin përdoren me shumicë copat e tullave e të tjegullave të vendosura në mënyrë të çrregullt. Gjatë gjithë murit jugor të akropolit gjen përdorim të gjërë materiali qeramik prandaj ai paraqet tipare të ndryshme nga muri verior dhe për këtë arsye po e trajtojmë veçmas.

Muri jugor i akropolit është ngritur mbi konstruksione prehistorike, antike dhe në mënyrë të veçantë mbi ato të periudhës romake.

Në traktin e shënuar me shkronjën F të një muri që ndjek linjën e përthyer të murit antik dallohen qartë dy teknika ndërtimi ajo e periudhës romake dhe mesjetare që i mbivihet në pjesën e sipërme të parës (Tab. XIII,1). Në këtë periudhë të dytë janë përdorur shpesh copa tullash të vendosura horizontalisht njëra mbi tjetrën në fugat vertikale të gurëve (Tab. XIII,2). Kjo teknikë të kujton fazën e parë të ndërtimit të murit që bashkon kalanë me liqenin nga ana veriperëndimore. Në vazhdim të këtij muri dallohet thuajse rafsh me tokën faqja e një kulle trekëndëshe e ndërtuar me të njëjtën teknikë.

Gjurmë daljesh trekëndëshe dallohen edhe në vazhdim të murit jugor të akropolit. Në një kohë më të vonë është ndërtuar para këtij muri një mur mbajtës me gjerësi 1,5 m ku copat e tullave janë futur në një mënyrë të çrregullt dhe midis tyre takohen mjaft tulla vertikale. Pas këtij muri ndodhet një hyrje për në akropol me hapësirë drite 1,5 m dhe lartësi 2,5 m por teknika e ndërtimit pranë saj është vetëm me gurë. Hyrja (Tab. XII) ka qenë mbuluar me arkitra dhe tavan druri, nga sa kuptohet prej zgavrave që janë ruajtur pas dekompozimit të këtij materiali. Pas hyrjes, për shkak të terenit të aksidentuar muri bën një kthesë të fortë duke krijuar më tej një të dalur të gjërë trekëndëshe. Në kulmin e këtij trekëndëshi është ndërtuar një kullë e cekët gjysmë rrethore.

Kulla, të cilën e kemi shënuar me shkronjën «O» (Tab. XII) paraqet një teknikë ku përdoren me shumicë coprat e tullave, por vetëm rrallë tulla të vendosura vertikalisht. Kjo teknikë ngjan me periudhën e dytë të murit që lidh kalanë me Liqenin si dhe me një pjesë muresh e kullash të rrethimit të jashtëm të qytetit nga ana jugore. Llaçi i përdorur për lidhjen e gurëve është i një cilësije të mirë me përzjerje çakulli.

DO NOT COPY

Teknika e mësipërme vazhdon deri tek muri i periudhës romake që zbret gjatë shpatit jugor të kodrës me drejtim në perëndim të «Portës me kulla». Pas tij kemi një trakt ku nuk janë përdorur tullat dhe që ngjason nga teknika me murin verior të akropolit, me kullat katërkëndëshe. Ky mur vazhdon deri tek një kthesë e vogël drejtkëndëshe që del rreth 1 m, e cila bashkë me murin në vazhdim të saj i mbështetet murit pa tulla. Tani teknika e ndërtimit ndryshon dhe është më e vonë se ajo e murit verior të akropolit me kullat katërkëndëshe. Në të shohim se përdoren në mur përsëri copat e tullave të futura në formë të çrregullt, por me pakicë, deri pranë murit që zbret për tek Porta e Liqenit.

MURI QË ZBRET NGA «AKROPOLI» DERI TEK PORTA E LIQENIT

Nga ana veriperëndimore e Akropolit, zbret një mur prej këtij të fundit deri tek «Porta e Liqenit», i cili duke u takuar pranë kësaj porte me linjën veriore të rrethimit të qytetit, formon atë që e kemi quajtur për kohën antike «qyteti i sipërm».

Në këtë mur ruhen trakte të rëndësishme të periudhës romake sidomos pranë «Portës së Liqenit» (Skea), por edhe në pjesët e sipërme ku ndërtimet mesjetare zenë vëllimin kryesor, ato janë vendosur në të shumtën e rasteve mbi substruksione të periudhës romake. Në skajin jugperëndimor ky mur i mbështetet murit të «akropolit», i cili vazhdon deri në këtë pjesë me të njejtën teknikë të anës veriore me kullat katërkëndëshe. Kështu muri që zbret për tek Porta e Liqenit është më i vonë nga muri verior i «akropolit» dhe përputhet në kohë me një pjesë të mirë të murit jugor të tij. Tek ai janë përdorur copra tullash dhe tjegullash të cilat i takojmë më tepër në trajtën e brezave të ndërprerë prej një rreshti. Janë përdorur me shumicë tulla që vendosen midis fugave horizontale të gurëve dhe vetëm rallë midis fugave vertikale. Tepër rrallë takojmë ndonjë tullë të vendosur vertikalisht apo fragmente tjegullash që rrethojnë gurët.

Gjatë këtij muri, pranë «Portës së Liqenit» ndodhet edhe një hyrje (Tab. XIV). Ajo ka një hapësirë drite prej 1.20 m dhe lartësi 2 m.

Paturat e saj formohen nga blloqe monolite guri ndërsa harku me një lartësi prej 23 cm formohet nga gurë të skuadruar smërçi me nga një tullë të vendosur në drejtim radial midis fugave të tyre, tullat janë të përmasave 0,22 x 0,18 x 0,03 m. Në pjesën e sipërme harku rrethohet me një kornizë tullash të harkuara me trashësi 2 cm. Tek hyrja mund të matej me lehtësi dhe trashësia e këtij muri që ishte 2,05 m, ndërsa lartësija e ruajtur shkon në disa vende 7-8 m.

Harku i kësaj porte të kujton nga teknika e ndërtimit atë të portës së jashtëme të oborrit të fortifikuar të kalasë së Beratit të ndërtuar rreth vitit 1205 nga Mihal Engjëll Komneni, veçse në këtë të fundit midis gurëve vendosen në mënyrë të alternuar dy dhe tre tulla vertikale ndërsa në pjesën e sipërme harku kufizohet nga një kornizë e dyfishtë prej tullash[13].

KËSHTJELLA

Kështjella ka formën e një pesëkëndëshi të çrregullt dhe formohej nga një kryekullë (Donzhon) e brendshme dhe muri që e rrethonte atë. Kryekulla mbështetej në murin verior të kështjellës. Një mënyrë e tillë ndërtimi të kujton pak a shumë «Kryekullën» që ndërtoi në kalanë e Durrësit në 1225 Teodor Komneni e cila sipas përshkrimit të L. Hezejt që pati rastin të shqyrtojë në vend gjurmët e saj, ishte pajisur me një banesë dhe një oborr të brendshëm.[14] Në Butrint kryekulla shërbente njëkohësisht edhe për tu banuar, po këtij qëllimi duhet ti kenë shërbyer edhe disa ambiente që i mbështeten murit rrethues jugor të saj. Kështjella është ngritur në pjesën më të lartë dhe më të mbrojtur të kodrës së Butrintit, nga ku mund të vrojtohet një pjesë e mirë e rrethimit të jashtëm të qytetit (Tab. XV, 1).

Në kryekullë qëndronte me sa duket komandanti ushtarak i qytetit nga ku drejtonte operacionet e mbrojtjes dhe të sulmit. Vetë kështjella në përgjithësi dhe kryekulla në veçanti janë vendosur në funksion të kryerjes së një detyre të tillë.

Kështjella është ndërtuar në funksion të vrojtimit të pjesëve më pak të mbrojtura nga natyra të qytetit të fortifikuar të Butrintit. Ndërsa vetë kryekulla duke u vendosur në murin verior të kështjellës mund të vrojtonte dhe një pjesë të mirë të murit rrethues veriperëndimor si dhe hyrjet për në akropol. Përshkrime më të hollësishme për të nuk mund të bëhen pasi i gjithë ky kompleks është rindërtuar nga Ugolini, pa na lënë një dokumentacion të mjaftueshëm të pjesëve ekzistuese. Restaurimi është realizuar sipas kriterit të plotësimeve stilistike. Kështu

13) A. Baçe, **Qyteti i fortifikuar i Beratit,** Monumentet 2/1971.
14) L. Heyzey, H. Daumet, **Mission Archeologique de Macédoine** Paris, 1876, 349-392.

pamja që ka sot kështjella dhe kryekulla janë më tepër meritë e fantazisë së restauratorëve se sa një e vërtetë historike. Ugolini që priste të zbulonte edhe për periudhën e sundimit venecian ashtu si për atë romake ndërtime të rëndësishme, u detyrua ti krijojë këto të fundit me duart e restauratorëve. Në kushte të tilla është vështirë të konstatosh me siguri pjesët e vjetra. Megjithatë disa gjurmë të tyre hetohen në faqen veriore të «kryekullës» si dhe në murin rrethues të saj nga ana lindore ku ndodhet dhe hyrja kryesore për në kështjellë. Teknika e ndërtimit të këtyre fragmenteve ngjan me pjesët më të vona të murit jugor të akropolit dhe murit rrethues të jashtëm gjatë bregut të kanalit të Vivarit.

* * *

Siç del dhe nga përshkrimi i mureve mbrojtës mesjetarë të Butrintit, kuptohet se ato zinin në këtë periudhë vëllimin më të madh nga gjithë periudhat e tjera historike paraardhëse. Nga ana tjetër fazat e ndërtimit janë aq të shumta sa dëshmojnë për rëndësinë që pati qyteti gjatë gjithë mesjetës, gjë që nuk mund të na i thonë kursesi burimet e shkruara fare të pakta dhe fragmentare.

Por fazat e shumta të ndërtimeve të ndërthurura me njera tjetrën shpesh me teknika mjaft të ngjashme apo të padallueshme midis tyre e vështirësojnë mjaft problemin e vendosjes së një kronologjije absolute apo relative të saktë e për pasojë peshën dhe rëndësinë që kishin këto ndërtime mbrojtëse në periudha të caktuara historike.

Megjithatë në këtë studim të parë mund të arrihen gjithsesi disa rezultate paraprake edhe përsa i përket fortifikimeve mesjetare.

Një nga mbështetjet kryesore në këto arritje megjithë vështirësitë e përmendura më lart do të jenë teknikat e ndryshme të ndërtimit të mureve, të para në një kuadër më të gjerë, por dhe si qëndrojnë në raport me njera tjetrën në rastin konkret.

Më e hershmja nga këto teknika në Butrint është ajo me përdorimin e fragmenteve të tullave të vendosura horizontalisht midis fugave vertikale të gurëve, por siç del qartë dhe nga përshkrimi i monumentit, kjo teknikë me pak ndryshime vazhdon për një periudhë relativisht të gjatë.

Na duket se nga variantet e saj në Butrint më e hershmja është ajo ku janë përdorur gurë të përmasave të mëdha apo janë ripërdorur gurët antikë. Këto ndërtime i takojmë direkt mbi muret antike siç është rasti në anën veriore të murit rrethues të jashtëm. Sidomos me evident është rasti tek pika e takimit me murin që bashkon kalanë me liqenin si dhe nga ana veriore ku dy variante të kësaj teknike diferencohen në kohë si dy periudha të ndryshme ndërtimi. Teknikën e përmendur e takojmë gjithashtu te kulla E dhe tek muri me kontraforta në dy anët e saj. Për ta vendosur aërsisht në kohë këtë periudhë ndërtimi do të na duheshin shembuj nga monumente të datuar ose se si qëndron kjo në kronologjinë relative në ndërtime të tjera.

Një nga shembujt më të mirë e takojmë në Berat, në kala, si dhe në kishën e Shën Kollit të Perondisë në afërsi të këtij qyteti ku duket qartë se të njejtët mjeshtër që ndërtuan kishën kryen edhe punimet në kala.

Në kishën e Perondisë janë konstatuar tre faza kryesore ndërtimi të periudhës bizantine[15].

Përsa i përket teknikës së ndërtimit këto faza dallohen si vijon. Faza e parë e datuar në gjysmën e dytë të shek. XI, por që mund të jetë dhe më e hershme, është ndërtuar në mënyrën e përshkruar për kullën E, pra me rreshta tullash horizontale dhe copa tullash të vendosura horizontalisht mbi njera tjetrën në fugat vertikale të gurëve. Faza e dytë e datuar në fillim të shek. XIII, është ndërtuar me gurë dhe breza tullash prej 4-5 rreshtash, ndërsa faza e tretë e datuar në shek. XIII-XIV, është ndërtuar me teknikën e kluasonazhit[16]. Këto tre teknika ndërtimi i hasim edhe në kalanë e Beratit, madje dy të parat ndodhen edhe tek kjo në të njejtin raport përsa i përket mbivendosjes. Muret me gurë antikë të ripërdorur dhe me copra tullash që mbushin fugat vertikale midis tyre në Kalanë e Beratit ashtu si edhe në Butrint i shohim të ngritura direkt mbi muret antike atje ku janë ruajtur trakte të tyre. Më i dukshëm është ky fenomen sidomos pranë portës kryesore. Këtë teknikë e takojmë edhe tek oborri i fortifikuar para kësaj hyrje si dhe në kullën pranë këtij të fundit. Në krahun e djathtë të harkut të hyrjes për në oborr ndodhet monogrami i Mihal Engjëll Komnenit, i cili është bërë shkak për datimin e krejt oborrit si dhe të kullës pranë tij në fillim të shek. XIII[17] (v. 1205). Por në fakt në kohën e Mihal Engjëll Komnenit kemi një rindërtim të oborrit ku është përfshirë edhe harku i portës. Teknika e ndërtimit të pjesëve të sipërme të mureve të oborrit ndryshon krejtësisht nga ajo e pjesëve të poshtëme.

15) A. Meksi, **Arkitektura dhe restaurimi i Kishës së Perondisë,** Monumentet, 5-6, 1973, f. 27-28.
16) A. Meksi, **vep. cit.,** 32-33.
17) A. Baçe, **Qyteti i fortifikuar i Beratit,** Monumentet 2-6, 1971, 43-62.

Do not copy

DO NOT COPY

Ndërtimet e Mihal Komnenit në këto pjesë të fortifikimit përfaqësohen nga një muraturë e ndërtuar me gurë kave të vegjël në të cilën është aplikuar dhe monogrami i tij. Në pjesën më të madhe të mureve dhe kullave të Beratit, kjo teknikë e dallueshme qartë kombinohet dhe me breza tullash prej 4-5 rradhësh që i përgjigjen fazës së dytë të ndërtimeve në kishën e Perondisë.

Pra për kalanë e Beratit fundi i shek. XII fillimi shek. XIII do të na shërbente si një terminus ante quem për periudhën e parë të ndërtimit. Kështu më e mundëshme është që oborri i fortifikuar i Beratit të jetë ndërtuar ashtu si dhe Kisha e Perondisë fillimisht në shek. XI dhe më herët. Në kështjellën mesjetare të Lezhës mbi muret antike janë mbështetur mure me llaç me blloqe të ripërdorur ku fugat vertikale mbushen si në Butrint dhe Berat me tulla apo me copra të thyera guri. Në këtë rast nuk mund të mos miret në konsideratë përmendja e kështjellës mesjetare të Lezhës në trajtën Elission që nga viti 1018, gjë që na bën ta zbresim këtë periudhë ndërtimi pa vështirësi së paku deri nga gjysma e dytë e shek. X.

Le mode de construction des meurtrières à couverture presque horizontale indiquent qu'elles ont été percées dans un mur qui existait auparavant et non construit récemment. Ce qui indique que les Vénitiens ont effectué nombre de travaux dans le domaine des fortifications, afin de pouvoir défendre d'une attaque imprévue lancée par des forces peu nombreuses le port commercial que Butrint était pour eux à l'époque. En témoigne aussi le fait que durant l'expédition du Sultan Soliman en 1537 Butrint, à la différence de Corfou, n'a pas opposé une résistance digne de ce nom malgré les mesures de défense que les Vénitiens avaient prises dès 1492.

A une période plus récente appartient aussi la troisième phase de construction du mur qui relie la forteresse au lac.

Sa période de construction plus probable se situe dans la période entre le Despotat de l'Epire et l'occupation vénitienne, à savoir la période allant du dernier quart du XIIIe à la fin du XIVe siècle.

DO NOT COPY

Fatos TARTARI

DO NOT COPY

ELEMENTE TË RINJ NË KALANË E DURRËSIT TË SHEK. V–VI TË ERËS SONË

Arkeologë: e topografët e huaj që vizituan Durrësin në të kaluarën patën mundësi të vëzhgojnë e të ndjekin nga afër konfiguracionin dhe perimetrin e kalasë së tij. Nëpërmjet skicave të Domjesë[1] Shoberit[2] dhe Rei-t[3] ne edhe sot e kësaj dite mund të ndjekim me përafërsi linjat kryesore të mureve, që kanë mbrojtur qytetin në shekuj. Në një serë punimesh të autorëve tanë të sotëm janë bërë përpjekje të suksesëshme për të lidhur ngjarjet e mëdha historike me periudhat e ndryshme të ndërtimit në kalanë e Durrësit, për të dhënë një histori të arkitekturës ushtarake në qytet[4]. Analizat e kujdesshme të teknikave të ndërtimit, leximi e zbërthimi i monogrameve e shenjave të tjera në tullat e mureve dhe kullave kanë provuar tashmë se tre unazat e mureve mbrojtës u plotësuan dhe u përfunduan gjatë aktivitetit ndërtimor të perandorit të Bizantit me origjinë nga Durrësi, Anastasit I (v. 491-518 e. sonë)[5].

Megjithatë si rezultat i punimeve të vazhdueshme në qytet, hera herazi dalin edhe elemente të rinj, me shumë interes, që i përkasin sistemit të tij fortifikues ose që kanë lidhje me të. Këta elementë dora dorazi ndihmojnë për të qartësuar shumë probleme që kanë mbetur ende pa një përgjigje të plotë e të argumentuar. Në qëndër të këtij shkrimi janë pikërisht dy elemente të tillë: Një nyje e përforcuar (kullë e brendshme) në linjën e murit verior të rrethimit të dytë në rrugën Ismail Qemali (oborri i përparmë i kopshtit «R. Skilja») dhe trakte të shkëputur të një kalimi të nëndheshëm brenda mureve të kalasë mesjetare.

Linjën e përafërt të murit verior të rrethimit të dytë e njohim para së gjithash nga disa gjurmë në kodrën «Stani», nga mbeturinat e kullës së rindërtuar nga T. Komneni[6], nga një trakt i dytë rreth katër metra i gjatë në rrugën «A. Goga» (në hyrjen e ndërtesës me nr. 695[7]) dhe tani së fundi pak më poshtë nga një linjë e po këtij muri me një dhëmbëzim të brendëshëm (Tab. I, 2,3) dalë në dritë në rrugën Ismail Qemali. Në pamundësi për të zgjeruar gërmimin në këtë pikë e për të parë funksionin e vërtetë të kësaj nyje, vumë re se në njerin krah muri rrethues ndjek drejtimin verilindje-jugperëndim për t'u çfaqur përsëri në traktin e ndërtesës Nr. 695. Në krahun tjetër ai kthen nga brenda rrethonjës një herë me kënd të gjerë, në gjerësinë afro 3 metra të fragmentit të murit, dhe pak më poshtë me kënd të drejtë në një

1) L. Heuzey – H. Daumet, **Mission archeologique de Macedoine,** Paris, 1876, f. 349-392.

2) A. Schober, **Zur topographie von Dyrrachium,** Jahreshefte des Osterreichisches Arcaologisches Institutes, Band XXIII Wien 1926, f. 231-240; C. Praschniker-A. Schober, **Archaologische Forschungen in Albanien und Motenegro,** Wien 1919, f. 32-46.

3) L. Rey, **Les Remparts de Durazzo,** Albania, 1925, f. 33-48.

4) Gj. Karaiskaj – A. Baçe, **Kalaja e Durrësit dhe sistemi i fortifikimit për rreth në kohën e vonë antike,** Monumentet 9, 1975, f. 5-23; Gj. Karaiskaj, **Kalaja e Durrësit në mesjetë,** Monumentet, 13, 1977, f. 29-53. Në këto punime është provuar se gjurmët më të hershme të dokumentuara në muret rrethues ekzistues i takojnë shek. III-IV të erës sonë, ndërsa në të vonat vitit 1502.

5) K. Zheku, **Zbulime epigrafike në muret rrethuese të kalasë së Durrësit,** Monumentet 3, 1972, f. 35 – 47.

6) L. Heuzey – H. Daumet, vep. cit. f. 354.

7) Gj. Karaiskaj – A. Baçe. **vep. cit,** f. 9.

mur të ndërprerë me gjerësi 1,15 m (Tab. I, 1,3). Në qoftë se konturi i brendëshëm i këtij dhëmbëzimi ndiqet qartë një gjë të tillë nuk mund ta themi për atë të jashtëmin. Teknika e ndërtimit është e njëjtë në tri kthesat. Janë përdorur tulla kompakte katërkëndëshe të formateve: 37,5 x 28 (30) x 4,5 (5) cm. të lidhura me llaç të përbërë nga gëlqere e fortë, përzier me guralecë e thërmija tullash me trashësi fuge horizontale 6,2 – 6,5 cm. dhe 3,5 cm në atë vertikale (Tab. I, 1).

I panjohur gjermë tani në sistemin mbrojtës të qytetit është një kalim i nëndheshëm (tunel) degëzimet e të cilit patëm rastin t'i ndjekim e t'i hetojmë kohët e fundit. Njerin aks të këtij kanali, me disa nga pjesët e tij përbërëse si pusetat e zbritjes, hyrjet e degëzimeve të veçanta e ndeshëm brenda kështjellës (kështjella e poshtëme ose e detit)[8] ngjitur me faqen e brendëshme të kurtinës, që kufizohet me kullat F dhe G. Ndërsa degëzimin e dytë më të gjatë e më interesant, që na shtyu të vendosim këtë lidhje, e zbuluam në pjesën më të ultë të kodrës me kuotë 59 m. në rrugën «24 Maj», përpara hyrjes së lulishtes «Adriatiku».

Traktin e ndodhur pranë kullës F[9] e pat vëzhguar kohë më parë edhe Rej, që në pamundësi për ta hetuar nga brenda e përcakton atë vetëm si hyrje të një ndërtimi nëntokësor pa na dhënë hollësi të tjera.[10] Nga ana tjetër, duke krahasuar teknikën e ndërtimit të murit pranë që i përket rrethonjës së shek. V-VI e. sonë si edhe muraturës së kësaj «hyrje» ai thekson se që të dy këto ndërtime janë të një kohëshme. Në të vërtetë ajo që pa Rej nuk është gjë tjetër veçse pjesa e prishur e njërës pusetë (puseta nr. 1) dhe e degëzimit të nëndheshëm që shtrihej në këtë zonë të mureve mbrojtës. Kjo pusetë (Tab. II, 1 fig. 1) ndodhet 15 m larg faqes veriperëndimore të kullës F ndërsa qëndra e saj 2 m nga faqja e brendëshme e kurtinës. Nga puseta ruhet vetëm faqja perëndimore me tri gropëzimet për mbështetjen e këmbëve. Muri i saj del pak sa mbi pjesën e sipërme të qemerit të tunelit. Hyrja për në tunel ndodhet në pjesën veriore të pusetës.

Trakti i nëndheshëm që lidh pusetën nr. 1 e 2 me gjatësi 22,50 m ndjek me valëzime të lehta linjën e thyer të murit mbrojtës midis kullave F dhe G (Tab. II, 1). Në këtë segment muret mbajtës të qemerit përbëhen prej 12 rreshtash horizontale tullash të përmasave 35 (36) x 28 (30) x 4 (4,5) cm që kanë në njërën faqe të stamposur në relief një kryq latin në krahë 3 dhe 6,5 cm si dhe një monogram (Tab. I, 4). Tullat lidhen me llaç të bollshëm, me trashësi fuge 4,5-5 cm të përbërë nga gëlqere e fortë, zhavor i imët dhe copra tullash. Me tulla të pjekura mirë është shtruar edhe dyshemeja e kalimit. Në njerin krah janë vënë tullat më të vogla: 28 x 22 x 4 cm. ndërsa nga krahu tjetër tulla më të mëdha: 37 x 28 x 4 cm. të bashkuara midis tyre në formë kuriz peshku gjatë brinjës me gjatësi 28 cm.

Mbi muret vijon qemeri. Në pjesën më të madhe të gjatësisë së tunelit, qemeri është i mprehët, formuar nga tulla të plota të vendosura këlliç e të bashkuara njera me tjetrën me kulm, por vende vende në mes të tyre janë vendosur edhe tulla më të vogla duke i dhënë qemerit trajtë cilindrike (Tab. II, 3).

Në ndonjë rast janë përdorur edhe blloqet prej guri shtufor për të mbushur ndonjë të çarë a boshllëk. Lartësia e kalimit arrin në 1.40 – 1.50 m ndërsa gjerësia 45 – 50 cm.

Të dhëna më të plota për mënyrën e zbritjes në tunel, si edhe të lidhjes midis degëzimeve të tij na e jep puseta nr. 2, e ruajtur në krejt lartësinë e saj. Puseta ka seksion të rregullt kuadratik me brinjë 0,87 m. (Tab. II, 4). Qëndra e saj, si në rastin e pusetës nr. 1 ndodhet 2 m larg faqes së brendëshme të murit rrethues dhe 1,5 m nën nivelin e sotëm të lartësisë së murit. Duke llogaritur dhe lartësinë e tunelit, puseta nr. 2 ka një lartësi të përgjithshme prej 4,70 m. Zbritja në të, bëhet jo me sistemin e shkallëve por me anë të disa gropëzimeve të vendosura përballë njëra tjetrës. Këto gropëza janë të gjera e të thella 14-16 cm, sa për mbështetjen e këmbëve, dhe jo më shumë se 25 – 45 cm. larg njëra tjetrës. Prej pusetës nr. 2, në gjendjen e tanishme të hetimeve, mund të lëvizet nëpër dy drejtime kryesore: nga ana jugore krijohet lidhja me pusetën nr. 1, ndërsa nga ana veriore nëpërmjet një hyrje të mbuluar me qemer cilindrik tuneli siç duket ndjek linjën e murit drejt kullës G.

Një trakt tjetër i këtij kalimi u çfaq kohët e fundit gjatë hapjes së themeleve të Komitetit të ri të Partisë, në rrugën «24 Maj», (pjesa e përparme e oborrit të rrethuar të kopështit «Adriatiku»). Ai ndjek drejtimin verilindje-jugperëndim (fig. 2, Tab. II, 2). Mendimi ynë është se ky degëzim duhet të bashkohet me linjën kodrinore të tunelit, pak më tej pusetës nr. 2 dhe të vazhdojë në tërë diagonalen e rrethimit të dytë. Tuneli në këtë pjesë të qytetit ruan me pak ndryshime të vogla përmasat e tij: lartësinë prej

8) Gj. Karaiskaj, **vep. cit.** f. 31-42.
9) Pikat e referimit i takojnë gjendjes së sotme të kalasë së Durrësit, e jo asaj të shekujve V-VI-të e.s.
10) L. Rey. **vep. cit.** f. 46, fig. 22.

DOI: 10.37199/F

1.40 m dhe gjerësinë prej 0;45 m. Ndryshime të vogla, të justifikuara me gjatësinë e tij dhe konfiguracionin e terenit, vihen re kryesisht në ndërtimin e brendshëm.

Përsa i përket ndërtimit vihet re një ngjashmëri e plotë në të dy traktet e zbuluar.

Në gjendjen e tanishme të gërmimeve dhe hetimeve, për dhëmbëzimin e brendshëm të murit në rrugën «Ismail Qemali», jemi të mendimit se kemi të bëjmë ndoshta me një nga kullat e brendëshme kuadratike, që përmend Hezej në murin verilindor të kështjellës së shek. V-VI të e. sonë[11], e cila shërbente për të mbrojtur pjesën më të dobët të fortifikatës, ndërsa muri me gjerësi 1,15 m duhet të jetë një rampë shkallë për ngjitje në platformën e kullës.

Elementi më interesant në kalanë mesjetare të Durrësit është zbulimi i kalimit të nëndheshëm, në se ky është një i vetëm, ose i një degëzimi të tërë kalimesh. Në qëndrat kryesore të fortifikuara të vendit tonë si: në Shkodër, Krujë, Berat etj. nuk mungojnë këto hyrje apo kalime të fshehta, që njiheshin vetëm nga mbrojtësit. Kështu psh në kalanë e Shkodrës është vërejtur një portë sekrete me dy koridore të hapura në shkëmb me gjatësi sa për të kaluar një njeri[12]. Në kalanë e Beratit, në faqen jugore duken gjurmët e një galerie 500-600 m të gjatë, që bashkonte qytetin e sipërm me lumin[13]. Edhe hyrja e dytë e kalasë së Krujës në skajin jugperëndimor komunikonte nëpërmjet një tuneli. Po kjo hyrje të nxjer tek krojet që burojnë në rrëzë të shkëmbit, jashtë mureve të kalasë.[14]

Megjithëse të paktë traktet e njohur na japin disa drejtime tepër delikate, që kanë të bëjnë me pikat më të ndjeshme të sistemit mbrojtës. Tuneli që i ngjitet kurtinës midis kullave F dhe G i takon me sa duket (gjithnjë në bazë të referimeve të reja) zonës kodrinore të kështjellës. Mendimi ynë është se ky kalim vlente edhe për të mbikqyrur hyrjet e kësaj pjese të kështjellës atë midis kullave E dhe D, si edhe ndonjë portë tjetër të mundëshme. Ka mundësi që në njerin krah ai të lidhte edhe dy lartësitë, kuotën 59 m me akropolin ose «kështjellën e sipërme» në kuotën 98 m. Duke ndjekur degëzimin e dytë që zbret nga kodra (nënkupto kodrën me kuotë 59 m) vemë re se ai mer drejtimin për në verilindje të qytetit, ndofta drejt portës së rëndësishme të kalorësit (Porta Caballina) që lidhej me rrugën, e cila padyshim luante një rol të dorës së parë në këtë pjesë të mureve mbrojtës. Mendimi tjetër ka të bëjë me lidhjen e drejtë për drejtë me portin, pra me detin, për një largim të shpejtë e të fshehtë nëpërmjet tij. Në të gjitha rastet e njohura (Shkodër, Durrës, Berat etj. galeritë, portat sekrete lidhen në një mënyrë apo një tjetër me vijën e ujit (lumin, liqenin, detin) për të lehtësuar largimin ose kthimin nëpërmjet tij. Këto mendime hipotetike lypset të provohen në vend, duke ndjekur nga brenda të gjitha degëzimet e mundëshme, duke kapur caqet e tyre. Vetëm në këtë mënyrë ne do të mund t'i njihnim ato plotësisht dhe veç kësaj do të skjaronim edhe disa pika të tjera që kanë mbetur të errëta (porta, linja muresh, ndonjë kullë apo element tjetër) në studimet tona për muret mbrojtës të Durrësit.

Degëzimi i tunelit në drejtim të kodrës me kuotë 59 m i është ngjitur faqes së brendëshme të murit rrethues të shek. V-VI. Materiali i përdorur, tulla e llaçi, teknika e ndërtimit të mureve mbajtës, pusetave, qemereve, kanë ngjashmëri të plotë me ato që janë vërejtur edhe në muret rrethues apo kullat e ndërtuara në kohën e Anastasit të I si edhe në rrjetin e madh higjeno-sanitar të qytetit, të realizuar gjatë së njëjtës kohë[15]. Qemerin e mprehtë të formuar nëpërmjet vendosjes së tullave klliç apo qemerin cilindrik me tulla këlliç por që plotësohet e shkëmbehet vende vende edhe me tulla horizontale e kemi vërejtur edhe në trakte të veçuara kanalesh nëntokësore, në frengji kullash e harqe portash.

Simbole të tilla në qytetin e Durrësit janë gjetur pothuajse në të gjitha ndërtimet e shek. V-VI e. sonë muret rrethues[16], kanalet, bazilikat etj. Tulla me shenja të tilla janë vërejtur edhe në rindërtimet e kalasë së Elbasanit në shek. V-VI të e. sonë[17]. Kështu që ne pajtohemi me mendimin e Reit, se këto kalime të nëndheshme u projektuan dhe u ndërtuan tok me muret e njohura rrethuese, në funksion të tyre, për t'i bërë ata me të vërtetë të sigurtë e të pa

11) L. Heuzey – H. Daumet, **vep. cit.** f. 354.
12) V. Kamsi, **Fortifikimi i hyrjes kryesore të kështjellës së Shkodrës,** Monumentet 3, 1972, f. 165 Tab. I, 3.
13) A. Baçe, **Qyteti i fortifikuar i Beratit,** Mon. 2, 1971, f. 43.
14) S. Adhami, **Gjurmime rreth themelit dhe rindërtimeve kryesore të kalasë së Krujës,** Monumentet 1, 1971, f. 88.
15) F. Tartari, Gjurmë kanalesh të lashta në Durrës e në qendra të tjera antike të vëndit tonë, Monumentet, 11, 1976, f. 75-87.
16) K. Zheku **vep. cit.** f. 35-47.
17) Gj. Karaiskaj. Të dhëna të reja për datimin e kalasë së Elbasanit Monumentet 3, 1972, f. 147-157 fig. 2.

Pozitiv

pushtueshëm. Përdorimi i tyre në raste tepër delikate e të rëndësishme duhet t'iu ishte besuar vetëm pak njerëzve. Ishin ata që dinin hyrjet e daljet e këtyre degëzimeve të fshehta, ishin ata që dinin mënyrën e lëvizjes brenda tyre. Është kjo arësyeja që gjer në ditët tona, ata së bashku me misionet që kanë kryer, nuk na janë bërë të njohur në burimet e shkruara historike e tregimtare. Gjerësia dhe lartësia e mjaftueshme lejon që brenda kanalit të lëvizte lirshëm vetëm një njeri që mund të kthehej në hapësirën e pusetës e në asnjë vend tjetër.

Vlen të theksojmë se në ndërtimin e kalimeve të fshehta nëntokësore janë marrë për bazë të gjitha arritjet inxhinjerike bashkohore si edhe ato të mëparshmet. Kështu p.sh. zbritjet me anë të puseve vertikale i kemi ndeshur edhe në ujësjellësin antik të Durrësit (shek. II-III e.s.) sidomos në segmentin që kalon nëpër kodrat e Arapajt[18]). Pusetat si elemente pastrimi dhe ajrosje i gjejmë edhe në rrjetin e kanaleve nëntokësor të qytetit[19]). Me këto kanale, tunelet siç e vumë re edhe pak më parë kanë edhe mjaft gjera të përbashkëta si ndërtimin e formën e qemereve, trashësinë e konsiderueshme të mureve mbajtës, trasimin e tyre jo në vijë të drejtë, për t'i bërë ballë rezistencave anësore të sipërfaqes, shtrimin e dyshemesë me tulla të ngjitura me llaç, vetë materialet e ndërtimit e teknikat. Madje kemi mendimin se në ndonjë rast edhe vetë rrjeti hidrik mund të jetë bashkuar me ndonjë degëzim tuneli dhe mund të ketë shërbyer për një qëllim të tillë.

DO NOT COPY

18) F. Miraj, H. Myrto. Kumtesë e mbajtur në sesionin Arkeologjik të bërthamës shkencore Durrës (23 Nëndor 1979). Lartësia e pusetave në këtë vend është 20-25 m.
19) F. Tartari, **vep. cit.** f. 75-87.

DO NOT COPY



1



2



3



4

TAB. II



Planimetri e shtrirjes te aksit te tunelit dhe degezimit poshte kodres me kuote 59m

1

0 10 20 30 m



PRERJE TERTHORE E TUNELIT

0 25 50 cm



DETAJ QEMERI

0 10 20 30 cm



PRERJE E PUSIT TE HYRJES DHE LIDHJES SE TIJ ME TUNELIN

0 50 100 cm

4

DO NOT COPY

Fatos TARTARI

DO NOT COPY

ELEMENTS NOUVEAUX DANS LA FORTERESSE DE DURRËS DU V-VI SIECLE

RESUME

Les archéologues et les topographes étrangers qui dans le passé ont visité la ville de Durrës ont eu la possibilité d'observer et de suivre de près la configuration du périmètre de la forteresse de cette ville.

Grâce à une série de travaux effectués par nos historiens d'aujourd'hui on a pu faire des recherches sérieuses pour rattacher les grands événements historiques aux différentes périodes de la construction de la forteresse de Durrës afin de rédiger une histoire de l'architecture militaire de la ville.

Les analyses diligentes des techniques de la construction, la lecture et le déchiffrage des monogrammes et différents signes sur les briques des murs et des tours ont démontré maintenant que les trois cercles de remparts ont été complétés et achevés pendant le règne et l'activité de l'empereur byzantin Anastas I, originaire de Durrës. En outre, comme résultat des travaux d'excavation ininterrompus dans la ville, surgissent de temps en temps des éléments nouveaux de grand intérêt et qui appartiennent au système de fortification ou qui ont des liens avec ce dernier. Ces éléments aident actuellement à résoudre beaucoup de problèmes qui restent encore sans une réponse exacte et argumentée.

Au centre de cet article sont exactement deux éléments pareils: un noeud renforcé (Tour intérieure) le long du mur Nord-Ouest de la seconde enceinte et des traces sans continuation d'un passage souterrain dans les murs de ce château du moyen-âge. Dans l'état actuel des excavations et des recherches effetuées pour découvrir les embranchements intérieurs du mur sur la rue «Ismail Qemali», nous pensons, pour le premier élément, qu'il s'agit peut-être d'une tour carrée intérieure de laquelle parle aussi Heuzey et qui est située sur le mur Nord-ouest du château du V-VI siècle de notre ère. Cette tour servait à protéger la partie la plus vulnérable des fortifications. Quant au mur qui a une épaisseur de 1.15 m il doit être le plan incliné d'un escalier qui servait à monter sur la plate-forme de la tour.

L'élément le plus intéressant dans le chateau fort médiéval de Durrës est la découverte du passage souterrain. Ce passage était peut-être seul ou bien c'était un embranchement d'autres passages.

Dans les forts les plus importants de notre pays, comme à Shkodra, Kruja, Berat etc. il ne manque pas de ces passages ou entrées secrets lesquels étaient connus seulement des défenseurs du château. Par exemple, dans le fort de Shkodra on a découvert une porte secrète flanquée de deux corridors taillés dans le roc et qui permettait le passage d'une seule personne. Dans la forteresse de Berat sur la face sud on voit les traces d'une galerie de 500 à 600 m de longueur qui liait la ville haute avec le fleuve. Ainsi la deuxième entrée du château de Kruja, située à la pointe sud-est du fort communiquait par l'intermédiaire d'un tunnel. D'autre part cette entrée conduisait aux sources qui jaillissent au pied des roches situées en dehors des murs du fort.

Quoique peu nombreuses les traces que nous connaissons nous donnent quand même des indications très précieuses ayant traits aux points les plus vulnérables du système de défense. Le tunnel qui est attaché à la courtine entre les tours F et G semble appartenir (toujours suivant les données nouvelles) à la zone des collines du château fort. Nous pensons que ce passage servait aussi à contrôler les entrées de cette partie du château plus exactement entre les tours E et D, ainsi que pour toute autre porte qui peut-être existait là-bas. Il est fort possible qu'il reliait d'un côté deux hauteurs, celle de cote 59 m. avec l'acropole ou le fort supérieur à la cote 98 m. En suivant le second embranchement qui descend de la colline (c'est-à-dire la colline de cote 59 m) nous remarquons qu'il prend une direction vers le Nord-ouest de la ville, peut-être vers la porte importante du chevalier (Porta Caballina) qui s'ouvrait sur la rue et pour cela il jouait sans contredit un rôle de permier ordre dans cette partie des remparts. Une autre supposition admet la liaison directe avec le port donc avec la mer pour assurer ainsi une fuite rapide et secrète à travers ce passage.

Dans tous les exemples que nous connaissons (Shkodër, Durrës, Berat etc.) les galeries et les portes secrètes communiquent d'une manière ou d'une autre avec un cours d'eau (fleuve, lac ou mer) pour faciliter la fuite ou le retour. Ces suppositions hypothétiques doivent être contrôlées sur place en suivant de l'intérieur tous les embranchements et en cherchant tous leurs recoins. Seulement de cette manière nous pourrons les connaître

en détail et en même temps nous aurons expliqué les points qui restent encore obscurs. (Portes, alignement des murs, tours ou autre élément) pour compléter nos études sur les remparts de Durrës.

L'embranchement du tunnel en direction de la colline à cote 59 m est collé à la face interne du mur d'enceinte du V-VI siècle de notre ère. Les matériaux employés, briques et mortiers, la technique de la construction des murs de soutènement, des puits, des voûtes ont une analogie complète avec les murs d'enceinte ou tours construits à l'époque de Anastas I ainsi qu'avec ceux employés pour la construction du grand réseau de canalisation de la ville réalisé à la même époque. La voûte brisée formée avec des briques mis de champ ou bien la voûte en berceau bâtie également avec des briques mis de champ, mais qui se complétaient quelque fois avec des briques pièces isolées des canaux souterrains, des meurtrières des murs, des arcs des portes. Des exemples pareils ont été trouvés presque dans toutes les constructions du V-VI siècle de notre ère, dans la ville de Durrës, comme murs d'enceinte, canaux etc. Des briques employées de cette manière ont été remarquées dans la restauration du fort d'Elbasan au V-VI siècle de notre ère. Ainsi nous nous accordons avec la pensée de «Rey» que ces passages souterrains ont été projetés et construits en même temps que les murs d'enceinte que nous connaissons pour rendre ces derniers vraiment sûrs et imprenables. Leur emploi dans des cas très délicats et importants était confié seulement à peu de personnes. Ces personnes étaient celles qui connaissaient les entrées et sorties de ces passages secrets avec leurs embranchements et la manière de circuler dans ces passages. C'est justement pour cette raison que jusqu'à nos jours nous ne connaissons ni ces personnes ni nous ne savons rien des missions qu'elles ont accomplies du moment qu'il n'existe aucune source écrite à ce sujet.

La largeur et la hauteur suffisantes du passage permet la circulation libre d'une seule personne laquelle peut aussi se retourner sans pouvoir pour cela se rendre à aucun autre endroit. Dans la construction des passages souterrains secrets on a mis en oeuvre toutes les connaissances de l'art de la construction de l'époque et même de celles antécédentes. Ainsi par exemple les descentes par l'intermédiaire des puits verticaux se rencontre aussi dans l'aquéduc antique de Durrës (II siècle de notre ère) surtout dans le secteur qui passe sur les collines de Arapaj. Les puits comme éléments d'aération et de nettoyage se trouvent aussi dans le réseau des canaux souterrains de la ville. Ces canaux comme nous l'avons cité plus haut ont beaucoup d'analogie dans leur construction avec celle des tunnels, comme par exemple dans la construction des voûtes, la grande épaisseur des murs de soutènement, leur tracé non en ligne droite pour pouvoir résister aux poussées latérales, leur pavage en brique éxécuté avec du mortier, les matériaux employés et la technique de construction. Nous pensons que dans certains cas le réseau hydrique a pu avoir une liaison avec un embranchement du tunnel et qu'il a servi aussi dans ce but.

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI – Pirro THOMO

DO NOT COPY

ARKITEKTURA PASBIZANTINE NË SHQIPËRI. (KISHAT ME STRUKTURË NË FORMË KRYQI ME KUPOLË)

Ndryshe nga kishat pasbizantine një nefshe[1]), monumentet e këtij grupi janë më të zhvilluara si në aspektin arkitektural ashtu dhe në ndërtimin e tyre struktural. Ndërtimi i tyre planimetriko-vëllimor është i ngjashëm me atë të kishave të tipit kryq i brendashkruar me kupol mbi mbështetje të lira të periudhës përpara pushtimit turk. Në brendësi në shumicën e rasteve mbi katër kolona apo pilastra nëpërmjet harqeve mbajtës apo qemereve krijohet bërthama katrore me kupolën mbi një tambur të lartë. Në ndërtimet e periudhës pasbizantine krahas aksit vertikal ndihet më tepër aksi gjatësor si në brendësi nëpërmjet zgjatjes së krahëve perëndimor dhe lindor të kryqit ashtu dhe në anën e jashtme ku pasja e një çatie dy ujse pa ambientet këndore në nivel më të ulët, me ose pa transept, i afron ato me bazilikat me kupol. Megjithë tiparet themelore të përbashkëta, monumentet e këtij grupi paraqesin dallime të kushtëzuara dhe nga ana funksionale, në numrin e absidave. Kështu dallojmë dy nëngrupe kryesore: kishat me një absidë dhe kishat me tre absida.

KISHAT ME NJË ABSIDË

Këto ndërtime kanë si ndërtimet e tjera të kultit absidën në anën lindore që i takon bemës në brendësi.

Kisha e Manastirit të Shën Mërisë së Drianosë në Zervat të Gjirokastrës përbëhet nga naosi (pikturuar më 1569), narteksi i njëkohëshëm (pikturuar më 1583) dhe një hajat i hapur mbi arkada i shtuar më vonë në anën perëndimore. Në naos hyhet nëpërmjet narteksit drejtkëndësh në plan dhe mbuluar me qemere cilindrikë, me pjesët anësore në nivel më të ulët e formuese veri jug, ndërsa pjesën qendrore më lart dhe me formuese lindje perëndim. Narteksi ndriçohet nga një dritare e vogël në murin jugor, si dhe nga një kamare në murin verior. Nga narteksi nëpër një portë të ulët kalohet në naosin, në brendësinë e të cilit kemi katër kolonat mbi të cilat ngrihen strukturat e mbulesës. Mbi këto kolona ngrihen harqe në muret anësorë të cilët si kudo krijojnë ambiente këndore mbuluar këtu me qemere cilindrike me formuese veri jug dhe shërbejnë si mbështetje për qemeret e krahëve të kryqit. Naosi ndriçohet nga dy dritare kuadratike pak a shumë të mëdha dhe tre dritare të vogla, dy në nën frontonet e krahëve të kryqit dhe një në ambientin anësor jug perëndimor.

Ambienti i altarit ndahet nga naosi me një ikonostas druri. Ai përbëhet nga bema me absidën gjysëm rrethore dhe protezisi e diakonikoni me nga një nike gjysëm rrethore. Ndriçimi i ambientit të altarit bëhet nga një dritare në secilën nga tre absidat, të cilat në anën e jashtme janë trefaqëshe dhe mbulohen me rrasa guri.

Muret e kishës sot të suvatuara, janë ndërtuar me gurë gëlqerorë lidhur me llaç gëlqereje. Me gurë të skuadruar janë qoshet dhe anët e dritareve. Muret përfundojnë me korniza prej rrasash guri. Çatia dy ujëse e kishës ndërpritet nga mbulesat e krahëve verior e jugor të kryqit të cilat përfundojnë me frontone. Në qendër ngrihet tamburi i madh dhe i ulët,

1. Për këto monumente shih artikullin tonë të parë në këtë trajtesë: A. Meksi, P. Thomo. **Arkitektura pasbizantine në Shqipëri (kishat një nefshe)** «**Monumentet**» 19, 1980 (në shtyp).

dëshmi i kohës së hershme të ndërtimit, i cili sot ka dritare vetëm në anët lindore dhe perëndimore.

Kisha e Manastirit të Shën Mërisë në Kameno në afërsi të Delvinës është ndërtuar në vitin 1530. Ajo përbëhet nga naosi, narteksi, ambienti i altarit dhe një hajat i vogël. Kisha është e përfshirë në të njëjtin vëllim, mbuluar me çati dyujëse me rrasa guri, ku dalin në dukje krahët verior dhe jugor të kryqit, të cilët përfundojnë me frontone dhe mbulesa konike e kupolës qendrore pa tambur.

Nëpërmjet hajatit të vonë, të hapur dhe me arkadë treshe mbi pilastra, hyhet në narteksin drejtkëndësh nëpërmjet portës mbuluar me arkitra të rrafshët e një nike mbi të. Dy nike të mëdha me harqe tullash të vogla janë në të dy anët e saj. Këto nike paraqesin veçantinë që në fushën e harkut ka një nike të dytë pak të thelluar e që mbulohet edhe ajo me hark tullash. Narteksi është i mbuluar me një sistem qemerësh cilindrikë, qemere më të ulët me formuese veri-jug në anët dhe në qendër me qemer me formuese lindje-perëndim të ngritur mbi dy të tjerët. Një nike e gjerë dhe e shkallëzuar është në faqen jugore të narteksit. Mbi të ndodhet një dritare e ngushtë. Narteksi lidhet me naosin nëpërmjet tre hapësirave, një në qendër, hyrja kryesore, dhe dy të tjera pranë mureve anësorë. Në këtë mënyrë kemi një lidhje më të madhe se sa zakonisht ndërmjet naosit dhe narteksit. Naosi ka në qendër të tij kolona mbi të cilat ngrihen harqe për në muret anësorë që shërbejnë për formimin e ambienteve këndore dhe për mbështetjen e qemereve të krahëve të kryqit. Nga këta krahu lindor është më i gjatë. Në katrorin që formohet në takimin e tyre nëpërmjet trekëndëshave sferik ngrihet kupola sferike pa tambur. Ambientet këndorë nga perëndimi mbulohen me kësula sferike, ato nga lindja me qemere cilindrikë me formuese veri-jug. Naosi ndriçohet nga tre dritare, dy në anën jugore dhe një në atë veriore.

Ambienti i altarit ndahet nga naosi nga një ikonostas i drunjtë. Bema përfundon me absidën gjysëm rrethore. Po të tilla janë dhe niket, protezisi dhe diakonikoni. Tre dritare nga një në secilën prej tyre ndriçojnë ambientin e altarit. Po kështu një dritare mbi absidë në frontonin e krahut lindor. Në anën e jashtme kemi tre absida trefaqëshe nga të cilat qëndrorja është më e madhe. Absidat si dhe muret e kishës përfundojnë me korniza njëfishe tullash të vendosura në formë dhëmbësh sharre. Muret e kishës janë ndërtuar me teknikë të rregullt me gurë gëlqerorë lidhur me llaç gëlqereje dhe shumë rrallë në to takohen edhe copra tullash.

Për vetë ndërtimin vëllimor dhe planimetrik të kishës, ajo rezulton me faqe të rrafshta, që gjallërohen nga ritmi i absidave vetëm në faqen lindore. Vëllimi kompakt i saj ka një theksim të lehtë vertikal në pjesën qendrore me transeptin dhe pjesën e ngritur lehtë në formë konike të kupolës.

Kisha e Manastirit të Shën Qiriakut dhe Julitës në Dhuvjan të Gjirokastrës, ndërtuar në vitin 1588 paraqitet më e zhvilluar se kishat e tjera të tipit për ndërtimin më të zhvilluar planimetrik e vëllimor, duke patur një ambient shtesë ndërmjet krahëve të kryqit dhe murit lindor. Kisha përbëhet nga naosi, ambienti i altarit dhe narteksi, të cilave i është shtuar më vonë një hajat i mbuluar me çati që e lidh me muret mbajtëse në territorin e manastirit. Në kishë hyhet nëpërmjet narteksit mbuluar me qemere cilindrike në nivel më të ulët në anët dhe më lart në qendër dhe tërthor të parëve, duke rezultuar në këtë mënyrë si vazhdim i qemerit të krahut perëndimor të kryqit, pra në një çati me të. Ndriçimi i narteksit bëhet nga një dritare e ngushtë në anën veriore dhe një tjetër në anën jugore mbi kamaren.

Në naos hyhet nëpërmjet narteksit. Në brendësi të tij kemi gjashtë kolonat që mbajnë strukturat e çatisë, katër për të formuar kryqin dhe dy në ambientin e altarit. Nga të tëra kolonat dalin harqe për në muret anësorë, gjithashtu me harqe lidhen kolonat në lindje të kupolës. Mbi këtë sistem harqesh ngrihen qemeret e krahëve të kryqit, të ambienteve këndorë dhe të pjesës shtesë në anën lindore. Ambientet këndore të naosit mbulohen me kësula sferike ndërsa ato të ambientit të altarit me qemere cilindrikë me formuese lindje-perëndim. Në kryqëzimin e qemereve formohet katrori prej të cilit me trekëndësha sferikë formohet baza rrethore për tamburin cilindrik e kupolën mbi të. Ndriçimi i naosit bëhet nga 4 dritaret e tamburit, dhe nga dy dritare një e madhe dhe një e vogël mbi të, në krahët verior e jugor të kryqit.

Ambienti i altarit ka bemën me absidën gjysëm rrethore, protezisin e diakonikonin me nga një nike gjysëm rrethore. Një kamare është gjithashtu në anën veriore. Ndriçimi i ambientit bëhet nga tre dritare të vogla, nga një për çdo pjesë dhe një tjetër mbi absidë. Nga këto dritarja e absidës është në anën e jashtme në formë kryqi dhe ka mbi të një nike me harqe të shkallëzuar prej tullash, por që sot si gjithë kisha është e suvatuar.

Muret e kishës janë me gurë gëlqerorë të nxjerrë nga formacionet e shtresëzuara dhe lidhur me llaç gëlqereje. Ata përfundojnë me kornizë të thjeshtë prej guri. Mbi to vijon çatia dy ujëse prej rrasash guri që ndërpritet prej transeptit, mbulesa e qemereve të krahut verior e jugor të kryqit, dhe prej tamburit me kupolën. Në timpanin e secilit fronton ndodhet një dritare kuadratike ndërsa nën të drita-

DOWNLOAD

rja tjetër e madhe kuadratike me një nike mbuluar me harqe të shkallëzuara tullash.

Tamburi i kupolës ngrihet mbi një bazament paralelpipedik. Ai ka tetë faqe ku alternohen dritare e nike mbuluar me harqe të shkallëzuara tullash. Tamburi përfundon me kornizë të rrafshtë e mbi të çatia konike. Kisha shquhet për vëllimin kompakt, linjat e drejta e faqet e rrafshta. Ajo i përmbahet formave që më vonë i gjejmë në tërë kishat e këtij tipi.

Kisha e manastirit të Shën Thanasit në Poliçan të Gjirokastrës[2], përbëhet nga naosi me ambientin e altarit dhe narteksi i vonë. Mbi katër kolona prej rrotullash guri lidhur me llaç ngrihen qemerët që shërbejnë si harqe mbajtës për kupolën. Duke qënë kolonat më afër në drejtimin lindje perëndim, për t'u formuar katrori për tamburin dhe kupolën, qemeret e krahëve verior dhe jugar janë më të ngushtë dhe më brenda kolonave, duke rezultuar kupola me diametër të vogël. Nga kolonat në muret lindor dhe perëndimor kalojnë harqe rrethorë, që ndajnë ambientet këndorë nga krahët përkatëse të kryqit. Nën influencën me sa duket të kishës së Shën Thanasit të Mazharit po në Poliçan të fillimit të shekullit XVI, këto ambiente mbulohen me qemere me hark çerek rrethi.

Naosi ndriçohet nga dritaret e tamburit, një dritare kuadratike në anën jugore dhe nga një dritare e ngushtë mbuluar me hark në anën veriore e jugore. Ambienti i altarit ndahet nga naosi me një ikonostas druri pa vlera të veçanta. Në murin lindor të tij kemi bemen-absidë gjysëm rrethore dhe protezisin e diakonikonin – nike gjysëm rrethore. Një kamare është në anën jugore. Ambienti i altarit ndriçohet nga dritarja dyshe në absidë dhe dritare të ngushta në niket. Në anën e jashtme absida është trefaqëshe, ndërtuar si dhe muret e kishës me gurë e llaç gëlqereje. Dritarja dyshe ka një kolonë gurë çmërsi në mes dhe mbulohet me hark prej tullash të rrethuara me një shirit tullash të vendosura në formë dhëmbësharre.

Në anën perëndimore, kishës në një kohë të dytë, i ishte shtuar një narteks i cili duket ka qënë mbuluar me qemer cilindrik me formuese veri-jug, gjurmë të të cilit ruhen si në faqet veriore e jugore ashtu edhe në mbështetjen e tij në murin lindor që e lidh me kishën. Muri perëndimor që përfundon me fronton, është më i ri, i rindërtuar kur është rrëzuar dhe qemeri. Në narteks hyhet nga porta në anën perëndimore mbuluar me arkitra guri, mbi të cilën është një nike e pikturuar. Narteksi ndriçohet nga dy dritare të mëdha mbuluar me hark në anën perëndimore dhe dritare të vogla si të naosit në veri e jug. Një portë sot e mbyllur ka qënë në anën veriore.

Kisha mbulohet me çati dy ujëse, që me sa duket fillimisht ka qënë mbuluar me rrasa guri. Tërthor saj, në formën e një transepti dalin çatitë e krahëve veriore dhe jugore të kryqit, që përfundojnë me frontone. Muret e kishës përfundojnë me kornizë njëfishe tullash të vendosura në formë dhëmbësh sharre. Në qendër të çatisë mbi një bazament rrethor ngrihet tamburi tetëfaqësh me koloneta në qoshet dhe nga një dritare për secilën faqe. Faqet e tamburit janë të shkallëzuara dhe përfundojnë me harqe tullash. Tamburi është i ndërtuar me një rradhë gurë çmërsi dhe tre rradhë tullash, që këmbehen me njëri tjetrin. Harku mbi kolonetat është i ndërtuar me gurë çmërsi. Fusha mbi këto harqe e deri në kornizën dyfishe prej tullash dhëmbë sharre është e ndërtuar me tulla të vendosura mjaft në rregull.

Duke krahasuar pikërisht mënyrën e ndërtimit dhe zbukurimin e tamburit duket qartë se kishën e ka ndërtuar e njëjta atelje që punon në këto zona në vitet 80 të shekullit 16 dhe që ndërtoi në Vanishtë (1583) e gjetkë. Për këtë arsye mendojmë që këtyre viteve duhet t'i takojë dhe kjo kishë.

Kisha e Shën Mërisë së Malçanit në rrethin e Sarandës përbëhet nga kisha e vjetër dhe narteksi i shtuar më vonë. Kisha që shquhet për format primitive, ka në brendësi katër pilastra të lira me prerje katrore, nga të cilat në muret anësore kalon një sistem harqesh që formon në këtë mënyrë ambientet këndore të cilët mbulohen me qemere cilindrikë me formuese lindje-perëndim. Dy pilastra në murin perëndimor shërbejnë për mbështetje, të harqeve të mësipërm, duket nga që krahu perëndimor i kryqit është më i gjatë se të tjerët. Mbi këtë sistem harqesh ngrihen qemeret e krahëve të kryqit, të cilët janë në lartësi duke i dhënë kishës një vertikalitet i cili theksohet akoma më tepër nga tamburi me kupolën. Tamburi ngrihet mbi katrorin që formojnë qemeret e krahëve të kryqit me një sistem trekëndëshash sferikë pak a shumë të rregullt. Tamburi është i ulët po të krahasohet me lartësinë e qemereve nga toka, të cilët i japin brendësisë sensin e vertikalitetit. Naosi ndriçohet nga dritaret e tamburit dhe ato nën frontonet e krahëve verior dhe jugor të kryqit.

Ambienti i altarit ka bemën me absidën gjysëm rrethore në brendësi dhe shtatëfaqëshe në anën e jashtme dhe një nike si protezis. Ambienti i altarit

2) A. Meksi, **Restaurimi i kishës së manastirit të Shën Thanasit në Poliçan.** «Monumentet» 7-8, 1974, 277-287.

DOKUMENTOJ

DO NOT COPY

ndriçohet nga dritarja e ngushtë e absidës dhe dy dritare drejtkëndëshe anash saj.

Në anën perëndimore si zakonisht ndodhet narteksi i cili duke gjykuar nga teknika më e rregullt e ndërtimit, brezat e drurit, mbulimi me çati druri dhe fuga në anën veriore, duhet të jetë më i vonë. Në narteks hyhet nga ana perëndimore. Ai lidhet me naosin nga porta në faqen perëndimore të tij. Naosi ka gjithashtu një portë në anën jugore që mund të jetë hapur dhe më vonë. Muret e kishës janë ndërtuar me gurë gëlqerorë dhe llaç gëlqereje. Në qoshet gurët janë skuadruar dhe nuk janë mbuluar nga shtresa e vonë e suvasë. Muret përfundojnë me kornizë dhëmbë sharre të njëfishtë.

Siç thamë dhe më lart në anët veriore dhe jugore krahët përfundojnë me frontone duke formuar edhe në çati kryqin. Në qendër të tij mbi një bazament kuadratik ngrihet tamburi i ulët dhe 12 faqësh ndërtuar kryesisht me tulla. Në pjesën e poshtme ka një brez të ngushtë me tulla të vendosura klliç që alternohen me gurë kuadratik. Mbi to një brez i dytë ku janë niket dhe dritaret të shkallëzuara dhe mbuluar me harqe. Ndërsa në brinjët e faqeve ku koloneta me gurë e tulla, dritaret dhe niket bashkë me harqet që mbulojnë ato janë tërësisht me tulla. Mbi këtë brez është një i tretë me tulla të vendosura vertikalisht dhe 45° me gurë ndërmjet tyre. Tamburi përfundon me kornizë me tulla dhëmbësh sharre dhe tre rreshta gurësh mbi të.

Në tërësi në anën e jashtme mbizotëron vertikaliteti, faqet e rrafshta dhe vëllimi kompakt që kurorëzohet nga kupola të zbukuruar së tepërmi edhe pse me një shije primitive dhe të pa proporcionuar mirë me kishën. Kisha i përmbahet në vija të përgjithshme ndërtimit vëllimor të kishave pasbizantine të fundit të shekullit XVI dhe fillimit të shekullit XVII, periudhë në të cilën ajo duhet të jetë ndërtuar.

Kisha e Shën Mërtirit në Tranoshisht të Gjirokastrës ndërtuar në vitin 1617 përbëhet nga naosi me ambientin e altarit dhe narteksi me një hajat në anën jugore të shtuar vonë. Në naos hyhet sot nëpërmjet portës që e lidh me narteksin në murin perëndimor. Në planimetri kisha është katrore me katër kolona në mes për të formuar strukturën me kupol mbi tambur. Nga kolonat kalojnë harqe në muret perëndimorë e lindorë të cilët shërbejnë si për ngritjen e qemereve të ambienteve këndorë me formuese lindje-perëndim ashtu dhe për qemerët e krahëve të kryqit. Mbi qemeret e krahut të kryqit në katrorin e formuar prej tyre nëpërmjet trekëndëshave sferik ngrihet tamburi cilindrik me kupolën, i cili është i tillë dhe në anën e jashtme. Naosi ndriçohet vetëm nga katër dritaret e ngushta të tamburit.

Ambienti i altarit ka absidën gjysëm rrethore dhe nga dy kamaret në pjesët që i takojnë protezisit e diakonikonit. Ai ndriçohet vetëm nga dritarja e vogël e absidës. Të tre pjesët e ambientit të altarit mbulohen me qemere cilindrike, më i lartë ai në qendër që i takon bemës. Në anën e jashtme absida është tre faqëshe.

Narteksi i vonë i ndarë me fugë të qartë nga kisha përbëhet nga ambienti drejtkëndësh në anën perëndimore të kishës më i gjatë se kjo dhe hajati që lidhet me të në tërë faqen jugore të kishës. Të dy këta janë mbuluar me çati druri treujëse e rrasa guri. Në narteks hyhet nga porta mbuluar me hark në anën veriore dhe porta që e lidh me hajatin. Ai ndriçohet nga një dritare në anën perëndimore.

Muret e kishës janë me gurë të çrregullt të lidhur me llaç në rreshta horizontalë dhe përfundojnë me një kornizë të thjeshtë rrasash. Mbi çatinë dalin si vëllime të veçanta në formën e një transepti krahët verior dhe jugor të kryqit të cilët përfundojnë me frontone. Në kryqëzimin e çative kemi tamburin, sot të suvatuar që përfundon me një kornizë të thjeshtë. Në anën e jashtme kisha paraqitet mjaft e proporcionuar dhe kompakte.

Kisha e Shën Kollit në Saraqinisht të Gjirokastrës ndërtuar në vitin 1630, përbëhet nga naosi, ambienti i altarit, narteksi i vonë dhe një hajat i ri në anën perëndimore. Naosi që përbën fazën e parë të ndërtimit ka në brendësi katër kolona prej rrotullash guri të lidhura me llaç mbi të cilat mbështeten qemeret e krahëve të kryqit. Në kryqëzimin e tyre nëpërmjet trekëndëshave sferik bëhet kalimi nga bërthama katrore në tamburin cilindrik me kupolën. Ambientet këndorë që janë në nivel më të ulët mbulojnë ata nga lindja me kësula të ulta sferike, ndërsa ata nga perëndimi me një qemer në formë të çrregullt. Ai ka një ndërtim të përafërt me një të katërtën e një qemeri të kryqëzuar duke patur të kurbëzuar pjesën brinjore. Naosi ndriçohet nga dy dritare dyshe në krahët verior dhe jugor dhe dritare si frengji në këto dy faqe. Në të hyhet si nga porta në anën perëndimore që e lidh me narteksin ashtu edhe nga një portë në anën veriore. Muret janë ndërtuar me gurë gëlqerorë e shtufi lidhur me llaç e gëlqereje.

Ambienti i altarit ndahet nga naosi me një ikonostas druri të gdhendur. Ai përfundon me absidën rrethore, trefaqëshe në anën e jashtme, të zbukuruar me tri nike, nga një për secilën faqe, që nuk shkojnë në tërë lartësinë e absidës.

Muret anësore të kishës përfundojnë me frontone mbi të cilët është çatia me rrasa guri prej katër flegrash jo plane me kulmet tek frontonet dhe ulluqet te qoshet e ndërtesës. Në qendër të saj është tamburi i cili nuk ka më bazamentin karakteristik të kishave bizantine por del direkt nga çatia. Tamburi

është tetëfaqësh i suvatuar dhe ka alternativisht dritare dhe nike për secilën faqe. Si niket dhe dritaret mbulohen me harqe të shkallëzuara. Tamburi përfundon me kornizë horizontale të trefishtë prej gurësh të vendosur në formë dhëmbësh sharre.

Narteksi i kishës është mbuluar me çati druri struktura e së cilës mbështetet në muret anësorë dhe në dy rradhë shtyllash druri që e ndajnë atë në tre pjesë. Në narteksin hyhet nga ana perëndimore që e lidh me hajatin e hapur mbuluar me çati mbi pilastra guri e shtylla druri.

Kisha e Manastirit të Shën Kollit të Spilesë mbi fshatin Saraqinisht përbëhet nga naosi (pikturuar në 1634) dhe narteksi i njëkohshëm me të (pikturuar më 1659) dhe një portik i vogël mbuluar me kupolë katror në plan dhe me arkada në anën jugore të narteksit, nga i cili bëhet hyrja për në kishë. Narteksi drejtkëndësh në plan mbulohet nga një sistem qemeresh, cilindrikë më të ulët të anës, më i larti qëndrori sipas një zgjidhje tashmë tradicionale. Narteksi ka një nike gjysëm rrethore në murin jugor dhe një kamare në atë perëndimor. Prej narteksit hyet në naosin nëpërmjet një porte në murin e përbashkët me të. Porta mbulohet me arkitra të rrafshët.

Naosi ka në brendësi katër kolona mbi të cilat ngrihen harqe për në muret anësorë të kishës duke shërbyer për mbajtjen e qemereve të krahëve të kryqit dhe për krijimin e mbështetjeve për mbulesën e ambienteve këndorë. Ambientet këndorë nga perëndimi mbulohen me qemer cilindrik çerek rrethi, ata nga lindja me qemer të çrregullt, vazhdim i trekëndëshave sferik të qosheve.

Mbi qemeret e krahëve të kryqit nëpërmjet trekëndëshave ngrihet tamburi mbi kupolën. Tamburi cilindrik në brendësi ka katër dritare të cilat së bashku me dritaret e tjera ndriçojnë bollshëm naosin. Këto dritare janë dy kuadratike në pjesën e poshtme në anën veriore dhe jugore dhe një dritare dyshe sipër në anën jugore.

Ambienti i altarit përbëhet si kudo nga bema mbuluar me qemerin cilindrik të krahut të kryqit nga absida gjysëm rrethore, nga protezisi me diakonikonin që janë ambientet këndore. Në veri kemi niken gjysëm rrethore e një kamare, në jug një kamare e madhe. Ambienti i altarit ndriçohet nga një dritare në absidë e nga një në protezis. Në anën e jashtme absida është pesë faqëshe me nike vetëm në pjesën e sipërme, mbi të cilat kalon një shirit tullash të vendosura në formë dhëmbësh sharre. Po me dhëmbë sharre është edhe korniza nën çatinë e absidës.

Muret e kishës janë me gur gëlqeror lidhur me llaç gëlqereje me tendencë horizontale të rradhëve të suvatuara po me llaç gëlqereje. Ky suvatim duhet të jetë i vonë sepse nuk mbulon tërë sipërfaqen e mureve. Kështu pranë portikut kemi një pjesë të mirë të ndërtuar me gurë të mëdhenj që është e pa suvatuar. Muret kanë në pjesën e sipërme nga një kornizë me rrasa gurësh dhe përfundojnë në anët veriore, jugore dhe lindore të naosit me frontone. Po me fronton është çatia në anën perëndimore të narteksit. Në takimin e çative të krahëve të kryqit kemi tamburin tetëfaqësh me katër dritare të ngushta e të larta dhe që ka një kornizë trefishe me gurë të vendosur në formë dhëmbësh sharre.

Kisha e manastirit të Shën Mërisë së Krorezit në rrethin e Sarandës[3] ndodhet mbi një breg shkëmbor mjaft piktoresk të detit Jon. Kisha e pikturuar në vitin 1672, përbëhet nga një vëllim unik dhe ka në brendësi naosin të ndarë nga ambienti i altarit nëpërmjet një ikonostasi prej muri të suvatuar. Në kishë hyhet me disa këmbë shkallë nga porta në anën perëndimore mbuluar me arkitra të rrafshtë e një kamare mbi të. Dyshemeja e kishës është shtruar me pllaka drejtkëndëshe dhe ka një rozetë në pjesën nën kupolë me një yll gjashtë cepash në mes. Mbi katër kolona me prerje rrethi dhe muret anësorë mbështetet sistemi i mbulesës me harqe dhe qemere. Nga kolonat kemi harqe që mbështeten në muret anësorë veriorë dhe jugorë dhe harqe ndërmjet tyre, si harqe mbajtës vetëm në drejtimin veri jug të cilët bëhen në kyç një me qemerët e krahëve lindor dhe perëndimor të kishës. Krahët verior dhe jugor mbulohen si zakonisht me qemere, ndërsa këtu edhe ambientet këndorë janë mbuluar me qemere që hapen ndaj aksit qendror të kishës, sipas një tipologjie karakteristike për kishat pasbizantine, por që për shkak të afrimit të kolonave me muret anësorë ngjason me kishat e tipit sallë me kupol.

Në pjesën katrore që formohet në takimin e qemereve të krahëve të kryqit me ndihmën e trekëndëshave sferik formohet rrethi ku pas një kornize ngrihet tamburi me kupolën. Tamburi ka katër dritare të vendosura në një kënd 45° ndaj akseve të kishës. Në anën e jashtme ai del mbi çatinë prej rrasa guri dyujëse të kishës nëpërmjet një bazamenti katror me çati të ulura në qoshet. Tamburi që është i suvatuar ka njëzet faqe të ngushta pak të harkuara përbrenda dhe përfundon me një kornizë prej dy rradhësh gurësh të hollë. Dritaret janë të ngushta e drejtkëndë-

3) A. Meksi. **Arkitektura e kullës si banesë.** «Monumentet» 2, 1971.

DO NOT COPY

she. Në faqen perëndimore del gjithashtu mbi çati një këmbanore e thjeshtë.

Në anën lindore të kishës, ambienti i altarit, kemi bemën gjysëm rrethore dhe dy nike pranë saj. Në muret veriore dhe jugorë ka gjithashtu nga një kamare. Në anën e jashtme del absida shtatëfaqëshe me gurët në rreshta horizontalë. Mbi absidë si dhe në fasadën perëndimore ka patur për zbukurim pjata.

Naosi i kishës ndriçohet nga dy dritare të ngushta në muret veriorë dhe jugor dhe dritaret e tamburit, ndërsa ambienti i altarit nga dy dritare mjaft të ngushta në bemën dhe dy niket pranë saj.

Muret e kishës janë ndërtuar me gurë të çrregullt e llaç gëlqereje duke patur rradhët tendencë horizontaliteti. Ato përfundojnë me kornizë guri. Në anën perëndimore është shtuar një mur me një hapësirë të harkuar në mes që mbledh ujërat e çatisë për të kaluar në sterën e ndërtuar pranë në anën veriore.

Kisha e manastirit të Shën Triadhës në Pepel të rrethit të Gjirokastrës është ndërtuar në vitin 1750. Ajo përbëhet nga naosi, ambienti i altarit dhe narteksi i njëkohshëm me ta. Në kishë hyhet nga porta jugore e narteksit nëpërmjet një portiku me absida me këmbanën pranë mbi murin e kishës. Narteksi është me planimetri drejtkëndëshe më të gjerë se zakonisht dhe për këtë arsye në brendësi të tij janë dy kolona mbi të cilat në drejtimin veri-jug kalon një arkadë që bën të mundur dhe mban mbulesën me struktura qemeresh të narteksit. Krahu perëndimor mbulohet me qemere të përbërë, çerek rrethi, ndërsa zona në lindje të arkadës mbulohet me qemer të tillë anash dhe qemer cilindrik në nivel më të lartë në qendër. Narteksi ndriçohet nga një dritare kuadratike në veri dhe një tjetër e ngushtë në perëndim.

Nga narteksi nëpër portën mbuluar me arkitra të rrafshtë e një nike mbi të hyhet në naos. Në brendësi të tij ka si zakonisht katër kolona mbi të cilat kalon një sistem harqesh, qemeresh të përbërë dhe kupolash pa tambur. Me kupola mbulohen pjesa ndërmjet kolonave dhe krahu lindor i kryqit ndërsa me qemere të përbërë gjithë krahët e tjerë dhe ambientet këndorë. Siç mund të kuptohet, struktura dallon nga ajo e tipit për t'u afruar me ato të bazilikave nga të cilat e dallon mungesa e një aksi gjatësor. Naosi ndriçohet nga katër dritare drejtkëndëshe të mëdha tregues i qartë i një ndërtimi të vonë të kishës.

Ambienti i altarit ndahet nga kisha nga një ikonostas druri. Ai përbëhet prej bemës mbuluar me kupol dhe protezisit e diakonikonit me qemere të përbërë. Absida gjysëm rrethore pesë faqëshe në anën e jashtme ka një dritare të ngushtë, dy të tjera të tilla janë në nivel më të lartë, anash saj për ambientet anësore. Një kamare është në murin verior, një nike për protezisin dhe dy dritare të tjera në jug e një në veri.

Kisha është e ndërtuar me gurë të nxjerrë nga formacione të shtresëzuar dhe lidhur me llaç gëlqereje. Ata mbarojnë me korniza guri e mbi të çatia katërujëse me rrasa guri në të cilën ndihen pjesët e mbuluara me kupolë. Trajtimi arkitektonik i kishës rezulton në këtë mënyrë mjaft i varfër dhe afrohet me atë të konakëve të manastirit.

Kisha e manastirit të Shën Mitrit në Qeparo të rrethit të Vlorës është ndërtuar në vitin 1760 dhe përsëri në vijat kryesore tipin planimetrik të cilin e hasim në Krorëz dhe Kakome. Në kishë hyhet nga porta e vetme në anën perëndimore mbuluar me arkitra të rrafshët mbi të cilën ndodhet dhe mbishkrimi ndërtimor. Në brendësi ndodhen katër kolona të vendosura në kulmet e një drejtkëndëshi. Harqet mbajtës për kupolën në anët veriore dhe jugore, janë qemeret e krahëve të kryqit, ndërsa në anët lindore dhe perëndimore kemi harqe të mirëfilltë mbajtës. Duke qënë këta të fundit në kuotë më të lartë se kyçet e qemereve të krahëve verior dhe jugor, baza rrethore e tamburit formohet me sipërfaqe pak të kurbëta afërsisht vertikale, në kuotë më të lartë dhe me prerjen tërthore më të vogël se drejtkëndëshi i kolonave. Kjo zgjidhje ngjan me atë të kishës së manastirit të Shën Thanasit në Poliçan, por që këtu nuk arrin të njëjtin efekt arkitektonik. Qemeret e ambienteve këndor janë me prerje më të vogël se gjysma e rrethit dhe hapen ndaj aksit gjatësor të kishës. Mbrapa një ikonostasi është ambienti i altarit me bemën gjysëm rrethore, niket e protezisit dhe diakonikonit anash saj dhe një kamare në anën veriore. Brendësia ndriçohet nga katër dritaret e tamburit dhe një dritare drejtkëndëshe nën krahun jugor të kryqit.

Muratura e kishës ka tendencë rreshtash horizontalë dhe është me gurë të çrregullt lidhur me llaç gëlqereje. Në qoshet ka gurë të skuadruar më të mëdhenj. Muret si dhe absida përfundojnë me kornizë njëfishe gurësh të vendosur në formë dhëmbësh sharre. Çatia është mbuluar me tjegulla vendi. Ajo është me dy kullime dhe ka në qendër mbi një bazament të çrregullt cilindrik e të ulët tamburin cilindrik e të suvatuar.

Kisha e Shën Vasilit në fshatin Përparim (Shën Vasi) të rrethit Sarandë ndodhet në një breg në lindje të fshatit. Përbëhet nga naosi me ambientin e altarit dhe një narteks mjaft i vonë në anën perëndimore. Në brendësi ka formën e tipit me katër kolona në qendër dhe formën e zakonëshme të krahëve të kryqit mbuluar me qemere e cila nuk del në

DO NOT COPY

DO NOT COPY

çatinë dyujëse, me tjegulla. Mbi të ngrihet vetëm tamburi me kupolën. Tamburi është cilindrik dhe ka tetë nike të mbuluara me hark dhe katër dritare të vogla të vendosura 45° ndaj akseve kryesore. Karakteristikë është këtu gjatësia më e madhe e krahëve lindor e perëndimor ndaj atyre verior dhe jugor që i jep ndërtesës një aks gjatësor. Gjithashtu ambientet këndorë mbulohen me qemere cilindrikë me formuese veri jug pra hapen ndaj pjesës qëndrore. Naosi ndriçohet dhe nga dy dritare relativisht të mëdha drejtkëndëshe në anën e poshtme dhe mbuluar me hark në anën e brendëshme.

Ambienti i altarit ndahet nga naosi nga një ikonostat druri pa vlerë. Ai përfundon në anën lindore me absidën gjysëm rrethore të trajtuar në anën e jashtme me tre nike mbuluar me hark që shkojnë deri afër tokës.

Duke u nisur nga trajtimi i jashtëm, teknika e ndërtimit mendojmë se kisha duhet të jetë ndërtuar në fund të shekullit XVIII ose në fillim të shekullit XIX.

KISHAT ME TRE ABSIDA

Karakteristikë e këtij grupi kishash, manastiresh, është pasja e tre absidave krahas rolit funksional ndikojnë në krijimin e një aksi vertikal qendror më të theksuar.

Kisha e manastirit të Ungjillzimit në Vanistër të Gjirokastrës ze pjesën qendrore të manastirit mjaft interesant ndërtuar mbi fshat. Kisha e ndërtuar në vitin 1582 përbëhet nga naosi dhe ambienti i altarit, narteksi i shtuar në vitin 1617 dhe një hajat në anën perëndimore mbuluar me çati druri që lidh kishën me një mur teracimi të brendshëm të manastirit; duke shërbyer si pjesë kalimi për të lidhur krahët verior dhe jugor të konaqeve. Kisha ka në brendësi katër kolona ndërtuar prej rrotullash guri mbi të cilat si në gjithë kishat e këtij tipi ngrihen qemeret e krahëve të kryqit prej kolonave në muret anësorë dhe kupola mbi tambur në pjesën qendrore katrore në plan.

Ambientet këndorë janë mbuluar me qemere me formuese veri-jug që hapen ndaj pjesës qëndrore. Krahët verior dhe jugor përfundojnë me absida mbuluar me konke çerek sfere duke marrë në planimetri kisha formën tradicionale, të kishave të manastirëve. Ndriçimi i naosit bëhet nga dritaret e absidave anësore dhe tamburi i kupolës. Absidat anësore duke patur për zbukurim nga shtatë nike të ngushta mbuluar me harqe tullash.

Ambienti i altarit ndahet nga naosi me një ikonostas druri. Ai ka bemën gjysëm rrethore dhe dy niket e vogla gjysëm rrethore të protezisit dhe diakonikonit si dhe një nike në anën veriore. Ambienti i altarit ndriçohet nga dritaria dyshe e absidës dhe dy dritare të ngushta në niket anash saj. Në anën e jashtme absida është tre faqëshe me nga një nike që nuk shkon deri në tokë për secilën faqe. Niket përfundojnë me hark tullash brenda një kornize prej tullash të vendosura në formë dhëmbësh sharre. Fusha e harkut që është më brenda murit, është e suvatuar dhe mbulohet me hark tullash. Në niken e mesit është dritarja dyshe e absidës mbi të cilën si zbukurim kemi një nike rrethore të mbuluar me hark tullash të rrethuara nga shiriti prej tullash dhëmbë sharre. Muret me gurë gëlqerorë të rregullt të absidës përfundojnë me kornizë të dyfishtë tullash të vendosura në formë dhëmbësh sharre. E vetmja portë e hyrjes për në kishë është ajo në murin perëndimor, që lidh atë me narteksin. Ky mbulohet me qemere më të ulët në anët veriore e jugore e një qemer më të lartë në pjesën qëndrore. Ai ndriçohet nga dy dritare të ngushta në muret anësorë.

Siç pamë dhe më lart hajati në anën perëndimore është krijuar si një kalim i mbuluar jo vetëm për kishën por dhe për të ndërlidhur të dy krahët e konakëve të manastirit atë verior dhe jugor me ambientet ndihmëse.

Në anën e jashtme kisha është trajtuar me faqe të rrafshta prej gurësh të rregullt lidhur me llaç gëlqereje duke u fragmentuar këto faqe nga absidat. Në pjesën e sipërme muret kanë kornizën e dyfishtë me tulla të vendosura në formë dhëmbësh sharre. Kisha është e mbuluar me çati dyujëse me rrasa guri duke patur në pjesën qëndrore në formë transepti mbulesën e krahëve verior dhe jugor të kryqit, që dalin me frontone në muret anësore. Në pjesën qëndrore të transeptit është bazamenti drejtkëndësh i tamburit. Tamburi tetë faqësh përbën një gjymtyrë me vlerë dhe pjesën më të zbukuruar të kishës. Ai ka në secilën faqe nike të shkallëzuara mbuluar secila me hark tullash. Në qoshet e faqeve ka nga një kolonet mbi të cilat ngrihen harqe me gurë e tulla që alternohen. Një kornizë e valëzuar tullash dhëmbë sharre ndjek përgjatë faqeve të tamburit këto harqe. Pjesa mbi të është ndërtuar me gurë dhe përfundon me kornizën dyfishe dhëmbë sharre prej tullash mbi të cilën kemi çatinë me rrasa guri të kupolës. Pjesa nën harqet e faqeve të tamburit është e ndërtuar me gurë dhe tulla, një rresht gurësh tre rreshta tullash që ndërpriten nga dritaret që alternohen me niket.

Në aspektin arkitektonik kisha shquan për trajtimin e hijshëm të tamburit dhe të absidave anësore, ndërsa janë pak a shumë rigoroze faqet anësore,

absida lindore për arsye të materialit të përdorur dhe zbukurimit të pakët. Në tërësinë e manastirit, ku oborri është minimal, kisha paraqitet mjaft kompakte dhe përbën ndërtesën kryesore rreth së cilës është organizuar i tërë kompleksi.

Kisha e manastirit të Shën Mërisë së Ravenjës mbi Goranxi të Gjirokastrës, pikturuar në vitin 1600 përbën një shembull me vlera të rëndësisë së dorës së parë për arkitekturën pasbizantine. Kisha përbëhet nga naosi, ambienti i altarit, narteksi dhe një ekzonarteks sot i mbyllur por dikur në formën e një hajati të hapur. Në kishë hyhet pikërisht nëpërmjet këtij ekzonarteksi nga porta e mbuluar me hark të mprehtë. Anash saj janë dy dritare mbuluar me hark të mprehtë, dy të tjera si këto në anët veriore dhe jugore. Këto më vonë janë murosur, duke shërbyer këto mbushje si mbështetje të sistemit me qemere që mbulon ekzonarteksin. Qemeret janë cilindrike, më të ulët në anët e me formuese veri-jug, më i larti i mesit me formuese lindje perëndim. Në pjesën e sipërme të mureve veriorë dhe jugorë ruhet fuga me kishën që tregon për një shtim të këtyre mureve bashkë me mbulesën.

Hyrja për në narteks është një portal i vërtetë mbuluar me hark të mprehtë dhe shpatulla të profiluara me hijeshi. Narteksi mbulohet me kupolë në pjesën qendrore dhe me qemere anash saj dhe në nivel më të ulët për ta mbajtur atë. Narteksi ndriçohet nga dritare drejtkëndëshe në anët veriore dhe jugore. Narteksi lidhet me naosin me tre kalime. Një portal me hark të mprehtë si i pari në qendër dhe dy të tjerë të mbuluar me hark rrethor pranë mureve anësorë. Në brendësi të naosit janë katër kolonat me kapitele me dekor bimor. Mbi ta kalojnë harqe në muret anësorë duke formuar ambientet anësorë mbuluar me kësula sferike. Mbi këta harqe ngrihen në nivel të lartë dhe qemeret cilindrike të krahëve të kryqit. Në krahët verior dhe jugor kemi absida gjysëm rrethore. Në katrorin që formohet nga krahët e kryqit nëpërmjet tre trekëndëshave sferik ngrihet tamburi i lartë me kupolën. Naosi ndriçohet nga katër dritaret e kupolës, dritaret e absidave dhe dritare kuadratike mbi to.

Brendësia shquan për proporcionet e goditura, për sensin vertikal, për përpunimin e detajeve. Në anën e jashtme shfaqen më tepër se në çdo kishë të kohës vlerat e këtij monumenti. Muret janë ndërtuar me gurë gëlqerorë të vendosur me rreshta të rregullt. Muret përfundojnë me kornizë prej pllakash guri, ndërsa absidat me kornizë me dyfish dhëmbësh sharre po prej gurësh të gdhendur. Absidat janë pesë faqëshe duke patur në qoshet koloneta guri të gdhendur mbi të cilat ka kapitele të thjeshtë dhe kalojnë harqe rrethorë që ndërthurren duke krijuar harqe të mprehtë. Këto harqe e koloneta që mveshin absidën, edhe i japin lëvizje asaj dhe e unifikojnë. Më e ndryshme është kjo në anën lindore ku anash absidës së madhe njëlloj si të tjerat ka dhe absida të vogla me dy faqe që e bëjnë akoma më elegante ritmin e kolonave dhe harqeve mbi të, më të vegjël, anash, të mëdhenj në qendër. Absida ka në mes një dritare dyshe me hark të mprehtë. Gjithashtu mbi harqet ka skulptura njerëzore e zoomorfe.

Mbulesa e kishës përfundon në anët veriore dhe jugore e lindore me frontone, në qendër të saj kemi tamburin me kupolën. Tamburi tetë faqësh ka në çdo faqe koloneta me kapitele e harqe mbi to. Harqe të tjerë nisin nga mesi i çdo faqeje mbi dritare apo nike me gurë të gdhendur, duke krijuar të njëjtin dekor që haset në absidat. Nën harkun e çdo dritareje e mbi çdo kolonet kemi dhe këtu skulptura. Edhe korniza e tamburit është dyfishe dhëmbësharre si e absidave. Në anën e jashtme nëpërmjet thyerjes së faqeve nga absidat, kolonetat me harqe, çatitë me frontone ndihet së tepërmi vertikaliteti i monumentit. Ky kurorëzohet dhe theksohet më tepër me tamburin e lartë.

Monumenti është me vlera mjaft të mëdha të arkitekturës dhe dekorit, është dëshmi e nivelit të lartë të ndërtuesve të saj. Harkadat me harqet e mprehtë, këto të fundit në brendësi, kapitelet e kolonave të naosit flasin qartë për influencën e arkitekturës perëndimore. Harqet fund lundre flasin për lidhje me arkitekturën islamike të kohës.

Kisha e manastirit të Profet Ilisë në Stegopull të Gjirokastrës ndërtuar në vitin 1624 përbëhet nga narteksi, naosi dhe ambienti i altarit. Në narteks hyhet nëpër dy dyer mbuluar me arkitra të rrafshtë njëra në murin perëndimor, tjetra në atë jugor. Narteksi është i mbuluar me qemer cilindrik me formuese lindje perëndim që për hapësirën e madhe të dritës e bën atë të ketë një lartësi jo të vogël. Prej tij nëpërmjet një porte kalohet në naosin i cili ka si kishat e tjera të tipit katër kolona. Prej tyre kalojnë harqe në muret veriorë dhe jugor mbi të cilët ngrihen qemeret që mbulojnë ambientet këndorë të hapur ndaj aksit gjatësor dhe qemeret e krahëve të kryqit në një kuotë më të lartë. Mbi këto nëpërmjet trekëndëshave sferikë ngrihet tamburi i lartë me kupolën. Dy absida ndodhen nën krahët verior dhe jugor të kryqit. Në atë jugoren kemi dhe një dritare. Naosi ndriçohet edhe nga dy dritare të tjera, njëra në ambientin këndor jug-perëndimor dhe tjetra një baxhë e hapur më vonë mbi absidën jugore.

Vëllimin kryesor të ambientit të altarit e zë bema me absidën gjysëm rrethore. Ambientet këndore të ngushtë mbulohen siç pamë me qemere dhe kanë, ai nga veriu dy nike, ai nga jugu vetëm një. Ambienti i

DO NOT COPY

altarit ndriçohet nga një dritare në anën jugore dhe një dritare e vogël mbi absidë. Në anën e jashtme absida ka tre nike të shkallëzuara.

Muret e kishës janë të trashë dhe të ndërtuar me gurë gëlqerorë e lidhur me llaç gëlqereje. Ata sot janë të suvatuar duke patur në pjesën e sipërme nën kornizë një brez me një mbishkrim me shkronja mjaft të mëdha. Me interes në drejtim të rezultatit estetik janë absidat e larta, me nga pesë nike të shkallëzuara dhe që lidhen në mënyrë të kurbuar me faqet e kishës duke krijuar një vazhdimësi të tyre që i mbështjell ato. Mbi kornizën me rrasa guri kemi çatinë dyujëse të kishës që është po ajo si për absidat anësore ashtu edhe për naosin me narteksin. Në qendër të saj ngrihet tamburi i lartë tetë faqësh me kupolën. Nike të shkallëzuara të njëjta me të absidave ka në secilën faqe të tamburit. Katër dritare të ngushta janë në tambur. E vogël nga përmasat kisha paraqet interes për formën e saj dhe trajtimin e përgjithshëm të anës së jashtme.

Kisha e manastirit të Shën Prodhromit në Voskopojë, datohet sipas mbishkrimit ndërtimor në vitin 1632.[4] Në ndërtimin planimetrik e vëllimor kjo kishë paraqet ndaj të tjerave dallim në pasjen e një hapësire shtesë ndërmjet vëllimit qendror me kupolë dhe ambientit të altarit origjinat e të cilit si dhe në Dhuvjan duhen parë në variantin kryeqytetas të kishave të këtij tipi të periudhës bizantine. Kështu në brendësi krahas katër kolonave ka dhe dy pilastra në pjesën që ndan ambientin e altarit nga naosi. Veçanti tjetër është se në krahët lindor e perëndimor të kryqit ka harqe mbajtës, në rolin e brinjëve ndërsa në anët jugore e veriore në këtë rol janë qemeret. Gjithashtu harqe në nivel më të ulët dalin nga kolonat e anës lindore për në muret anësorë dhe pilastrat si dhe nga kolonat e tjera në muret veriorë e jugor. Dallimi nga tipi përbën dhe mbulimi me kësulë sferike i krahut jugor të kryqit ndaj të cilit hapen qemeret cilidrikë të ambienteve këndorë. Në krahët jugor e verior hapen absidat anësore të mbuluara me çerek kupole. Në secilën prej tyre ka nga një dritare mbuluar me arkitrarë dhe hark mbi të. Të tre absidat janë në anën e jashtme pesë faqëshe.

Ambienti i altarit ndahet te pilastrat nga një ikonostas i sjellë këtu nga kisha e Shën Premtes. Ambienti përbëhet nga bema mbuluar me qemer cilindrik në pjesën e absidës rrethore dhe nga protezisi dhe diakonikoni mbuluar po me qemere cilindrikë në drejtim të kundërt. Këto dy ambiente të fundit kanë niket përkatëse. Një kamare ndodhet në anën veriore. Ndriçimi bëhet nga tre dritare të vogla në murin lindor dhe një dritare drejtkëndëshe e hapur më vonë në anën jugore.

Në kishë hyhet nga narteksi i shtuar në anën perëndimore. Dallimi bëhet nga teknika e ndërtimit dhe fugat në takimin e tyre. Narteksi është i mbuluar me çati druri. Ai ndriçohet nga dy dritare të mëdha mbuluar me hark në anën perëndimore dhe një tjetër në jugoren. Po me hark është mbuluar dhe porta në këtë anë.

Muret e kishës janë ndërtuar me gurë dhe llaç gëlqeror me mbushës të trashë. Muret janë riparuar disa herë dhe në faqen jugore, në të dy anët e absidës janë vënë si përforcim dy kontërforca. Muret përfundojnë me kornizë prej gurësh dhe mbi to vjen çatia me rrasa guri. Çatia është dyujëse në pjesën e kishës së vjetër dhe tre ujëse për narteksin shtesë. Mbi çati del tamburi 8 faqësh i ndërtuar me gurë dhe llaç gëlqeror dhe me katër dritare të mëdha në drejtimet kryesore. Mbulimi me rrasa i kupolës bëhet me sipërfaqe të kurbëta. Mbi çatinë dyujëse del lehtë dhe mbulesa e kësulës sferike e krahut perëndimor.

Monumenti shquhet për vëllimin kompakt, faqet e rrafshta, ndërtimin e zhvilluar planimetriko-vëllimor dhe ngritjen e ndijshme në lartësi. Gjithashtu në të duket qartë frymëzimi i ndërtuesve nga modelet e arkitekturës bizantine.

Kisha e manastirit të Fjetjes së Shën Mërisë në Koshovicë të Gjirokastrës është ndërtuar në vitin 1669. Ajo përbëhet nga naosi dhe ambienti i altarit. Në kishë hyhet nga dera në murin perëndimor mbuluar me arkitrarë guri mbi të cilën ka një nike të lartë mbuluar me hark. Në murin perëndimor ka gjurmë që flasin për vazhdim të mureve pra për prezencën e një narteksi më të ulët se kisha i cili sot nuk ekziston. Në brendësi kemi katër kolonat të cilat lidhen me harqe me muret jugorë e veriorë. Mbi këto harqe dhe muret anësorë mbështeten qemeret e ambienteve këndorë me formuese veri-jug. Mbi këtë sistemqemeresh e harqesh ngrihen qemeret e krahëve të kryqit, nga të cilët perëndimori është më i gjatë. Në katrorin e formuar prej tyre nëpërmjet trekëndëshave sferikë ngrihet tamburi me kupolën. Tamburi në anën e jashtme është dymbëdhjetë faqësh dhe ka katër dritare mjaft të ngushta si frëngji. Tamburi del direkt nga çatia dyujëse e kishës dhe përfundon me një kornizë të thjeshtë prej gurësh. Në anët veriore dhe jugore kemi absidat anësore, gjysëm rrethore në brendësi e mbuluar me gjysëm kupolë e trefaqëshe por jo shumë të rregullt në anën e jashtme. Ndër to ka një dritare të ngushtë vetëm absida jugore.

4. S. Adhami, **Një monument me vlerë i shekullit XVII në Voskopojë.** «Monumentet» 10, 1975, fq. 63-72.

Do not copy

Ambienti i altarit përbëhet nga bema me absida gjysëm rrethore relativisht të madhe dhe protezisi e diakonikoni me nga një nike gjysëm rrethore. Një kamare ndodhet në anën veriore. Në anën e jashtme absida është gjithashtu gjysëm rrethore dhe për nivelin e lartë të dhérave në të nuk ka dritare.

Muret e kishës janë me gurë gëlqerorë të vendosur në rreshta dhe lidhur me llaç gëlqereje. Kisha karakterizohet nga faqet e rrafshta dhe të verbëra, nga trajtimi i varfër i tyre.

Kisha e manastirit të Shën Mërisë së Kakomesë në rrethin e Sarandës ndodhet rreth 1 km larg gjirit me të njëjtin emër të bregdetit Jon[5]. Kisha së cilës në një kohë të dytë i është shtuar një hajat përbëhet nga naosi dhe ambienti i altarit, të ndarë nga një ikonostas druri pa vlera artistike. Kisha është pikturuar në vitin 1672.

Në brendësi të kishës mbi katër kolonat ngrihet kupola mbi tamburin tetë faqësh. Kolonat janë mjaft afër mureve verior dhe jugor dhe të vendosur kulmet e një drejtkëndëshi me brinjë më të gjata ato lindje perëndim. Për këtë që të formohet katrori për bazën rrethore të tamburit nëpërmjet trekëndëshave sferikë ndërtuesit kanë përdorur artificë që dëshmon për mjeshtrinë e tyre në ngritjen e mbulesave të kurbuara. Ndërsa qemeret e krahëve lindorë dhe perëndimorë përfundojnë si zakonisht në anë të kolonave duke shërbyer pra si harqe mbajtës, krahët jugor dhe verior janë mjaft të shkurtër dhe përfundojnë më brenda kolonave për të kompensuar ndryshimin në gjatësi të brinjëve veri-jug duke u kthyer qemeret e krahëve të kryqit thjeshtë në harqe mbajtës.

Edhe këtu si në kishën e Krorezit qemeret e ambienteve këndorë hapen ndaj aksit gjatësor të kishës duke patur në këtë mënyrë harqe nga kolonat në muret anësorë vetëm në drejtimin veri-jug. Në ndërtimin planimetrik e vëllimor kisha i përmbahet tipit të manastireve duke patur në anët veriore dhe jugore dy absida të cilat bëjnë të ndihet aksi qendror i kishës qemeri i të cilit do të ishte i vogël për vendosjen e kolonave pranë mureve.

Naosi ndriçohet nga dritaret në absidat anësore, prej të cilave ajo nga veriu është mbyllur si dhe tre dritareve në tamburin e kupolës në anët veriore, lindore dhe jugore.

Ambienti i altarit me absidën rrethore në qendër ka si dhe në Krorëz, me sa duket ndërtim i të njëjtëve mjeshtrave, dy nike për protezisin dhe diakonikonin dhe dy kamare në muret veriorë dhe jugorë. Ambienti ndriçohet nga tre dritare të vogla.

Muret e kishës janë ndërtuar në mënyrë të rregullt me gurë gëlqerorë të papunuar të nxjerrë nga kavo shtresore pra me tendenca horizontale të rradhëve dhe lidhur me llaç gëlqeror. Në pjesën e sipërme përfundojnë me korniza guri prej dy rradhësh. Në murin lindor mbi absidën është një pjatë për zbukurim. Çatia e kishës është e mbuluar me tjegulla. Ajo është dyujëshe duke patur më të ngritur pjesën që i takon krahëve jugorë dhe veriorë të kryqit. Pjesën qendrore të kësaj e zë tamburi me faqet e tij të rrafshta që përfundon me kornizë horizontale. Në ndërtimin e tamburit është përdorur edhe gur çmërsi.

Në anën perëndimore kishës i janë shtuar hajati me arkada me dy faza ndërtimi. I brendëshmi që është dhe më i vjetër ka pilastra në qoshet dhe kolona në mes tyre. Çatia e sotme ngrihet mbi këtë hajat i cili në anën perëndimore përfundon me fronton. Hajati i jashtëm edhe ky me arkadë është me pilastra që i mvishen të parave. Ai përfundon me mur horizontal mbi arkadën e cila nga teknika e ndërtimit duhet të jetë e njëkohëshme me konakët e manastirit.

Kisha e manastirit të Shpërfytyrimit në Mingul të Gjirokastrës ndodhet jashtë fshatit dhe përbëhet nga vetë kisha me naosin dhe ambientin e altarit dhe narteksi i vonë mbuluar me çati druri e tavan dërrase në anën perëndimore. Në kishë hyhet nëpërmjet narteksit dhe portës në anën perëndimore mbuluar me hark. Në brendësi të naosit kemi katër kolona mbi të cilat kalojnë harqe për në muret anësorë që krijojnë ambientet anësorë dhe mbajnë strukturat e mbulesës. Ambientet anësorë mbulohen me qemer cilindrik me formuese veri-jug ndërsa në nivel më të lartë janë qemeret e krahëve të kryqit. Në jug dhe veri të krahëve respektiv janë absidat gjysëm rrethore me nike të shkallëzuara në anën e jashtme. Në secilën nga këto absida ka nga një dritare. Naosi ndahet nga ambienti i altarit nëpërmjet ikonostasit të drunjtë. Ambienti përbëhet nga bema me absidën gjysëm rrethore dhe protezisi dhe diakonikoni me nga një nike gjysëm rrethore secili. Një kamare ka gjithashtu në anën jugore. Ndriçimi i ambientit të altarit bëhet nga dritarja e ngushtë në absidë dhe dy të tilla anash saj lart.

Muret e kishës janë ndërtuar me gurë çmërsi dhe shtufi të lidhur me llaç gëlqereje, teknikë kjo e rëndomtë në zonën e Lunxherisë. Muret përfundojnë me kornizë njëfishe dhëmbësharre prej gurësh. Çatia e kishës është dyujëse ndërsa ajo e narteksit treujëse. Mbi çati dalin mbulesat me frontone të krahëve ve-

5) A. Meksi; Arkitektura e kullës...

Botim

rior dhe jugor të kryqit. Si zakonisht në vend takimin e krahëve të kryqit mbi një bazament paralelopipedik ngrihet tamburi i lartë tetëfaqësh. Faqet e tamburit janë të rrafshta dhe të suvatuara. Në të ka katër dritare të larta.

Për nga format e thjeshta, teknika e rëndomtë, ndërtimi planimetrik e vëllimor kisha duhet të jetë ndërtuar gjatë shekullit XVII.

Kisha e Burimit Jetëdhënës në Derviçan përbëhet nga narteksi, naosi dhe ambienti i altarit. Hyrja e vetme është ajo në murin perëndimor të narteksit. Narteksi drejtkëndësh në plan mbulohet me një kupolë të stërgjatur që ngrihet mbi trekëndësha sferik në këndet. Narteksi ndriçohet nga dy dritare të mëdha mbuluar me hark të ulët në muret verior dhe jugor. Prej tij nëpër portën me arkitra të rrafshtë kalohet në naos. Në brendësi të tij kemi katër kolonat prej të cilave kalojnë harqe në muret veriorë dhe jugorë. Mbi të ngrihen qemerët e ambienteve këndorë që hapen ndaj aksit gjatësor të kishës dhe në një kuotë më të lartë qemeret e krahëve të kryqit. Duke qënë kolonat në qoshet e një drejtkëndëshi me brinjë më të gjatë atë lindje perëndim, për të formuar katrorin për kupolën në këto drejtime kemi një ngushtim pastaj fillon kupola pa tambur. Naosi ndriçohet nga dy dritare në absidat anësore.

Ambienti i altarit është i ndarë nga naosi nëpërmjet ikonostasit të drunjtë. Ai përbëhet nga bema me absidën gjysëm rrethore dhe protezisi me diakonikonin me niket gjysëm rrethore. Një nike tjetër ndodhet në anën veriore. Ndriçimi i ambientit të altarit bëhet nga dritarja e absidës dhe një dritare e vogël mbi të në frontonin e krahut lindor të kryqit.

Muret e kishës janë me gurë gëlqerorë nga formacione të shtresëzuara lidhur me llaç gëlqereje. Ato janë të rrafshta dhe gjallërohen nga absidat pesëfaqëshe me nike mbuluar me hark. Muret përfundojnë me korniza rrasash. Çatia dyujëse mbulohet me rrasa guri. Ajo ndërpritet nga pjesët me fronton të krahëve verior dhe jugor dhe ka në qendër një tambur të ulët për pjesën mbi çati të kupolës. Nga teknika e ndërtimit dhe format e thjeshta e mungesa e tamburit të mirëfilltë, kisha duhet të jetë ndërtuar gjatë shekullit XVIII.

Kisha e manastirit të Kryeengjëjve në Derviçan të Gjirokastrës përbëhet nga narteksi dy katesh në anën perëndimore dhe naosi në ambientin e altarit. Në narteks hyhet duke zbritur disa këmbë shkallë nëpërmjet portës së vetme në anën perëndimore mbi të cilën ka një nike të harkuar. Kati i poshtëm i narteksit është i mbuluar me qemere cilindrikë me formuese lindje perëndim. Ai ndriçohet nga dy dritare të ngushta në anët veriore dhe jugore. Një kamare është në murin jugor. Kati i sipërm për sa mund të gjykohet nga formulimi arkitektonik i dritareve, strehëve, ndryshimet në teknikën e ndërtimit duhet të jetë shtuar më vonë. Në të hipet nëpërmjet një shkalle të gurtë në anën veriore. Ambienti i vetëm i këtij kati ndriçohet nga pesë dritare, dy në anën veriore një në lindje, një në jug dhe një në anën perëndimore. Mbulesa e këtij ambienti është me çati me struktura druri.

Në naos hyhet nëpërmjet portës që e lidh me narteksin. Ndërsa në planimetri kisha është e njëjtë me monumentet e tjera të këtij tipi, ndërtimi vëllimor ka të veçantë ambientin qendror drejtkëndësh ndërmjet katër kolonave i cili mbulohet me qemer cilindrik me formuese lindje perëndim. Mbi katër kolonat kalojnë harqe për në muret verior dhe jugor. Ambientet këndorë mbulohen me qemerë me formuese veri-jug. Po të tillë me nivel më të lartë janë qemeret e krahëve verior dhe jugor. Krahët lindor dhe perëndimor mbulohen me qemere cilindrik me formuese lindje-perëndim. Në krahët jugor e verior kemi absidat gjysëm rrethore të cilat në anën e jashtme janë gjithashtu gjysëm rrethore duke patur tre nike të shkallëzuara mbuluar me harqe ku këmbehen gurë dhe tulla. Në to kemi dhe dritaret drejtkëndëshe që ndriçojnë naosin.

Ambienti i altarit përbëhet nga bema me absidën dhe protezisi me diakonikonin me nga një nike gjysëm rrethore dhe një kamare anash tyre. Ndriçimi bëhet nga dritarja e absidës dhe një dritare e vogël në murin jugor.

Muret e kishës ndërtuar me gurë e lidhur me llaç gëlqereje përfundojnë me kornizë dhëmbësharre prej guri. Mbi të vjen çatia dyujëse e mbuluar me rrasa guri. Nga format dhe teknika e ndërtimit kisha duhet të jetë e fundit të shekullit XVIII, ndërsa shtesa e narteksit e shekullit XIX.

* * *

Siç del nga parashtrimi i kishave të këtij tipi, me prejardhje të qartë nga monumentet e periudhës paraturke, arkitektura pasbizantine paraqitet me ndërtesa me vlera të mëdha si për nivelin e zgjidhjes planimetriko-vëllimore ashtu edhe në trajtimin e jashtëm të shembujve më të arritur duke përbërë një ndër kulmet e kësaj arkitekture në vendin tonë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



KISHAT ME NJE ABSIDE





SHEN MERIA – *Zervat*



SHEN QIRIAKU – *Dhurjan*





SHEN MERIA - *Kameno*









KİSHA E SHEN THANASIT - *Polička*

DO NOT COPY

DO NOT COPY





SHEN MERIA - *Melçan*





DO NOT COPY







SHEN MERTIRI – *Vranoshisht*



SHEN KOLLI – *Spile*





SHEN KOLLI – Saraqinisht





DO NOT COPY

DO NOT COPY







SHEN MERIA - *Kroreës*



SHEN TRIADHA - *Pepel*



DO NOT COPY



SHEN MITRI – *Qeparo*









SHEN VASILI – *Shën Vasi*

DO NOT COPY



KISHAT ME TRE ABSIDA



KISHA E UNGJILLIZIMIT – Vanistër







SHEN MERIA – *Goranxi*







PROFET ILIA – *Stegopull*



DO NOT COPY





SHEN PRODHROMI – *Voskopojë*





SHEN MERIA – *Koshovicë*





DO NOT COPY

DO NOT COPY







SHEN MERIA – *Kakome*







KISHA E SHPERFYTYRIMIT – *Mingull*

DO NOT COPY

KISHA E BURIMIT JETEDHENES – *Dervişan*









KISHA E KRYEENGJEJVE – *Dervişan*





Aleksandër MEKSI – Pirro THOMO

DO NOT COPY

L'ARCHITECTURE POSTBYZANTINE EN ALBANIE (EGLISES A STRUCTURE EN FORME DE CROIX AVEC COUPOLE)

RESUME

Contrairement aux églises postbyzantines à une seule nef, les monuments de cette classe sont plus avancés tant dans l'aspect architectural que dans celui de la construction structural. Leur construction planimétrique et volumétrique ressemble à celle des églises de type croix tracée à l'intérieur avec coupole sur supports libres de l'époque d'avant l'occupation turque. A l'intérieur, dans la plupart des cas, sur quatre colonnes ou pilastres, entre les arcs d'appui ou les arches se crée le noyau carré avec la coupole sur un haut tambour. Dans les constructions postbyzantines, de pair avec l'axe vertical, apparaît encore plus l'axe longitudinal, aussi bien à l'intérieur; par le rallongement des ailes occidentales et orientales de la croix, qu'à l'extérieur, par le toit à double pente, sans ambiances angulaires à des niveaux plus bas, avec ou sans transept, qui les approche des basiliques à coupole. Malgré les traits fondamentaux communs, les monuments de cette classe présentent des différences conditionnées même du point de vue fonctionnel, par le nombre d'absides. On distingue donc ainsi deux sous-groupes principaux: les églises à une abside et celles à trois absides.

1. Les églises à une abside.

Dans ces constructions de culte, tout comme dans les autres, l'abside se trouve au côté Est. La construction la plus ancienne est l'église du monastère de Sainte-Marie de Driano à Zervat de Gjirokastër, *qui est composée du naos (peint en 1569), du narthex du même époque (peint en 1583) et du porche ouvert sur arcades, ajouté plus tard au côté Ouest. Dans cette même région de Gjirokastër, se trouvent aussi* l'église du monastère de Saint-Qiriak et de Julita à Dhuvjan, *édifiée en 1588, l'église du monastère de Saint-Thanas à Poliçan, l'église de Saint-Mërtir à Tranashisht (1617), de Saint-Koll à Saraqinisht (1630), de Saint-Koll de Spile sur le village de Saraqinisht (peint en 1634), l'église du monastère de Sainte-Triadhë à Pepel (1750). L'église de Dhuvjan se distingue des autres par la disposition d'une ambience supplémentaire entre les ailes de la croix et le mur oriental, donc elle ressemble aux variantes de la capitale de l'architecture byzantine. Dans ce sous-groupe s'incluent aussi l'église de Sainte-Marie de Malcan dans la région de Sarandë (fin du XVI siècle – début du XVII*e *siècle), l'église du monastère de Sainte-Marie de Kurorezi à Sarandë aussi (peinte en 1672), l'église du monastère de Saint-Mitri à Qeparo de Vlorë (1760) et l'église de Saint-Vasil à Përparim de Sarandë (fin du XVIII*e *siècle – début du XIX*e *siècle).*

2. Les églises à trois absides.

*Il est caractéristique de ce groupe d'églises de monastères, la possession de trois absides. De pair avec le rôle fonctionnel, cela influe sur la création d'un axe vertical central plus mis en relief. La construction la plus ancienne entre elles est l'église du monastère d'Evangélisation à Vanistër de Gjirokastër, construite en l'année 1582 (tandis que le narthex y est rajouté en 1617). C'est de ce type qu'est aussi l'église du monastère de Ravenjë sur le village de Goranxi de Gjirokastër (peinte en 1600) qui a des valeurs de première importance, avec des influences claires de l'architecture occidentale, pour la construction de laquelle ont travaillé des maîtres, qui construisaient même les temples du culte islamique. Dans la région de Gjirokastër, se trouvent aussi l'église du monastère du prophète Ilia à Stegopull de Gjirokastër (1624), l'église du monastère du Sommeil de Sainte-Marie à Koshovicë (1669), l'église du monastère de la Défiguration à Mingul de Gjirokastër (XVII*e *siècle), l'église de la Source de Vie à Derviçan (XVIII*e *siècle) et l'église du monastère des Suranges encore à Derviçan (XVIII*e *siècle) avec narthex rajouté (XIX*e *siècle). Dans la région de Sarandë se trouve l'église du monastère de Sainte-Marie à Kakomë (peinte en 1672). Particulière, parmi elles se présente l'église du monastère de Saint-Prodhom à Voskopojë de Korçë, construite en l'année 1632, dont le narthex est rajouté plus tard. Tout comme à Dhuvjan, on dispose ici d'une espace supplémentaire entre le volume central à coupole et l'ambiance de l'autel.*

Dans l'exposition de ces monuments de même type, d'origine claire des monuments de la période pré-turque, l'architecture postbyzantine se présente avec des constructions de grandes valeurs, tant par le niveau des solutions planimétriques et volumétrique, que par le traitement extérieur des exemples les plus parfaits, qui font les sommets de cette architecture dans notre pays.

DO NOT COPY

Valter SHTYLLA

UJËSJELLËSI I VJETËR I KALASË SË GJIROKASTRËS

Ujësjellësi që ka pasë furnizuar kalanë e Gjirokastrës me ujë gjatë mesjetës së vonë është një nga ndërtimet më interesante dhe monumentale të këtij qyteti në këtë periudhë. Në fazën e tanishme të studimit e gjurmimit të ujësjellsave të vjetër tek ne mund të shprehemi se për nga gjatësia, kompleksiteti i zgjidhjeve inxhinjerike-hidraulike gjatë aksit të tij, ndërtimet mbrojtëse të tij, etj. ndoshta ky ujësjellës është më i madhi e më interesanti i ujësjellsave të ndërtuar në vendin tonë gjatë periudhës së mesjetës.

Lidhur me kohën e ndërtimit të këtij ujësjellësi nuk kemi burime të sakta dokumentare. Kur më 1672 Evlia Çelebiu[1] ka vizituar Gjirokastrën dhe në shënimet e tij ai përmend ndërtime hidraulike mjaft më të thjeshta ndaj ujësjellësit monumental, për të cilin nuk përmend asnjë fjalë. Ky është një fakt që të bën të mendosh se në këtë kohë ujësjellësi nuk ka egzistuar.

Pasi ujësjellësi i Gjirokastrës furnizonte me ujë kalanë, ahere për datimin e këtij ndërtimi hidraulik argumenta bindëse japin dhe vetë fazat e ndërtimit të kalasë. Pjesën më të vjetër të Kalasë e përbën faza e periudhës së para pushtimit turk, që zë pjesën verilindore dhe atë qëndrore, e cila duhet të jetë ndërtuar në gjysmën e dytë të shekullit XIII[2]. Në ditët e sotme kalaja ruan një shtrirje më të madhe. Zgjerimi i kalasë ka ndodhur në drejtimin jug-perëndimore të saj ku kemi të bëjmë me një fazë ndërtimi që lidhet me aktivitetin ndërtimor të Ali Pashë Tepelenës siç dëshmojnë Hani,[3] etj.

Pikërisht në ekstremin jug-perëndimor të kësaj faze ujësjellësi lidhej me kalanë (fig. 1). Ky është një argument i fortë që na shtyn të mendojmë se edhe ndërtimi i ujësjellësit duhet ti takojë kohës së Ali Pashë Tepelenës.[4] Në këtë kohë, vitet 1811-12 e më tej deri në 1820 kalaja e Gjirokastrës ishte një nga pikat ku Ali Pasha kish vendosur një garnizon të fuqishëm ushtarak me 75 topa të kalibrave e të peshave të ndryshme.[5] Ndërtimi i një ujësjellësi të tillë të gjatë me shumë vepra arti disa nga të cilat mjaft të vështirë për tu ndërtuar kërkonte njerëz të kualifikuar, pra teknikë, mjeshtër e inxhinjerë që në administratën e Aliut zinin një nga vendet kryesore e që kryen një volum të madh ndërtimesh të gjinive të ndryshme, si kala, ura, banesa, etj.

---

1) Evlija Çelebiu, Shqipnija para dy shekujsh, Tiranë, 1930, 29. Këtu Çelebiu shprehet: Në kala ka 200 shtëpi ..... Brënda në fortesë ndodhet xhamia e Bajazit Hamit ..... Afër minares së kësaj xhamie ka një sarenxhë të madhe ku mblidhen ujrat e shiut që kullojnë nga rrasat e pullazeve të fortesës në të cilën pinë ujë gjithë banorët e kalasë. Veç kësaj çdo zotni ka në shtëpi të vet një sarenxhe të veçantë. Pra fakti që banorët e kalasë problemin e furnizimit me ujë e kishin zgjidhur me organizimin e ujrave të shiut nëpër sarenxha (stera-depozita) tregon se ky ujësjellës në atë kohë nuk ka egzistuar.

2) A. Baçe, **Vështrim mbi qendrat e banuara antike dhe mesjetare në luginën e Drinos (Gjirokastër),** Monumentet 4, 1972, 122.

3) I.G. Hahn, Albanesische Studien, Jena 1854, 53.

4) E. Riza, Disertacion, **Qyteti Muze i Gjirokastrës,** 1978, 25.

5) R. Drishti, **Armët dhe armëtaret shqiptare,** Tiranë 1976, 84.

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2

Si argument tjetër mund të sillnin faktin se akoma dhe sot një nga urat më të mëdha të ujësjellësit; e ndërtuar në dalje të lagjes Manalat mbi lumin e Manalatit, nga fragmentet e vetme të ujësjellësit të ruajtura më mirë, populli e quan me emrin Ura e Ali Pashë Tepelenës. (tab. I).

Pra pas këtyre argumentave si datim të ujësjellësit pranojmë kohën e ndërtimit të fazës së Ali Pashës në kala pra vitet 1811-1812. Në këtë kohë në Gjirokastër ka pas egzistuar dhe një ujësjellës tjetër që furnizonte qytetin me ujë (pjesën jashtë kalasë).[6] Pukevili në dekadën e parë të shek. XIX-të kur përmend marrjen e qytetit të Gjirokastrës nga Ali Pasha shkruan se «sapo ushtritë e Vezirit këputën ujësjellësin dhe rrëzuan mullinjtë, banorët kërkuan të dorëzohen.[7] Pra duke pranuar si kohë ndërtimi të ujësjellësit atë të Ali Pashës, atëhere nga ky shënim i Pukevilit mund të mendojmë se Aliu ka prishur ujësjellësin tjetër të ndërtuar para kohës së tij.

Në gjendjen e sotme ky ujësjellës ruhet mjaft i dëmtuar. Ruhen vetëm disa urë-kanale të tij, një pus kontrolli, një kullë mbrojtje, gjurmë të këmbëve të akuaduktit të madh pranë kalasë dhe ndonjë rrënojë tjetër fig. 2. Megjithatë studimi i tij bazuar në këto gjurmë e në burimet mund të kryhet.

Ujësjellësi i kalasë së Gjirokastrës që nga vendi ku buronte tek Mëma e Ujit, siç e quajnë vendasit, në Grykën e Sopotit në jug-perëndim të fshatit Lazarat e deri në hyrjen e tij në skajin jug-perëndimor të Kalasë arrinte gjatësinë afër 12 km. Aksi i tij është trasuar duke ndjekur shpatet e kodrave, pak a shumë me parimin e izoipseve duke u krijuar sigurisht edhe qarkullimet me rënie (duker) nëpër përrenjtë apo grykat (ultësirat) ndërmjet kodrave apo «shullireve»[8] siç i quajnë këto vendasit, (tab. II).

Po të emërtojmë vendet karakteristike nga kalon ujësjellësi kodrat, sheshet, etj. ashtu siç i quajnë vendasit ahere prej burimit e deri në kala rruga që përshkonte ky ujësjellës i gjatë ishte: Mëma e Ujit (burimi) – Zhulliri i Kroit – Sheshi i Fotos – Prroi i Mesunit – Mokrra e Kokonos – Gropa e Kokonos – Shtegu i Rradhoit të Qershisë – Shulliri i Gropës së qershisë – Kurrizi i Zhapë – Shulliri i Ristës, – Fundi i Gropave të Sejdiut – Sheshi i Pllashnjës – Shulliri i Urës – Gropa e Lugut – Kodra e Mesunit – Kreu i gërmadhave të Mustafa Aliut – Këmbët e Shesheve – Shulliri i Qivurit – mali i Lulos – Shulliri i Gjokanës – kodra e Hijes së Arapëve – ura e Ali Pashës mbi lumin e Manalatit – lagje Dunavat.

Gjatë trasimit që jemi përpjekur të bëjmë në hartë mund të themi se pothuaj me saktësi kemi vendosur aksin nga kalaja deri tek ura e shesheve, ndërsa intervali prej këtej e deri në burim, për mungesë gjurmësh, është trasuar me afërsi.

Nga pikpamja teknike ky objekt është i mjaft i arritur. Sipas rastit gjatë aksit të tij janë ndërtuar shumë vepra arti si urë-kanale në përrenjtë, mure mbajtës në shpatet shkëmbore të thikta, pus kontrolli e bile deri dhe kullë për mbrojtjen e saj nga dëm-

6) TH. Kamberi, Shkenca dhe Jeta, Nr. 4, 1975, 55.
7) F.C.H.L. Pouqueville, **Voyage de la Grèce,** T.I., 1920 f. 338.
8) Shulliri – me këtë emër vendasit quajnë pllajën malore karshi diellit.

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

tuesit. Nga burimi deri në kala për funksionimin normal të ujësjellësit janë ndërtuar shtatë ura guri me hark me madhësi të ndryshme sipas grykës së përroit apo lumit që ndërpret aksin e ujësjellësit. Duke filluar nga burimi, në grykën e prroit të Pllashunjës që ndan Zhullirin e Urës me Sheshin e Pllashnjes tubacioni i ujësjellësit kalonte mbi urën e Vogël të Pllashnjes, sot e shkatërruar. Më tej në grykën që ndan Kodrën e Mesunit me Gropën e Lugut tubacioni kalonte mbi një urë tjetër e quajtura ura e Mesunit, edhe kjo e prishur.

Në grykën ndërmjet dy lartësive, këmbët e Shesheve dhe Shulliri i Qivurit ndodhet një prrua i vogël, verës pa ujë, këtu ujësjellësi kalonte mbi një urë të vogël — urë e shesheve me vetëm një hark me hapësirë rreth 5 m. Sot ura është e prishur dhe në kreun e saj me gjerësi 2 m. nuk ruhet asnjë gjurmë tubacioni. Ura është ndërtuar me gurë pllakë gëlqerore lidhur me llaç gëlqere.

Ura e katërt duke nisur nga burimi është ura e Karcales (Shën-nikollës) mbi lumin e Gjonakatës gryka e të cilit kalon ndërmjet malit të Lules dhe Shullirit të Gjokanës.

Ura e Karcales është interesante si kompozim dhe e ndërtuar me finesë. Në gjendjen e sotme ajo ruhet mjaft e dëmtuar, megjithatë rikonstruksioni ideor i tij është plotësisht i mundshëm (tab. III, 1). Si zgjidhje ai është ndërtuar i tërë mbi brigjet shkëmbore dhe konstruksioni i tij nuk ka kontakt fare me shtratin e lumit të Gjenakatës mbi të cilin është ngritur, lumë krejt i tharë gjatë periudhës së verës. Ura ka qenë ndërtuar mbi dy harqe, më i madhi prej të cilëve kalon mbi shtratin e lumit. Ky ka pasur formën e harkut rrethor me diametër 7.5 m. e lartësi mbi shtrat 6,5 m. Konstruksioni i qemerit të harkut ka trashësinë 55 cm. Këmba e mesit e urës që ndan dy harqet me gjatësi 1,7 m. nga të dy bjefet është trajtuar me majë të mprehët (fig. 3). Harku i vogël me hapsirë drite 2,4 m. e trashësi qemeri po 55 cm. është ndërtuar i tëri mbi shkëmbin në anën e djathtë. Në kreun e urës me gjërësi 110 cm, nuk ruhet asnjë gjurmë tubacioni i ujësjellësit. Teknika e ndërtimit është me gurë pllakë lidhur me llaç gëlqere.

Ura e pestë që vijon për më nga afër qytetit dhe që është nga ndërtimet më interesante të këtij ujësjellësi është ura e Ali Pashës e ndërtuar mbi lumin e Manalatit në grykën që ndan lartësinë e quajtur «Hieja e Arapëve» me shpatin shkëmbor që vijon për nga banesat periferike të lagjes Dunavat buzë lumit të Manalatit mjaft e thiktë ndaj shtratit të tij, (tab. I).

Ura e Ali Pashës, kështu e quajnë sot vendasit, është një ndërtim monumental që të imponohet veçanërisht me theksimin e tij vertikal. Duke soditur këtë ndërtim të guximshëm inxhinjerik të lind vetiu një respekt i veçantë për kurajon dhe aftësinë e mjeshtrave tanë të ndërtimit, që kanë realizuar një objekt të tillë solid e të vështirë. Kjo urë kanal me gjatësi afër 40 m. në qendër të kompozimit ka harkun e madh rrethor që mbështetet mbi faqet e pjerrta shkëmbore të grykës së lumit e nuk takon në shtratin e lumit i cili në këtë vend është mjaft i ngushtë. Harku është me hapsirë drite 13,7 m dhe lartësi nga kyçi në shtratin e lumit 19 m. Harku është ndërtuar me dopjo qemer me trashësi të përgjithëshme 130 m. Në ballin e qemerit të poshtëm nga të dy bjefet janë



Fig. 5

vendosur nga tetë ganxhe metalike për mbërthimin e gurëve ballorë ndërmjet tyre. Për lehtësimin e konstruksionit e për të evituar muret masive bregore që mbështeten mbi skarpate shkëmbore, anash harkut të madh, në lartësi, janë hapur dy harqe lehtësues me formë gjysëm rrethore. Kanali ka pas kaluar mbi kreun e urës, që ka gjërësinë 2,3 m. Sot mbi urën nuk ruhet asnjë gjurmë e tubacionit të ujësjellësit, por në krahun e djathtë të urës në faqen shkëmbore të malit është dalltuar një thellim për vendosjen e tubacioneve (fig. 4). Ura është ndërtuar me gurë gëlqere pllakë lidhur me llaç e gëlqere.

Pasi kalon urë-kanalin e Ali Pashës tubacioni vijonte në shpatin shkëmbor në bregun e majtë të lumit dhe pasi bën disa qindra metra gjatë këtij bregu futet në lagjen Dunavat.



Fig. 6

Nuk kemi ndonjë të dhënë për rrugën që përshkon ujësjellësi në pjesën jug-perëndimore të lagjes Dunavat deri sa hasim aksin e tij në urën e vogël me një hark në qendër të lagjes Dunavat mbi të cilën kalonte tubacioni i ujësjellësit.

Ura e Dunavatit është ndërtuar me një hark rrethor me trashësi të qemerit 45 cm. Hapësirë drite e harkut është 3,6 m, e lartësia nga kyçi në tokë është 2,3 m. (tab. III, 2). Prroi i Dunavatit gjatë verës nuk ka ujë. Tubacioni ka pas kaluar mbi kreun e urës, që ka gjërësinë 1,75 m. Menjëherë sapo del nga ura tubacioni kalonte në faqen e thiktë shkëmbore të grykës së prroit. Në afërsi të urës pak metra pas daljes prej saj, në shkëmb për vendosjen e tubacionit është ndërtuar një mur mbajtës rreth 7 m. i gjatë mbi të cilin kalonte tubacioni i ujësjellësit. Më tej gjurmët e ujësjellësit i hasim përpara portës së jashtëme të ish banesës së Qerebashit (fig. 5). Këtu tubacioni ruhet ende nën dyshemenë e oborrit të shtëpisë. Në këtë banesë që është shumë afër skajit jug-perëndimor të kalasë, ku dhe përfundonte ujësjellësi, ruhen elemente me interes që bënin pjesë në atë larmi zgjidhjesh teknike që e përbënin këtë objekt hidraulik.

Brënda murit rrethues të kësaj banese ndodhen dy godina të lidhura në formë L-je, njëra formë kulle me tre kate (e sipërmja) dhe tjetra më afër kalasë, me dy kate (tab. IV). Ndërtimi trekëndësh ka shërbyer si kullë e fortifikuar për mbrojtjen e ujësjellësit. Në murin e lartë nga ana veriore, që sheh nga qyteti janë vetëm dy dritare në katin e sipërm, ndërsa në katin përdhes e në të parin ruhen akoma frengjitë që duket se ishin hapur për mbrojtjen e ujësjellësit, aq më tepër pasi në këtë banesë ish ndërtuar dhe një pus kontrolli për kontrollin e tubacionit. Pusi ruhet ende (por i mbyllur) në katin përdhes të volumit me dy kate që lidhet me kullën e mësipërme. Nga ana e oborrit kjo godinë është me një kat, ndërsa nga faqja që sheh nga kalaja për shkak të terrenit të aksidentuar është me dy kate e pikërisht nga kjo faqe muri shihet edhe sot një kamare e vogël që komunikon me pusin e kontrollit e ku në thellësi të saj ruhet edhe një tubacion qeramike. Ky pus kontrolli mund të ketë qenë i fundit i këtij lloji para hyrjes së ujit në kala duke shërbyer dhe për dekantimin e grimcave të ndryshme në mënyrë që uji në kala të shkonte sa më i pastër.

Vepra më afër kalasë dhe më interesantja e gjithë ujësjellësit të vjetër të Ali Pashë Tepelenës në Gjirokastër është urë-kanali (akuadukti) i lartë me dy palë harqe, sot i rrënuar krejtësisht, i ndërtuar për arsye të rënies së terrenit në intervalin e banesave e Qeribashit (pusi i kontrollit). — skaj jugë perëndimor i kalasë. Pra ky akuadukt lidhte këto dy pika me kuotë afërsisht të njëjtë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Ky akuadukt monumental me një kompozim arkitektonik mjaft të goditur për objekte të kësaj gjinije e me një zgjidhje konstruktive shumë elegante siç na e paraqet Liki[9] në një gravurë të gjysmës së parë të shekullit XIX (fig. 6). Në ditët e sotme nga ky ndërtim i rrallë ruhen vetëm disa fragmente muresh të pjesëve të poshtme të kollonave. Vërejmë gjurmë të gjashtë kollonave. Më mirë nga këto ruhet pjesa e poshtme e kollonës në buzë të rrugës që lidh qëndrën Komitetik me lagjen Dunavat (fig. 2). Ajo është me seksion katërkëndësh me përmasa të poshtme 5,5 x 2,5 m (gjërësi). Këmbët qenë me seksion variabël p.sh. deri në lartësinë 4 m që ruhet kjo këmbë gjatësia 5,5 m. shkon e ngushtohen 20 cm nga të dy skajet fig. 7. Kollona apo këmba është ndërtuar me breza druri çdo 1,3 m. seksioni i binarëve 8 x 10 cm. Muratura me gurë pllakë gëlqerore me trashësi 6-12 cm lidhur me llaç gëlqere. Qoshet janë punuar me gurë shtufi të skuadruar. Më lart kësaj, nga ana e pusit të kontrollit ruhet një këmbë tjetër me gjërësi 2,25 m.

Hapësira ndërmjet këtyre këmbëve është 5,7 m. Akoma më lart ndodhet një këmbë tjetër me hapësirë më të madhe, 6,15 m. Në pjesën e rrugës nga kodra e kalasë duhet të kenë qenë dy këmbë me hapsirë 5,7 m ndërmjet tyre. Në bregun e kodrës së kalasë ruhen gjurmët mjaft të dëmtuara të tre këmbëve. Pra sot gjurmë të ruajtura janë vetëm për gjashtë këmbë të akuaduktit. Si përmasë e hapsirës së këmbëve dominon shifra 5.7 m. Nga llogaritja e përafërt del se gjatësia totale e akuaduktit me dy palë harqe prej buzës së kalasë e deri tek pusi i kontrollit i Qeribashit është rreth 120 m.

Qarkullimi i ujit në ujësjellësin e vjetër të Gjirokastrës kryhej me tuba qeramike. Për arësye të disnivelit që ekzistonte ndërmjet burimit të marrjes së ujit dhe skajit jug perëndimor të kalasë, ku është vepra e marrjes, rreth 1000 m, ky tubacion punonte me presion pra me mbushje të plotë. Nga gjurmët e gjetura tek ura e shesheve, 1/3 e rrugës pranë burimit, rezulton se diametri i brendshëm i tubacionit ka qënë mesatarisht 140 mm, ndërsa në tubacionet e gjetura në lagjen Dunavat, pra pranë fundit të ujësjellësit, rezulton se tubacioni ka pasur diametër 110 mm.[10] tab. V.

Ky fakt tregon se ujësjellësi është llogaritur me saktësi duke pasur parasysh edhe humbjet hidraulike, pra humbjet në gjatësi për efekt të fërkimit si dhe humbjet e vendit, në kthesat e ngushtimet pasi në atë kohë tubat ndërtoheshin me seksion variabël me pjesën më të ngushtë në dalje. Këto zgjidhje hidraulike të



Fig. 7

goditura tregojnë dhe një herë se ky ujësjellës është ndërtuar nga teknikë të aftë dhe forcon mendimin se objekti është ndërtuar nga Ali Pasha në administratën e të cilit kanë punuar teknikë e inxhinjerë të profileve të ndryshme. Faqet e brendëshme të tubave janë me vjaska apo thellime paralele ndërmjet tyre. Lidhja e tubave kryhej me futje njera tek tjetra. Lidhjet e tubave visheshin me llaç të përbërë vetëm prej gëlqereje të pastër e të staxhionuar. Gjatësia e tubave arrinte 330-360 mm. Trashësia e pareteve të tubave prej qeramike për të përballuar presionin e ujit shkonte nga 15 deri në 19 mm.

9) E. Lear, **Journals of a landscape painter in Albania,** London, 1851.

Për të mbrojtur rrjetin e ujësjellësit nga dëmtimet e mundëshme tubacionet e qeramikës vendosen thellë në tokë 50-60 cm. Ato bëheshin prej argjile dhe gjatë përgatitjes së tyre piqeshin mirë në mënyrë që të përballonin presionin e ujit brenda tyre. Uji në kala futet jo nikërisht në kullën jug perëndimore, ai me tubacion vijon disa dhjetra metra në faqen shkëmbore poshtë murit veri lindor. Pas një farë rruge bën kthesë e futet në kala ku depozitohet në tri stera të mëdha prej nga merret me muslluk.

Lidhur me mjeshtrit që kanë punuar për ndërtimin e këtij ujësjellësi nuk kemi të dhëna. Në bazë të burimeve të ndryshme rezulton se në atë kohë në krahinën e Lunxhërisë e pikërisht në fshatrat Nokovë, Dhoksat e Këllez ka pasur mjeshtër të njohur në ndërtimin e ujësjellsave,[11] të cilët me veprat e tyre hidraulike u bënë të njohur në gjithë Perandorinë. Pra kuptohet se po këta mjeshtra duhet të kenë marrë pjesë në ndërtimin e ujësjellësit të kalasë së Gjirokastrës, aq më tepër që ky ndërtim i profilit të tyre kryhej pranë vendlindjes së tyre. Puset e sterat e shumta dhe ujësjellsat e ndërtuar në Gjirokastër dhe fushën e Dropullit dëshmojnë për një aktivitet të gjerë të mjeshtrave lunxhiotë.

Ujësjellësi i Ali Pashë Tepelenës që furnizonte me ujë kalanë e Gjirokastrës ka një gjatësi të konsiderueshme; që e vendos atë ndër ujësjellësit më të gjatë. Nga literatura që kemi mundur të konsultojmë për ujësjellësit e ndërtuar në Ballkan gjatë mesjetës në Tivar ruhet një ujësjellës i ndërtuar në shekullin XVII me gjatësi 1,5 km. Akuadukti (urë-kanali) i tij që sjell ujin në kala është i gjatë 74 m.[12] Për realizimin teknik e larminë e zgjidhjes funksionale ai gjithashtu është një nga objektet më të goditura të gjinisë së tij dhe që e vlerëson mjaft aftësinë dhe pjekurinë e mjeshtrave tanë të ndërtimeve hidraulike.

DO NOT COPY

11) C. Robert, **Les Slaves de Turquie,** Paris, 1852, II, f. 171.
12) N. Katdiç, M. Gojkoviç, **Graça za prouçvanije kamenih mostova i akvedukta u akvedukta u Hrvatskoj,** Beograd-Zagreb, 1972, f. 229.

DO NOT COPY



URA E ALI PASHE TEPELENES

Gjirokastër





0 1 2 3 4 8 M

TAB: II



DO NOT COPY





DO NOT COPY

BANESA 40





DO NOT COPY





DO NOT COPY

Valter SHTYLLA

DO NOT COPY

L'ANCIEN AQUEDUC DE LA CITADELLE DE GJIROKASTËR

L'aqueduc qui a fourni d'eau la citadelle de Gjirokastër, pendant le haut Moyen-Age, est l'une des constructions les plus monumentales de cette ville, à cette époque-là. Au stade actuel des recherches et études sur les anciens aqueducs de notre pays, on peut dire que par la longueur, la complexité des solutions d'ingineeting et hydrauliques sur son axe, les constructions à caractère défensif etc., cet aqueduc est probablement le plus grand et le plus intéressant des aqueducs construits dans notre pays au cours de la période du Moyen-Age. Concernant l'époque de la construction de cet aqueduc, on ne dispose pas de sources documentaires précises. En nous basant sur les phases de construction de la citadelle, sur les sources orales attestées et sur d'autres arguments extraits de l'époque, nous admettrons que cet aqueduc est construit à l'époque d'Ali Pacha Tepelena et précisément aux années 1811-1812.

A l'état actuel, cet aqueduc se trouve très endommagé. Il n'en reste que qeulques viaducs le long de son axe, un puits de contrôle et une tour défensive, des traces de colonnes du grand aqueduc près de la citadelle et quelque autre ruine, constituant des objets rendent possible son étude.

L'aqueduc de la citadelle de Gjirokastër, depuis sa source «Mema e Ujit» comme la dénomment les habitants ou col de Sopot, au sud-ouest du village de Lazarat, jusqu'à son entrée, l'extremité sud-ouest de la citadelle, atteint une longueur d'environ 12 km.

Nous avons essayé de tracer sur la carte à peu près exactement l'axe depuis la citadelle jusqu'à «Ura e Shesheve», tandis que l'intervalle, de là, jusqu'à la source, à défaut de traces, a été tracé approximativement.

Du point de vue technique, cet objet est assez réussi. Afin d'assurer un fonctionnement normal à l'aqueduc, entre la source et la citadelle, on avait construit sept viaducs en pierre à archades, de différentes dimensions, selon la gorge du torrent ou de la rivière qui coupe l'axe de l'aqueduc. Depuis la source à la gorge du torrent de Pllashnjë qui sépare «Shulliri i Urës», du «Sheshi i Pllashnjës», la conduite d'eau de l'aqueduc passait sur le petit pont de Pllashnjë, aujourd'hui ruiné. Plus loin, à la gorge qui sépare «Kodra e Mesunit» de «Gropa e Lugut» la conduite d'eau passait sur un autre pont, celui de Mesun, également ruiné.

A la gorge entre deux hauteurs «Këmbët e Shesheve» et «Shulliri i Qivurit» se trouve un petit torrent, sec en été; où l'aqueduc passait sur un petit pont (Ura e Shesheve) à un seul arc, avec une espace de 5 mètres environ. Actuellement le pont est démoli.

Le viaduc de Karcaler (Saint-Nikolla), sur la rivière de Gjirokastër dont le cours passe à travers la montagne de «Lule» et de «Shulliri i Gjokanës», est le quatrième à partir de la source. Il est intéressant du point de vue de la composition et de fine construction.

Bien que à l'état actuel il se présente très endommagé, sa reconstruction imaginaire est tout à fait possible. Le viaduc avait été construit sur deux arcs, dont le plus grand passait au-dessus du lit de la rivière. Il avait la forma d'un arc en plein cintre d'un diamétre de 7,5 m et d'une hauteur de 6,5 m au dessus du lit. La partie supérieure du pont, d'une largeur de 110 cm ne conserve aucune trace de la conduite d'eau.

Le cinquième pont, le plus proche de la ville, qui constitue l'une des constructions les plus intéressantes de cet aqueduc, est celui d'Ali Pacha, construit sur la rivière de Manalat à la gorge qui sépare la hauteur «Hieja e Arapëve» du versant rocheux qui suit vers les habitations périphériques du quartier de Dunavat au bord de la rivière de Manalat, très raide envers son lit. Le pont d'Ali Pacha, comme l'appellent les auttoctones de nos jours, est une construction monumentale qui s'impose particulièrement par sa verticalité accentuée.

Au centre de la composition de ce viaduc d'une longueur d'à peu près de 40 m, se situe le grand arc en plein cintre qui repose sur les pentes rocheuses de la gorge de la rivière sans toucher à son lit, très étroit en cet endroit. L'arc mesure, du haut au lit de la rivière une hauteur de 19 m et a un espace de lumière de 13,7 m. Autrefois le canal passait sur la partie supérieure du pont, d'une largeur de 2,3 m. A l'heure actuelle le pont ne conserve aucune trace de la conduite d'eau de l'aqueduc, mais au côté droit du pont, sur le versant rocheux de la montagne il a été taillé un creux pour l'installation de la conduite d'eau.

Domoteka

Après avoir traversé le viaduc d'Ali Pacha, la conduite d'eau suivait sur une centaine de mètres la pente rocheuse de la montagne, le long de la rive gauche de la rivière, puis s'introduisait dans le quartier de Dunavat.

Nous ne disposons pas de données sur le chemin que suivait l'aqueduc dans la partie sud-ouest du quartier de Dunavat, jusqu'au petit viaduc à un arc au centre de ce quartier, au dessus duquel passait la conduite d'eau de l'aqueduc.

Le viaduc de Dunavat comporte un arc en plein cintre ayant un espace de lumière de 36 m. Son arche est large de 45 m. Ayant quitté le pont, la conduite d'eau suivait l'abrupt versant rocheux de la gorge du torrent. A la proximité du pont, quelques mètres au delà, sur le rocheux un mur d'appui d'environ 7 m de long avait été construit pour l'installation de la conduite d'eau. Plus loin, on rencontre les traces de l'aqueduc devant la porte extérieure de l'ex-habitation des Qeribash. La conduite d'eau se conserve encore sous les dalles de la cour de la maison. Dans cette habitation, qui se trouve tout près de l'extremité sud-ouest de la citadelle, où terminait l'aqueduc se conservent des éléments d'intérêt.

A l'intérieur du mur d'enceinte qui entourne l'habitation, se trouvent deux bâtiments liés en forme de «L», l'une en forme de manoir (celle d'au-dessus) de trois étages et l'autre, dans le voisinage de la citadelle de deux étages. Cette construction triangulaire a servi de tour fortifiée pour la défense de l'aqueduc. Le haut mur nord, qui donne sur la ville, comporte seulement deux fenêtres à l'étage supérieure, tandis que le rez-de-chaussée et le premier étage gardent encore les meurtrières qui semblent avoir été ouvertes pour défendre l'aqueduc, d'autant plus que dans cette habitation on avait construit aussi un puits de contrôle, afin de contrôler la conduite d'eau. Le puits se conserve encore, mais bloqué, dans le rez-de-chaussée du volume de deux étages, lié au manoir ci-dessus.

Le haut viaduc à deux rangées d'archades, aujourd'hui complètement ruiné, qui se trouve le plus près de la citadelle, constitue la partie la plus intéressante de tout l'ancien aqueduc d'Ali Pacha Tepelena à Gjirokastër. Ce viaduc a été construit à cause de l'affaissement du terrain entre le group d'habitations s'élevant sur le rocher des Qeribash (puits de contrôle) et l'extrémité sud-ouest de la citadelle. Donc le pont reliait ces deux points qui sont presqu'à la même hauteur.

Cet aqueduc monumental est d'une composition architectonique assez réussi pour des objets de ce genre et d'une solution constructive très élégante, comme cela nous est présenté par Leake sur une gravure de la première moitié du XIX sciècle. A l'heure actuelle, de cette construction exemplaire il ne reste que quelques fragments de murs des parties inférieures des colonnes. On aperçoit les traces de six colonnes. L'espace entre les colonnes est de 5-7 m.

L'eau potable, dans l'ancien aqueduc de Gjirokastër, circulait au moyen de tubes de grès. La source de l'eau et l'extrémité sud-ouest du château, n'ayant pas le même niveau une différence d'environ 1000 m, cette conduite d'eau travaillait à pression pleine. Des traces restées à «Ura e Shesheve» (un pont) au tiers du chemin près de la source, il resulte que le diamètre intérieur des tubes a été en moyenne de 140 mm, tandis que les conduites d'eau, trouvées dans le quartier de Dunavat, donc près d'extrémité de l'aqueduc il résulte que le diamètre des tubes a été en moyenne de 110 mm.

De ce fait il s'ensuit que l'aqueduc avait été calculé avec précision, prenant en considération même les pertes hydrauliques, donc les pertes en longuer, à cause du frottage, ainsi que les pertes dues au terrain, aux tournants et aux endroits étroits, parce que, à cette époque-là, les tubes étaient produits à section variable la partie la plus étroite étant à la sortie. Ces solutions hydrauliques réussies démontrent une fois de plus, que cet aqueduc a été construit par de bons techniciens et renforce l'idée que l'objet est construit par Ali Pacha, dans l'administration duquel ont travaillé des techniciens et des ingénieurs de différentes specialités. Les tubes étaient liés en entrant l'un dans l'autre, étant revêtus en cette partie d'une couche de mortier fait de chaux pure conditionnée. Ils atteigneaient une longueur de 330-360 m. L'épaisseur des parois des tubes de grès, afin de pouvoir faire face à la pression de l'eau, était de 15 à 19 mm.

Afin de préserver le réseau de l'aqueduc des endommagements possibles, les tubes de céramique, étaient placés à une profondeur de 50-60 cm. L'eau ne s'introduisait pas dans la citadelle par le tour sud-ouest, mais il suivait sur quelques dizaines de mètres, la partie rocheuse au dessous du mur longitudinal de derrière. Plus loin, après un détour, elle entrait dans la citadelle, où on la conservait dans de grandes citernes et qu'on puisait au moyen de robinets.

Nous ne savons rien sur les maîtres qui ont construit l'aqueduc. D'après différentes sources, il résulte qu'en cette époque-la, dans la région de Lunxheri, à savoir, les villages de Nokove, Dhoksat, Këllez, il y a eu des maîtres connus dans la construction d'aqueducs, qui par leurs oeuvres hydrauliques se sont fait connaître dans tout l'empire. Il est évident que ces maitres ont dû participer à la construction de l'aqueduc de la citadelle de Gjirokastër, d'autant plus que cette construction, appartenant à leur spécialité, avait lieu dans le voisinage de leur région natale. Les puits et citernes multiples, ainsi que les aqueducs construits à Gjirokastër et dans la plaine de Dropulle font preuve d'une large activité des maîtres de Lunxhêri.

L'aqueduc d'Ali Pacha Tepelena, qui fournissait d'eau la citadelle de Gjirokastër, a une longueur considérable qui le place parmi les plus longs aqueducs. D'après la littérature, que nous avons pu consultér, concernant les aqueducs construits aux Balkans, au cours du Moyen-Age, à Tivar du Monténégro se conserve un aqueduc long de 1,5 km, construit au Moyen-Age au XVIIIème siècle. Son viaduc qui conduit l'eau à la citadelle, est d'une longueur de 74 m. Du point de vue de la réalisation technique et de la variété des solutions fonctionnelles, il est aussi l'un des objets les plus réussis de son genre, qui fait évaloir assez la capacité et la maturité de nos maitres de constructions hidrauliques.

DO NOT COPY

Emin RIZA

DO NOT COPY

BANESA QYTETARE SHQIPTARE GJATË GJYSMËS SË DYTË TË SHEK. XIX, DERI RRETH ÇEREKUT TË PARË TË SHEK. XX.

Banesa qytetare shqiptare, nga gjurmimet dhe studimet e derisotme është ndjekur në zhvillimin e saj të përgjithshëm gjatë pesë shekujve të fundit, duke qenë shek. XVIII-XIX, dhe fillimet e shek. XX, relativisht të pasur me material faktik. Dekadat e para të shek. XX, vazhdojnë si tradicionalisht, ta mbajnë këtë veprimtari ndërtimore brenda suazave të krijimtarisë popullore, për t'ia lënë vendin shkallërisht ndërtimeve të paraprira nga projekte të hartuara prej arkitektësh.

Banesa qytetare, ashtu si banesa në përgjithësi, është e lidhur ngushtë në përbërësit e saj themelorë me kushtet ekonomiko-shoqërorë. Pikërisht ky realitet është shkaku i dallimeve thelbësore ndërmjet tipologjisë dhe në përgjithësi i karakteristikave të banesës qytetare që lidhet me dy formacionet ekonomiko-shoqërore të feudalizmit dhe kapitalizmit. Studimet e derisotme kanë treguar se rreth mesit të shek. XIX duhet kërkuar caku i përafërt kohor i fillimit të pasqyrimit në banesë të atij procesi të rëndësishëm në jetën ekonomike e politike të vendit, që lidhej me lindjen e zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste dhe me lëvizjen e madhe të Rilindjes Kombëtare. Pikërisht ky cak e ndan tipologjinë e banesës qytetare shqiptare në dy grupe të mëdhenj banesash, që lidhen respektivisht me secilin formacion ekonomiko-shoqëror.

Banesa qytetare shqiptare, e lidhur me formacionin feudal të shoqërisë, brenda periudhës së përmendur më sipër dallohet për një sërë tiparesh, ndër të cilat më të spikaturat janë: tipologjia e pasur me shtrirje të ndryshme, zhvillimi relativisht i ngadalshëm i saj, lidhja e ngushtë e kësaj tipologjie me banesën fshatare veçanërisht në variantet e thjeshtë etj. Këto tipare e gjejnë shpjegimin në copëtimin ekonomik feudal, në ritmet relativisht të ngadalshme të zhvillimit, në angazhimin e një pjese të popullsisë që jetonte në qytete me ekonominë bujqësore, në ekonominë relativisht të mbyllur familjare etj.

Lindja dhe zhvillimi i marëdhënieve kapitaliste në vendin tonë, lindja dhe fuqizimi i shtresave të reja të borgjezisë, që pruri ndryshime të rëndësishme në strukturën klasore të shoqërisë qytetare të kohës, patën ndikim të drejtpërdrejtë në karakterin dhe tipologjinë e banesës. Shtresat e ndryshme të shoqërisë borgjeze, dalloheshin thelbësisht nga ato paraardhëset në mënyrën e jetesës, e cila kërkonte domosdo materializimin e saj dhe në banesa, si kategoria ndërtimore e lidhur më drejtpërdrejt me natyrën e shoqërisë, në kuptimin e gjerë të fjalës. Thuajse në të gjithë qytetet tanë, ku më shumë e ku më pak, lidhur kjo me shkallën e zhvillimit të çdo qendre, ndihen përpjekje për pasqyrimin në banesë të koncepteve të reja, të cilat pa mohuar krejtësisht arritjet paraardhëse, por duke u mbështetur fort në to, shënonin një zhvillim relativisht të shpejtë drejt realizimeve, që dalloheshin thelbësisht nga ato tradicionalet. Ashtu si në çdo proces historik dhe në rastin e dhënë, nuk jemi përpara një shkëputje të prerë e të njëkohëshme me konceptet e vjetra në mbarë qendrat. Duke qenë përpara një procesi dialektik rritjeje, kalimi bëhet me mënyra e shkallë të ndryshme intensiteti në qendra të ndryshme, në përputhje me fuqinë ekonomike të shtresave të reja të borgjezisë, dhe me shkallën e realizimeve të banesës tradicionale.

Pikërisht duke pasur në bazë shkaqet e mësipërme, gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX dhe më vonë në banesën qytetare shqiptare vërehen dy dukuri të rëndësishme, të cilat në mënyra të ndryshme pasqyrojnë prirjen e përgjithshme për materializimin e koncepteve të reja në banesë. Dukuria e parë, lidhet me një proces të gjerë e të rëndësishëm ri-

ndërtimesh të tipave të vjetër. Në këtë proces duhen përfshirë dhe një sërë ndryshimesh që u pasqyruan në katër tipat tradicionale, që ende ndërtoheshin, ndërmjet të cilëve kryesisht në banesën gjirokastrite, ndryshime këto që synonin të përputhnin tipat e vjetër me kërkesat e reja të kohës. Krahas kësaj dukurie, ndeshemi dhe me një dukuri paralele me të parën, atë të lindjes së një tipi të ri banese, e cila lidhej drejtpërdrejt me kërkesat e shtresave të ndryshme të borgjezisë së re. E theksojmë se lindja e tipit të ri, e cila për arsye të kuptueshme nuk përfshiu barazisht mbarë qendrat qytetare, nuk u shoqërua me heqjen dorë nga ndërtimi i tipave të vjetër, disa prej të cilëve, siç përmendëm, vazhdojnë të ndërtohen me ndryshime, krahas rasteve të ruajtjes së kompozimeve të mëparshme. Ndjekja në kohë e dukurisë së dytë është relativisht e vështirë, për shkak të mungesës së datimeve, por ajo nuk duhet mohuar. Të dy proceset e rëndësishëm, ai i rindërtimeve dhe lindja e tipit të ri, janë në raporte të ndryshme në kohë dhe në shtrirje. Fillimisht, procesi i parë është mjaft i gjërë, duke ia lënë vendin shkallërisht procesit të dytë, përhapjes së gjerë të ndërtimit të banesave të reja, me konceptet e kohës.

Ndër studiuesit e arkitekturës sonë popullore, G. Strazimiri[1] i pari ka vënë re dukurinë e rindërtimeve të gjëra në banesën tonë qytetare, e veçanërisht në Berat. Ai e sheh këtë si ndikim perëndimor, të shfaqur vetëm në sipërfaqe (pamje të jashtme), i cili erdhi te ne nëpërmjet Stambollit dhe disa qyteteve të tjerë ballkanikë. Megjithë meritën e madhe të vënies në dukje të proçesit të rindërtimeve, problemet e shkaqeve të përhapjes së kësaj dukurie nuk gjejnë argumentimin e duhur, ndërsa mohimi i lindjes së tipit të ri është i pa bazuar. Këto janë të shpjegueshme po të marrim parasysh se kjo fushë në ato vite sapo kish filluar të lëvrohej.

Banesa qytetare shqiptare e shekujve të fundit të mesjetës, tipologjikisht e lidhur me katër tipat kryesore të saj: banesën me shtëpi zjarri përgjatë dy kateve (banesa tiranase), banesën me hajat, banesën me çardak dhe kullën qytetare (banesën gjirokastrite) si dhe një numur të madh zgjidhjesh të veçanta, në pragun e ndryshimeve të rëndësishme ekonomiko-shoqërore, që lidheshin me lindjen dhe zhvillimin e marëdhënieve kapitaliste në vendin tonë, kishte arritur të krijonte jo vetëm një fond shumë të madh banimi, por edhe realizime të rëndësishme, që shpesh llogariteshin me vlera të mëdha monetare. Në anën tjetër, procesi i lindjes së borgjezisë nuk qe aq i vrullshëm dhe nuk përfshiu me dendësi të njëllojtë mbarë qendrat e vendit. Mbeturina të ekonomisë feudale, mpleksja e ekonomisë qytetare me atë fshatare, qenë për një kohë të gjatë bashkëudhëtarë të qyteteve tanë. Në këto kushte vinte e kuptueshme përpjekja për të prekur banesat ekzistuese, të kushtueshme dhe me mundësi të mëdha për ritrajtime në përputhje me kërkesat e reja të kohës. Disa shkaqe ekstra-sociale, si tërmeti i vitit 1851, në qytetin e Beratit, nxisin dhe shpejtojnë zgjerimin e procesit të rindërtimeve në banesat e vjetra, apo më saktë, të ndërtuara sipas konceptesh tashmë të vjetëruara.

Rindërtimet qenë me shtrirje të ndryshme në tipa të ndryshme. Shkaqet duhen kërkuar kryesisht në dy rrethana. Së pari ndryshimeve iu nënshtruan tipat e hapur, kryesisht ai i banesës me çardak, i cili tashmë ishte i dënuar historikisht. Ai në variantet e zhvilluar ishte i lidhur kryesisht me shtresat e pronarëve të tokave, të cilët prej kohësh ishin përfshirë në sferat e shkëmbimit. Prirjet e tyre drejt borgjezimit apo rënia ekonomike, e bënë kalimin drejt banesës së mbyllur një dukuri mjaft të përhapur. Së dyti, ndryshimeve iu nënshtruan tipat e lashtë e mund të themi anakronikë, si banesa tiranase, e lidhur ngushtë me mbeturina të koncepteve patriarkale, ndërsa banesa me hajat dhe ajo gjirokastrite, e ndjejnë fluksin e koncepteve të reja më shkarazi. Banesa me hajat ishte e lidhur kryesisht me shtresat e mesme e të varfëra zejtare, mënyra e jetesës së të cilave nuk pësoi ndryshime të rëndësishme nga gjendja e re shoqërore e tyre, prandaj ajo pësoi pak ndryshime.

Banesa gjirokastrite me përhapje relativisht të kufizuar thuajse vetëm në Gjirokastër me karakteristikat e saj të njohura si qendër administrative e këmbimi, nuk njohu ndonjë zhvillim të dukshëm të borgjezisë, ndërsa banesa tipike e këtij qyteti kishte arritur në këto dekada realizime të rëndësishme, që i qëndronin kohës me pak ndryshime. Madje, siç përmendëm, në banesën gjirokastrite gjejmë rastin relativisht të rrallë të përpjekjeve për të futur konceptet e reja në banesat e ndërtuara gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, gjithë duke qëndruar këto të fundit brenda kuadrit të tipologjisë së banesës gjirokastrite.

Konceptet e reja në proceset e rindërtimeve u shprehën kryesisht në mbylljen e sipërfaqeve të hapura, në prirjen për largimin nga banesa e ambientet të pabanuara të katit përdhe, kur kjo ishte e arritshme, në zgjerimin e ndriçimit për ambientet e banuara, në barastrajtimin e pamjeve të jashtme me ato të brendshme, duke thjeshtuar trajtimin e brendshëm dhe përpunuar më tej trajtimin e jashtëm, në futjen gjerë të teknikës me skelet druri etj.

1) G. Strazimiri. **«Disa tipare të arkitekturës së qytetit të Beratit»,** në «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», Tiranë 1965.

POROTOPI



Fig. 1

Ndryshimet në tipologjinë e banesës tradicionale mund të ndiqen në tre përbërësit e saj kryesorë dhe pikërisht në kompozimin, në trajtimin arkitektonik dhe teknikën e ndërtimit. Kompozimi i banesave tradicionale, të lidhura me formacionin feudal të shoqërisë, për arsye të kuptueshme, në përgjithësi nuk cënohet rëndë nga ndryshimet që pësuan këto banesa. Megjithatë shkalla e ndryshimeve të kompozimit në disa tipa banesash është më e ndjeshme, sepse ato i përgjigjeshin një shkalle relativisht të ulët zhvillimi, madje dhe brenda kuadrit të ekonomisë feudale.

Në përgjithësi në tipat e banesës së hapur, me çardak dhe me hajat, kompozimi nuk preket ndjishëm. Kryesisht në këto banesa shohim që sipërfaqet e hapura të mbyllen pjesërisht, apo plotësisht duke ndërtuar në to ambiente, apo në vend të çardakut të hapur, divane të mbyllur me funksione ndërlidhëse. Në katin përdhe të banesave me çardak me një ritëm relativisht të ngadalshëm vërehen dhe raste të krijimit brenda volumit të hajatit të ambienteve të banuarë, apo të kthimit të ndonjë ambienti ndihmës në të banuar. Në banesën gjirokastrite, kryesisht u prekën variantet e zhvilluar të cilët përfshinin dhe çardakun, duke qenë ky i fundit objekt i zakonshëm i mbylljes dhe i krijimit brenda volumit të tij të ambienteve të rinj.

Banesa tiranase, iu nënshtrua një procesi relativisht të vonë, por të fuqishëm rindërtimesh. Të vonë, sepse vetëm aty nga fillimi i shek. XX, qyteti fillon të pësojë një rritje të shpejtë dhe të fuqishme nga që banesa tiranase ishte, ndërmjet simotrave më primitivja. Ndryshimet në kompozimin e kësaj banese janë të theksuara. Në variantet e zhvilluar, me mundësi të mëdha zgjidhjesh të reja, këto ndryshime spikasin më qartë, duke e coptuar kompozimin origjinal unitar, në një numër njësish të veçanta kompozicionale që shërbehen nga hyrje të shkëputura.



Fig. 2

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

Ndryshimet më të mëdha në kompozim i gjejmë pikërisht në grupin e banesave që nga ana kompozicionale paraqesin zgjidhje të veçanta. Në tipologjinë e banesës shqiptare, numërin më të madh dhe më me interes të këtyre zgjidhjeve e ndeshim në Berat, prandaj praktikisht kur flasim për këtë grup kemi parasysh kryesisht këtë qendër. Rindërtimi thuajse tërësor i katit të banuar, u shoqërua shpesh, veçanërisht në banesat me kompozim të shtrirë gjatësor, me prekje të theksuara të formulimit planimetrik origjinal, në të cilin ndihen qartë ndikimet e koncepteve të reja kompozicionale, që u shprehën qartazi në banesën korçare të kësaj periudhe.

Fusha, ku konceptet e reja gjetën një pasqyrim relativisht të gjërë, qe ajo e elementëve të ndryshëm arkitektonikë, të cilët iu nënshtruan një ritrajtimi të dalluar. Këto ritrajtime kryesisht patën si shkas prekjet në kompozimin e banesës, por nuk mungojnë dhe rastet, kur pa cënuar kompozimin, ritrajtimet përfshijnë vetëm elementët arkitektonikë, dhe përgjithësisht ata të pamjes kryesore. Nëse do të grupohen elementet arkitektonikë në ata të pamjes së jashtme dhe të brendshme, do të vëmë re se pamja e jashtme është ajo që preket më shumë, në krahasim me elementet e brendësisë. Këto trajtime, bëjnë që në dallim nga banesat paraardhëse, veçanërisht të të dy tipeve të zhvilluar, të kalohet drejt barastrajtimit arkitektonik të pamjeve të jashtme, dhe veçanërisht asaj kryesore, me pamjet e brendshme.

Në pamjen e jashtme, prirja kryesore është fshehja e konstruksionit nëpërmjet suvatimeve, façaturave, mbylljes së strehëve etj. Por duhet theksuar se përdorimi i gjërë i teknikës me skelet druri binte nevojën e këtyre elementeve jo vetëm për arsye të ripunimit të formës, por edhe të përmbajtjes, sepse ato ishin të nevojshme konstruktivisht. Gjatë kësaj periudhe, dritarja fillon të luaj një rol shumë me rëndësi në formulimin arkitektonik të banesës dhe veçanërisht të pamjes kryesore. Ndërsa në tipat e vjetër (fig. 1), ajo me përmasat e vogla, formulimin e thjeshta dhe numrin e kufizuar theksonte tiparet e mbyllura të banesës, tashti me hapësirat e mëdha, vendosjen harmonike në kompozimin e pamjes kryesore dhe ritmin e gjetur (fig. 2) bëhet një element i dorës së parë në vlerësimin e banesës. Ashtu si dhe më parë grupimi i dritareve në njësi treshe (fig. 3) dhe më rallë katërshe, mbetet karakteristika kryesore e kompozimit të tyre. Në Shqipërinë e Jugut dhe të Veriut, përgjithësisht këto grupe shquajnë si të tilla nga vendosja e dritareve pranë njëra tjetrës, ndërsa në Shqipërinë e Mesme ndeshen dhe raste të kornizimit me elementë druri, duke e trajtuar grupin prej tre dritaresh (fig. 4) si një bllok të vetëm. Dritaret në përgjithësi kornizohen thjeshtë me fashatura druri,

DO NOT COPY

duke pasur sipër një lloj bande më të gjërë, që të kujton një motiv neoklasik. Në Shqipërinë e Mesme është i përdorur dhe motivi me trekëndësh, ndërsa në Shkodër (fig. 5) ndeshet dhe një motiv i veçantë. Në Gjirokastër përdoret dhe fashatura në formë harku gjysëm rrethor, që kurorëzon dritaren mbuluar me arkitra.

Forma më e përhapur e dritareve, është ajo katërkëndëshe kënddrejtë. Me futjen e gjerë të xhamave, përgjithësisht hapësirat e dritareve kanë nga jashtë brenda, telajon me xhama e pas saj kanatat prej druri. Të dyja këto janë zakonisht me lëvizje vertikale, por ndeshen dhe zgjidhje me lëvizje horizontale. Në disa raste përpara telajove me xhama vendosen persiane dhe rrjetë hekurash.

Perdja me skelet druri që mbyll çardakun, zakonisht trajtohet me dritare me formulim të ndryshëm nga ai i ambientit apo ambienteve anash tij. Këto dritare mjaft të dendura dhe përgjithësisht të mbuluara me hark gjysëm rrethor (fig. 6) tregojnë qartë në pamjen kryesore, se i përkasin një ambienti me funksion të ndryshuar nga ata të banimit. Ndryshimi i trajtimit të ambienteve të banuar nga ata me funksione të tjerë, shihet qartë dhe në Berat, ku salloni i vogël qendror (fig. 7) shpesh në ballë në formën e qoshkut dallon si nga ritmi, ashtu dhe nga formulimi arkitektonik i dritares. Rindërtimet, veçanërisht në banesat e tre lagjeve-muze të Beratit, duke përjashtuar ato me çardak, kanë prurë një zbatim të gjerë të daljes së katit të banuar (fig. 8) në formë erkeri. Në



Fig. 6



Fig. 7



Fig. 5

disa raste të tjera pjesa qëndrore e katit të banuar del përtej planit të ballit në formë qoshku të mbyllur, duke i dhënë kompozimit një theksim të dalluar në qendër (fig. 3), i cili shquan dhe nga trajtimi i çatisë, disa herë me fronton. Erkeri, shumë i përhapur, në Berat, në lagjet mbi troje të pjerrët, ku terreni

DO NOT COPY



Fig. 8



Fig. 9

është tepër i kursyer, ka një domethënie të kuptueshme, por ai takohet në disa raste dhe në Gjirokastër (fig. 9) e më rrallë në qendra të tjera, për të lejuar sajimin e ambientit të ri, në kurriz të ambienteve të mëdhenj origjinalë, në raste rindërtimesh, apo edhe në ndërtimet e reja si një mënyrë ekonomike për të rritur sipërfaqen e banuar. Nuk mungojnë dhe rastet kur një dalje e vogël bëhet me funksione estetike. Edhe elementi i harkut me tre qendra, ndeshet veçanërisht në Berat, në formë frontoni apo për mbulimin e dritareve. Ai datón që në vitin 1854, në një banesë të rindërtuar (fig. 10) në lagjen Goricë të Beratit.

Suvatimi i katit të banuar, diktuar kjo nga teknika me skelet druri, pruri një ndryshim të madh në karakterin e banesës. Ajo tashti nuk kishte më pamjen e ashpër që ia jepte muratura e gurit. Volumet e ballit, shpesh të dalë në formë erkeri me dritare të mëdha, dhe me ngjyrën vezulluese të gëlqeres i dhanë një karakter krejt tjetër ansambleve kompakte të Beratit, si dhe banesave të veçanta të ritrajtuara.

Edhe strehëve, përgjithësisht, iu maskohet konstruksioni i tyre, me teknika të ndryshme. Për të ruajtur konstruksionin e trarëve, në muret me skelet druri, në ballë përdoren gjerësisht fashaturat e drurit të cilat, së bashku me kornizimet e dritareve, theksojnë më mirë volumet dhe planet transparente nëpërmjet një kontrasti të goditur të të dy materialeve.

Dekadat e para të fillimit të shek. XX veçanërisht në Tiranë, shënojnë kalimin nga fashaturat e drurit në kornizime të dritareve me teknikën e suvasë, e cila lidhej me ndërtimin e muraturës me qerpiç, apo me mur tulle.

Ndryshimet në kompozimin e banesës, veçanërisht në ato të Beratit, apo edhe sajimi i ambienteve të rinj në sipërfaqen e çardakut, shtruan dhe problemin e mënyrës së trajtimit të brendësisë së dhomave. Në përgjithësi, gjatë kësaj periudhe vërehet prirja për thjeshtëzimin e trajtimit të brendësisë së banesës, prirje e cila theksohet veçanërisht në dy dekadat e fundit të shekullit të kaluar. Kjo vërehet në ornamentikën më të thjeshtë dhe në ecjen drejt atrofizimit të kompleksit musandër-mafil. Pjesa e sipërme, mafili fillon e mbyllet, ndërsa shkallërisht krejt kompleksi kthehet në një perde të thjeshtë ndarëse,

si një atrofizim i kësaj njësie aq të përhapur në mbarë banesën qytetare të të katër tipave tradicionalë. Me teknikën e skeletit të drurit, shpesh në ballin fundor të dhomës si reminishencë e kompleksit musandër-mafil, ndeshet modeli në suva i harqeve të shurdhër, disa prej tyre çift (fig. 11) në qendër. Fillimi i përdorimit të orendive, po i jepte shtysën e fundit jo vetëm këtij kompleksi, por dhe dollapëve në mur si dhe sergjeneve, të cilët dhe ata tashmë kthehen në elementë formalë dekorativë, për të mos u ndërtuar më nga fillimi i shek. XX.

Përpunimi i pamjes së jashtme dhe thjeshtësimi i brendësisë bien shkallërisht barastrajtimin e tyre arkitektonik, si një tipar me rëndësi të arkitekturës së re.

Përbërësi i fundit, ku gjithashtu konceptet e reja gjejnë shfaqje, është ai që lidhet me teknikën e ndërtimit. Këtu është për tu vënë re kryesisht futja e gjerë në përdorimin e mureve me skelet druri veshur nga të dy anët me paretka mbi të cilat kalohet shtresa e suvasë me dy duar. Themi futja e gjerë në përdorimin e kësaj teknike për arsye se dhe më parë teknika me skelet druri njihej dhe zbatohej nga mjeshtrat popullorë në katër tipat e vjetër të banesës qytetare shqiptare. Këtë teknikë e ndeshim pikërisht në këto banesa me variante të ndryshme lidhur me mënyrën e realizimit të mbushjes së skeletit, duke filluar prej mbushjes me gurë e qerpiç e deri në thurjen (fig. 12) me gardh. Teknika e fundit, është tepër afër asaj të veshjes me paretka nga të dy anët e skeletit, e cila gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar pati një përhapje shumë të gjërë. Shkaqet e përhapjes së kësaj teknike duhen kërkuar në radhë të parë në zbatimin e gjërë të daljes së ballit të katit të banuar në formë erkeri, e cila domosdo kërkonte konstruksione të lehta muresh. Përveç kësaj muret me skelet druri, në dallim nga ata prej guri lejojnë ndërtimin e hapësirave të mëdha të dritareve në formë vargu. Kaq e vërtetë është kjo, sa dhe në tipat e vjetër, ndërtuar kryesisht me gurë apo me qerpiç, balli i odës së miqve me numër relativisht të madh dritaresh, tre (fig. 13) apo më rallë katër të tilla, ndërtohet me teknikën e skeletit të drurit. Pra shkaqet e përhapjes kaq të gjërë të teknikës së re, veçanërisht në Berat, si në muret e jashtëm dhe ata të brendshëm, mbajtës dhe ndarës, lidhet me konceptet e reja kompozicionale si dhe ato të formulimit arkitektonik, ndërsa në mbylljen e ballit të çardakut kjo teknikë ishte sheshit me parësi të dalluar.

Rrethanat shoqërore të përmendura më lart, të cilat qenë faktorët themelorë të shfaqjeve të reja, krijuan kushtet për kërkimin e rrugëve drejt adaptimit të tipeve të vjetër, e më tej të krijimit të një tipi të ri. Mjeshtrat shqiptarë me përvojë shumëshe-



Fig. 10

kullore, kuptuan shpejt kërkesat e kohës dhe me një aftësi të shquar arritën përfundime vërtet të goditura, sepse qenë njohës të mirë si të mënyrës së jetesës, ashtu dhe të artit të ndërtimit në përgjithësi.

Proçesi i ri i ndërtimeve, i cili preku tipologjinë tradicionale të banesës qytetare, që lidhej me for-



Fig. 11

DO NOT COPY



Fig. 12



Fig. 13

macionin feudal të shoqërisë, siç shpjeguam nuk qe uniform në mbarë tipat, dhe nuk u shtri barazisht në mbarë qendrat qytetare, gjithashtu dhe në kohë ky proces nuk u ndje kudo me fillesë të njëjtë.

Nga të katër tipat e banesës tradicionale, banesa me çardak qe ajo që iu nënshtrua një procesi të fuqishëm rindërtimesh, thelbi i të cilave mund të përmblidhet në synimin për të kaluar nga banesa e hapur në atë të mbyllurën.

Banesa me çardak, me përhapjen më të gjerë në tipologjinë tradicionale, karakterizohet në planin kompozicional nga vendi i rëndësishëm i tremave të hapura, barazisht në të dy katet e banesës. Këto banesa në arritjet më të goditura dhe përgjithësisht



Fig. 14



Fig. 15

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Fig. 16



Fig. 17



me volume të mëdhenj ndërtimi, lidheshin me shtresat e pronarëve të tokave, të cilët zinin një vend të rëndësishëm në strukturën klasore të shoqërisë qytetare të kohës. Banesa të thjeshta me çardak ndërtoheshin dhe nga shtresat e mesme të popullsisë. Tipi i banesës me çardak dhe në përgjithësi funksioni i çardakut, në kushtet e theksimit të tipareve qytetare në mënyrën e jetesës bëhej i pa pranueshëm, sepse ai tashmë nuk e justifikonte veten. Nevoja për ambiente të rinj, dhe lehtësia me të cilën mund të sajoheshin ata në strukturën e çardakut shpejtuan së tepërmi dukurinë e ndërtimit brenda volumit të tij të ambienteve të banuar, apo ndërlidhës. Mbyllja e çardakut shpesh nuk është një akt i vetëm, si në variantin me çardak në gjithë ballin, apo me çardak në një krah, kryhet me dy, apo më shumë faza, duke kaluar nga sajimi i një ambienti të vetëm (fig. 14) pastaj në një të dytë, deri në mbylljen e plotë të hapësirës qendrore, e cila për vetë vendin në kompozim nuk mund të shndrohet veçse në një sallon relativisht të madh, me funksione ndërlidhëse ashtu siç ishte fillimisht. Shembuj të tillë në fondin e trashigimisë sonë të këtyre banesave janë të shumtë. Kufizimi i ndërtimit të ambientit, apo ambienteve, në sipërfaqen e çardakut, është i përcaktuar nga dysnivelet, që shkëpusin qoshqet me funksione qendrimi (fig. 15) nga pjesa tjetër e çardakut me funksione ndërlidhëse. Qoshqet dyfishe gjithashtu, përgjithësisht formojnë dy ambiente banimi.

Struktura konstruktive e çardakut gjatë proçesit

DO NOT COPY



Fig. 18



Fig. 19

të rindërtimit kushtëzon qartë jo vetëm zhvillimin volumor të ambienteve të sajuara në të, por në një shkallë të ndjeshme dhe trajtimin arkitektonik të pamjes së jashtme. Hapi i shtyllave prej druri (fig. 16) praktikisht përcakton dhe vendvendosjen e dritareve. Duke ruajtur traditat pozitive të diferencimit të funksioneve të ambienteve dhe nëpërmjet trajtimit të pamjes së jashtme, e veçanërisht të dritareve në numër e formulim, salloni zakonisht shquan për dritaret e shumta (fig. 17) më të mëdha se ato të ambienteve. Dritaret e shumta të sallonit, ndërtohen përgjithësisht në çdo hapësirë të kollonadës prej druri, që formonte ballin e çardakut, duke ruajtur kështu ritmin fillestar.

Për arsye të kuptueshme rindërtimet në volumet e hapura nuk u kryen në të njëjtën kohë, ato fillojnë që rreth mesit të shek. XIX, e vazhdojnë deri vonë gjatë dekadave të para të shek. XX, pa arritur të përfshijnë mbarë banesat me çardak, prej të cilave sot e kësaj dite ruhen mjaft shembuj me ndryshime të pjesshme, apo më rrallë të pa cënuar. Pikërisht kohët e ndryshme në ritrajtimin e çardakut, shpjegojnë formulimet e ndryshme arkitektonike të tyre.

Gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, mbizotëron mbyllja me teknikën e skeletit të drurit dhe dritaret e kornizuara me fashatura dërrase, ndërsa gjatë shek. XX, siç shohim në shumë shembuj të banesave me çardak në Shkodër (fig. 18), kalohet në mbylljen me mure guri apo tullash, duke kaluar nga fashaturat e drurit në kornizime me teknikën e suvasë.

Krahas çardakut, edhe hajati i katit përdhe bëhet objekt ndryshimesh, por në dallim nga i pari, ai shpesh mbetet i tillë ende për një kohë, ose në disa raste kthehen në ambiente banimi një (fig. 19) apo dy katojt e ballit, duke mbetur hajati i pa cënuar. Përgjithësisht në banesat me çardak të ritrajtuara, në dekadat e para të shekullit tonë, objekt ndryshimesh bëhet mbarë kati përdhe, i cili siç dihet fillimisht ishte i pabanuar. Ky ndryshim me rëndësi të madhe në karakterin e banesës me çardak e tjetërson rrënjësisht atë përsa i përket përmbajtjes.

Krahas çardakut dhe shtëpia e zjarrit, ambienti më primitiv i banesës bëhet që heret objekt ndryshimesh, ndër të cilët me rëndësi janë, ndërtimi i tavanit, ndërtimi i tamburit për tërheqjen e tymrave nga vendi i zjarrit, zmadhimi i dritareve apo hapja e dritareve të reja etj.

Odat e banimit dhe veçanërisht ajo e miqve, për vetë trajtimin e përparuar, përgjithësisht nuk pësojnë ndryshime, pa përjashtuar rastet, kur edhe ato cënohen, dukuri kjo që lidhet kryesisht me fillimin e shekullit tonë.

Ndryshimet e mëdha që pësuan një pjesë e mirë e banesave me çardak gjatë periudhës në shqyrtim, i dhanë një trajtim krejt të ri veçanërisht pa-

DO NOT COPY



Fig. 20



Fig. 21

mjes kryesore, dhe padyshim që prekën dhe kompozimin e karakterin e banesës, e cila kështu bën një kapërcim cilësor nga banesa e hapur në atë të mbyllur.

Krahas banesës me çardak, edhe banesa gjirokastrite gjithashtu me arritje të shënuara për kohën, gjatë periudhës së gjysmës së dytë të shek. XIX, dhe dekadave të para të shekullit tonë pëson ndryshime. Por, ndërsa në banesën me çardak për vetë karakterin e saj, si dhe të natyrave ekonomike të qendrave ku ajo gjeti më tepër përhapje ndryshimet janë të shumta e të rëndësishme, në banesën gjirokastrite këto ndryshime janë më të pakta dhe më të rralla. Mungesa e një klase të fuqishme zejtaro-tregëtare dhe realizimet e goditura të banesës gjirokastrite, të cilat në shumë drejtime ende i përgjigjeshin kërkesave të kohës, janë shkaqet kryesore të kësaj dukurie. Megjithëkëtë as banesa gjirokastrite nuk qëndroi mënjanë nga fluksi i koncepteve të reja. Banesat e vjetra dhe këtu fillojnë të pësojnë ndryshime. Ndër to në radhë të parë duhet përmendur mbyllja e çardakut me perden karakteristike prej skelet druri (fig. 20), me dritare të shumta. Krahas saj përgjithësisht ritrajtohen dhe ballët e odave të katit të sipërm, mbyllen strehët etj. Në dallim nga tipi i banesës me çardak, banesa gjirokastrite, gjithë duke ruajtur skemat tradicionale kompozicionale, vazhdon të ndërtohet duke bërë të sajat disa koncepte të reja si largimin nga tremat e hapura, thjeshtësimin e dekoracionit, futjen e trajtave të reja në elementët arkitektonikë, veçanërisht të pamjes së jashtme etj. Aty nga fundi i shekullit të kaluar ndeshim dhe në banesa (fig. 21) në të cilat katit përdhe i janë hequr pjesërisht ambientet e katojve, duke ndërtuar në vend të tyre ambiente banimi. Në banesat e kësaj periudhe fillon të marë një përhapje të kufizuar dhe dalja e ballit të katit të sipërm, në formë erkeri, pjesërisht apo plotësisht. E njëjta dukuri ndeshet dhe në një pjesë të banesave të rikonstruktuara. Për tu shënuar janë dhe ndryshimet që filluan të pësojnë banesat me gjysmëkat perpendikular në Berat, Krujë dhe Gjirokastër, të cilat tipologjikisht përfshihen në tipin e banesës gjirokastrite. Kjo banesë u prek si në pamjen e jashtme, ashtu dhe në trajtimin e brendëshëm, veçanërisht në ambientin e shtëpisë së zjarrit. Në Krujë është për tu vënë re një dukuri lokale në ritrajtimin e ballit të katit të banuar, e cila ndeshet dhe në banesat e reja të ndërtuara gjatë kësaj periudhe. Është fjala për ndërtimin e një dritareje fare të vogël, sipër, përbri dritareve të zakonshme të ballit të qoshkut (fig. 22) apo të odës së miqve. Siç duket kjo duhet mbajtur si një reminishencë e dritareve të sipërme fikse, të përhapura gjerësisht në banesat e shtresave të pasura të popullsisë, gjatë shek. XVIII deri rreth mesit të shek. XIX.

Për tu theksuar, lidhur me banesën gjirokastrite, është dhe rënja e tipareve të saja mbrojtëse, gjatë kësaj periudhe si pasqyrim i kushteve të reja.

Banesa me hajat e përhapur gjerësisht në Shqipërinë e Mesme dhe veçanërisht në qytetin e Elbasanit dhe Kavajës, për arsyet shoqërore të shpjeguara më lart nuk u bë objekt ndryshimesh të rëndësishme. Megjithëkëtë dhe banesa me hajat, nuk qëndroi krejt jashtë përhapjes së dukurive të reja në konceptimin e banesës. Në radhë të parë këtu vjen në konsideratë shfrytëzimi i sipërfaqes së hajatit, për

DO NOT COPY



Fig. 22



Fig. 23

ndërtimin në të të ambienteve të banuar një apo më shumë të tillë. Gjithashtu brendësia e ambienteve të banimit, dhe kryesisht si i shtëpisë së zjarrit, pësojnë shpesh ritrajtime në dobi të krijimit të një komoditeti më të lartë.

Banesa tiranase, një prej tipave më realizime që mbeten dhe në variantet e zhvilluara afër banesës fshatare, për vetë natyrën dhe shkallën e zhvillimit ekonomik të qytetit të Tiranës, gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, pëson ritrajtime me ritme të ngadalshme. Kryesisht ato i përkasin ambienteve të banuara, ku zgjerohen dritaret dhe përpunohet brendësia e tyre, krahas mbylljes së tremave të hapura. Fillimet e shek. XX, dhe veçanërisht shpallja e Tiranës kryeqytet në vitin 1920, i dhanë një shtytje të re ritrajtimit të banesave të vjetra të këtij tipi. Tashti ato preken rrënjësisht në kompozim dhe trajtimin arkitektonik të brendshëm dhe të jashtëm. Shtëpia e zjarrit, me zhvillim të theksuar vertikal, ndahet më dysh, duke u përfshirë funksionalisht pjesa e sipërme në kompozimin e katit përkatës. Trajtimi i jashtëm bëhet në përputhje me format e kohës, ku dekoracionet në suva luajnë rolin kryesor. Në këto raste banesa tiranase mer një pamje krejt të re si në kompozim ashtu edhe në trajtimin arkitektonik, ku vetëm syri i specialistit mund të vërej shenjat e nënshtresës origjinale.

Tipologjia tradicionale e banesës qytetare shqiptare, natyrisht, që krahas katër tipave të njohur, përfshin dhe një mori zgjidhjesh të veçanta, të cilat i bashkuan me këtë tipologji programi, trajtimi kompozicional dhe formulimi arkitektonik.

Shkaqe të ndryshme si shoqërore ashtu dhe të natyrës së terrenit, truallit në dispozicion etj, kanë kushtëzuar kompozime të improvizuara ku me të vërtetë spikat një aftësi e shquar për krijime mjaft të goditura në shumë plane. Siç u përmend më lart, këto zgjidhje të veçanta i ndeshim të shumta dhe me vlera të mëdha sidomos në Berat dhe veçanërisht në tre lagjet-muze. Në të kaluarën në këto të fundit jetonin kryesisht shtresat prodhuese të qytetarëve, për të cilat ishte rezervuar trualli më pak i volitshëm për ndërtim, tepër shkëmbor dhe shpesh me pjerrësi të madhe. Ambientet relativisht të vegjël, të katit të banuar, ndriçimi mjaft i pakët, trajtimi i varfër dhe i ashpër i pamjeve kryesore etj., tashmë nuk mund të kënaqnin kërkesat jetësore të shtresave zejtaro-tregëtare gjithnjë në rritje. Siç përmendëm tërmeti i vitit 1851 i dha një shtytje të madhe procesit të rindërtimeve, i cili preku thellë veçanërisht tre lagjet-muze. Uniteti i madh në elementet e ndryshëm arkitektonikë të banesave të ritrajtuara, është një provë e periudhës së shkurtë gjatë së cilës u kryen këto rindërtime.

Ndryshimet në banesat beratase, gjatë kësaj periudhe, që përgjithësisht gjenden në tre lagjet muze i përkasin në pjesën më të madhe vetëm katit të sipërm, i cili është edhe ai i banuari (fig. 23), me përjashtim të disa shembujve të rrallë, ku banesa pjesërisht, apo plotësisht zhvillohet me tre kate, duke qenë kështu dhe ai i ndërmjemi i banuar. Por dhe në këtë rast zakonisht u ritrajtua pjesa ballore, e cila për vetë vendin në kompozim lejonte zgjidhje e trajtime të reja, në dallim nga pjesa fundore që i mbështetej shkëmbit, apo delte drejtpërdrejtë në rrugë me murin e prapmë.

Ambientet e kësaj pjese, shpesh të ndriçuara vetëm nga baha, praktikisht ofronin mundësi shumë të pakta për ritrajtime. Nga sa u tha kuptohet se fusha e ndryshimeve në kompozim ishte relativisht mjaft e kufizuar. Megjithkëtë përpjekjet qenë serioze dhe prunë mjaft ndryshime në banesat e këtyre lagjeve. Një parim kompozicional, që u përhap gjerësisht në këtë periudhë, është ai i sajimit në qendër të kompozimit të një lloj divani të vogël, disa herë të dalë përtej ballit të ambienteve anësore, i cili është një qoshk i mirëfilltë qëndrimi. Ky parim të kujton atë të banesës korçare, siç do të shohim më poshtë. Funksioni i këtij divani me qoshk (fig. 3) diferencohet qartë dhe në trajtimin e jashtëm të dritareve në formë, apo edhe në madhësi. Por mjaft të përhapura janë edhe kompozimet e ambienteve në formë vargu në ballë duke pasur në pjesën qendrore një koridor gjatësor ndërlidhës. Erkeri arrin një shtrirje shumë të gjerë, duke gjetur vendin e mirëfillt të përdorimit, në dobi të rritjes së sipërfaqes së banuar, pa cënuar rrugën, si një zgjidhje që tashmë kishte gjetur terren të zbatohej. Skeleti i drurit bëhet protagonisti kryesor në fushën e teknikës së ndërtimit, duke mundësuar si daljen në formë erkeri, ashtu dhe dritaret e shumta dhe të dendura, që formojnë grupime dyshe dhe më shumë treshe, apo janë kompozuar në formë vargu. Edhe harku me tre qendra (fig. 24) e më rrallë frontone trekëndësh, nuk mungojnë. I pari ndeshet në një datim relativisht të hershëm më 1854 (fig. 10), i cili lidhet me rindërtimin e kësaj banese. Volumi i madh i katit të banuar, i cili del shpesh drejtpërdrejt në rrugë në formë erkeri në ballët dhe vendosja e ndërtimeve në formë brezash për shkak të truallit të pjerrët, humbasin thuajse krejtësisht gjurmët e gjendjes origjinale të cilat ruhen vetëm në pjesën e katit përdhe, shpesh të paprekur. Kështu këto tre lagje morën një pamje krejt të re, e cila pa cënuar kompaktësinë e ndërtimeve dhe skemën e arritur kompozicionale të këtyre ansambleve të realizuar



Fig. 24

rreth dy shekuj më parë, mori një veshje të re, në përputhje me nevojat dhe shijet e kohës.

Vala e gjerë e rindërtimeve, që përfshin ku, më shumë e ku më pak mbarë tipologjinë e banesës qytetare dhe të gjithë qytetet tanë, shënon një fazë të rëndësishme në historinë e zhvillimit dhe tipareve të banesës qytetare, duke shprehur qartazi karakterin evolutiv të kësaj kategorie në lidhje të ngushtë me kushtet ekonomiko-shoqërore. Dukuria e rëndësishme dhe mjaft e përhapur e rindërtimit të banesave të tipologjisë së vjetër, e cila gjendej e përshtatshme kryesisht për arsye ekonomike, bënte të natyrshme që krahas saj të fillonin dhe kërkimet për arritjen në një tip të ri. Këtë të fundit, i cili kishte në thelbin e karakterit të tij plotësimin e kërkesave jetësore të shtresave zejtaro-tregëtare, që tashmë kishin arritur të krijonin tregun e brendshëm kombëtar, e priste një shtrirje e gjerë, në dallim nga tipologjia tradicionale e larme, dhe mund të themi me tipare të theksuara lokale.

Lindja e tipit të ri gjeti terrenin më të përshtatshëm në qytetin e Korçës, duke filluar realizimet konkrete pikërisht rreth mesit të shek. XIX. Ky qytet, qendër relativisht e parëndësishme deri nga shek. XVII, më vonë dhe sidomos pas shkatërrimit të Voskopojës, merr një zhvillim tepër të vrullshëm, duke u kthyer në një qendër të mirëfillt zejtaro-tregëtare. Duke pasur përreth një zonë të gjerë të populluar mirë, që ushtronte bujqësinë e blegtorinë, e lidhur me rrugë karvanesh me Shqipërinë e Mesme, Maqedoninë dhe Epirin, Korça kristalizon relativisht shpejt karakterin e një qendre prodhimi e këmbimi, duke

DO NOT COPY



Fig. 25

arritur të bëhet gjatë shek. XIX, një qytet i rëndësishëm i Shqipërisë së Jugut.

Rruga e rindërtimit të banesave të vjetra në këtë qendër nuk gjente terren, qoftë për arritjet modeste të banesave tradicionale, qoftë për rritjen e vrullshme të shtresave zejtaro-tregtare, të cilat nuk mund të pajtoheshin me zgjidhje gjysmake, por kërkonin të materializonin sa më parë, në banesë, pozitën dhe karakterin e klasës që përfaqësonin. Forca ekonomike relativisht e madhe e këtij qyteti, veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, është në themel të rrugës origjinale në realizimin e synimit për të materializuar tiparet e borgjezisë së re në banesë, në dallim nga rruga që zgjodhën këto shtresa në qytetin e Beratit, Borgjezia shkodrane, megjithëse e fuqishme ekonomikisht duke qenë e lidhur ende ngushtë me pronat, e duke pasur banesa të mëdha dhe të kushtueshme me çardak, i gjen ato ende të përshtatëshme dhe mjaftohet me ndryshime të pjesshme.

Pra qyteti i Korçës përmbushte kushtet për të marrë parësinë në lindjen dhe zhvillimin e tipit të ri, i cili në mbarë karakterin dhe trajtimin e tij plotësonte të gjitha kushtet për tu cilësuar banesë e mirëfillt qytetare, e lidhur me stadin e ulët të zhvillimit të marëdhënjeve kapitaliste.

Ashtu si shoqëria feudale, dhe formacioni i ri i shoqërisë borgjeze në vendin tonë, i cili do të bartte për shumë kohë mbeturina të shoqërisë feudale, dallohet për një diferencim të theksuar klasor brenda shtresave të shoqërisë qytetare, i cili sa vinte dhe bëhej më i mprehtë. Pikërisht ky fakt duhet shikuar si fakori thelbësor i asaj morfologjie të pasur të banesës korçare[2], e cila përfshin një numër relativisht të madh variantesh dhe nënvariantesh. Banesa korçare dallohet për skemat e ngjeshura e racionale kompozicionale, në të cilat të bie në sy salloni qendror dhe ambientet e banimit anash. Variantet e ndryshme, duke ruajtur këtë koncept rriten në mënyrë sasiore, si brenda të njëjtit kat, apo duke kaluar nga banesa një katshe në atë dykatshe, duke përjashtuar katin e podrumit, i cili si një karakteristikë lokale e Korçës, ka zhvillim të pjesshëm, apo të plotë si katet e banuara. Shkallët për në kat, zhvillon zakonisht në fund të sallonit. Në sallonin e katit të sipërm, në formën e qoshkut të mbyllur zgjerohet përtej ballit një volum në formë erkeri, apo i mbajtur nga dy apo katër shtylla. Ky element, mjaft i përhapur në Korçë, e më mjaft në pah qendrën e pamjes kryesore, duke i dhënë një lëvizje të theksuar volumeve të ndërtimit.

Banesa e re, nuk duhet mbajtur si një dukuri e shkëputur krejtësisht nga tradita e vjetër, por si një mohim dialektik i saj. Koncepte, madje dhe kompozicionale të tipave të vjetër i gjejmë dhe në banesën e re. Ajo duke mbetur në kuadrin e krijimtarisë popullore, trashëgoi tiparet pozitive, të cilat e karakterizojnë atë, në arritje që ishin në përputhje me kushtet e reja të jetës. Siç përmendëm kjo banesë pati një përhapje të gjërë dhe relativisht të shpejtë në Korçë.

Rreth viteve 1870 ndërtohen banesa të mëdha të varianteve të zhvilluara të cilat flasin qartë për ritmet e shpejta të ecurisë. Siç përmendëm, përgjithësisht gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, tipi i ri i banesës përhapet kryesisht në Korçë. Këtu mund të përmenden dhe tre banesa të një familje të madhe feudale në Tiranë (fig. 25) në të cilat shihen konceptet e banesës së re në variante mjaft të zhvilluara. Duke qenë pa asnjë lidhje me tipologjinë e banesës tradicionale të këtij qyteti, ato duhen parë në kuadrin e gjerë të arritjeve të banesës ballkanike të kohës, çka përligjej nga vetë përkatësia klasore e banuesve të këtyre ndërtesave.

Në elementet e ndryshëm arkitektonikë të pamjeve të jashtme të tipit të ri gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, mbisundojnë format e njohura të kornizimeve me dru, brendësia thjeshtohet së tepërmi, duke u shkarkuar nga ornamentika dhe duke ngushtuar, apo edhe hequr krejt nga repertori musandrat, dollapet e murit etj.

2) E. Riza, B. Strazimiri, **«Vështrim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës»**, Monumentet 3/1972.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Fillimi i shek. XX, shënon një përhapje mjaft të gjerë të tipit të ri në mbarë qytetet e vendit tonë. Natyrisht në ato qëndra ku zhvillimi pati rritjen e natyrshme, ai nuk kishte si të bëhej mbizotërues, përkundrazi në qendrat me zhvillim të shpejtë, siç qe rasti i Tiranës, tipi i ri gjeti një terren shumë të përshtatshëm. Janë këto arsyet, që veçanërisht pas shpalljes të Tiranës kryeqytet, tipi i ri thuajse me të gjithë variantet e tij merr një përhapje tepër të gjerë, duke e bërë Tiranën, përveç Korçës qytetin ku mund të ndiqet lehtë karakteri dhe tiparet e kësaj banese. Gjatë kësaj periudhe, dmth në dekadat e para të shek. XX, teknikat me dru pësojnë një rënie të përgjithshme si për ndërtimin e mureve, ashtu dhe si elementë veshës në pamjen kryesore. Përdorimi i gjerë i tullave në Korçë dhe i qerpiçit në Tiranë, vunë në plan të parë si material dekorativ suvanë. Prandaj gjatë kësaj periudhe ndeshim në një përhapje shumë të gjerë të kësaj teknike duke marrë motive nga repertori i vjetër, krahas futjes së elementeve dhe kompozimeve të reja.

Banesa korçare, si një tip banese që lidhet drejtpërdrejt me plotësimin e kërkesave për banim të shtresave të ndryshme të borgjezisë, mbyll atë histori të gjatë e të pasur arritjesh në lëmin e banesës popullore qytetare që ka për protagonista mjeshtrin e talentuar popullor.

Lindja dhe zhvillimi i marëdhënieve kapitaliste në vendin tonë krahas reflekseve në tipologjinë dhe karakterin e banesës qytetare, gjen shprehjen dhe në urbanistikën e kësaj periudhe. Por duhet theksuar se ndërsa në banesë ndryshimet janë të shpejta dhe me një shtrirje relativisht të gjerë, përsa i përket urbanistikës të rejat vinë në mënyrë të kufizuar, pra me një shtrirje të vogël e madje të vetme, pikërisht në qytetin e Korçës. Urbanistika mesjetare sipas së cilës ishin konceptuar si zonat e banuara, ashtu dhe ajo ekonomike, kishte në bazën e saj mungesën e planifikimit. Ajo karakterizohej nga zgjidhje të improvizuara, me një rrjetë rrugor pa një kriter të qartë. Pa mohuar arritjet e goditura veçanërisht, në qytetet apo lagjet mbi troje të pjerrët, urbanistika mesjetare e paraqiste mangësi të dalluara, të cilat lidheshin me atë fazë zhvillimi të shoqërisë shqiptare që kushtëzohej nga kufizimet e rendit feudal. Fillimi i lindjes së marëdhënieve kapitaliste pati reflekse të vonuara, apo më saktë mjaft të kufizuara në urbanistikë, për aryse se në mjaft qytete skemat e vjetra urbanistike ishin konsoliduar prej kohësh, ndërsa ndërtimet e reja nuk përbënin një volum tepër të



Fig. 26

madh. Një far inercie në këtë drejtim, lidhur me vetë natyrën kontradiktore e të prapambetur të shoqërisë së kohës bënë që edhe në rastet e ndërtimeve të shumta si në Shkodër, të vazhdohet tradita e vjetër e rrugëve plot dredhime e pa krye, që lidhnin pa kritere të paracaktuara mbarë qytetin.

Ashtu si në banesë dhe në fushën e urbanistikës, pikërisht në Korçë, ndeshim për herë të parë në vendin tonë zbatimin e planifikimit në ndërtimin e lagjeve të banuara. Kjo dukuri shfaqet në një periudhë relativisht të hershme[3] madje dhe për Ballkanin, duke i pasur fillimet rreth mesit të shek. XIX.

Në lagjet e reja të qytetit të Korçës (fig. 26) këto koncepte shprehen me arritje të përparuara për kohën. Në bazën e urbanistikës së re qëndron sistemi i rrjetit kuadratik, i cili formohet nga parcela ndërtimi, që përftohen nga ndërprerja e një sistemi rrugësh normal njëra tjetrës. Buzë rrugës, apo

3) P. Thomo **«Mbi urbanistikën dhe arkitekturën e qytetit të Korçës»,** Monumentet historike», Tiranë, 1978.

më tej saj ndërtohen banesat, njëra pranë tjetrës, me oborre të vegjël. Rrugët e shtruara me kalldrëm, kanë anash trotuare dhe pranë tyre kunetat për largimin e ujrave të rreshjeve. Ky koncept ishte një e re me ndryshime thelbësore nga urbanistika tradicionale. Krahas zonës së re të banuar, ky koncept urbanistik fillon të gjejë zbatim edhe në qëndrën zejtaro-tregëtare të qytetit, në pazar. Lidhur me kohën e futjes së këtij koncepti në pazarin e Korçës mendimi i sotëm[4] e shtyn shfaqjen e kësaj dukurie më herët vitit 1879, që lidhet me zjarrin e madh, që përfshin pazarin. Ky zjarr u bë shkak për një përhapje të shpejtë të të rejave urbanistike, duke e prurë qendrën ekonomike të qytetit të Korçës thuajse në formulimin që ruhet ende edhe sot.

Krahas ritrajtimit urbanistik të pazarit të Korçës, i cili gjithashtu si ai i lagjeve të banuara, në këtë qendër mbeti një dukuri e rrallë, me përhapje mjaft të gjerë ndeshim ritrajtimin e godinave themelore të ansambleve të pazareve, dyqanet. Këta të fundit gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, me një rritje progresive me kalimin e kohës i nënshtrohen ritrajtimeve, apo edhe rindërtimeve tërësore në frymën e arritjeve të reja të kohës. Kjo dukuri përfshiu mbarë qendrat e vendit, por më fortazi shfaqet në Korçë dhe Gjirokastër[5]. Në këtë trajtim, fillojnë të ndryshojnë veçanërisht ballët e dyqaneve, duke zëvëndësuar tarabat dhe qepenet prej druri, me qepenë dhe rulo metalike. Futja e këtyre elementeve dhe në përgjithësi kalimi nga materialet e ndërtimit prej druri, në ata më të qëndrueshëm, si guri e tulla, prunë zhdukjen e strehëve të gjëra karakteristike, që i jepnin aqë shumë tipare piktoreske pazareve të vjetër.

Përfundimisht mund të pohohet se lindja dhe zhvillimi i marëdhënieve kapitaliste në vendin tonë, pati pasqyrim relativisht të shpejtë në tiparet dhe karakterin e banesës qytetare, madje në ndonjë rast ai ndikon dhe në fushën e urbanistikës, duke prurë kështu, krahas shumë fakteve të tjera një dëshmi më shumë të kushtëzimit të drejtimeve kryesore të dukurive arkitektonike nga ato ekonomiko-shoqërore.

DO NOT COPY

4) Në këtë përfundim ka ardhur kolegu Pirro Thomo, i cili merret me studimin urbanistiko-arkitektonik të qytetit të Korçës.

5) Emin Riza. **«Ansamblet ndërtimore të pazareve dhe restaurimi i tyre»,** Monumentet 15-16; 1978.

Emin RIZA

DO NOT COPY

L'HABITATION URBAINE ALBANAISE AU COURS DE LA SECONDE MOITIE DU XIXe SIECLE, JUSQU'AU PREMIER QUART DU XXe SIECLE ENVIRON

RESUME

L'habitation urbaine albanaise par les recherches et études faites jusqu'à ce jour, a été suivie dans son évolution générale au cours des cinq derniers siècles, étant donné que les XVIIIe-XIXe siècles et les débuts du XXe siècles ont été relativement riches en matériels de fait. Les premières décennies du XXe siècle continuent, comme traditionnellement, à conserver cette activité constructrice, à l'intérieur des cadres de la création populaire, pour donner lieu, graduellement, aux constructions qui ont été précédées de projets dressés par des architectes.

L'habitation urbaine, ainsi que, l'habitation en général, est liée étroitement, dans ses parties constituantes, aux conditions économiques et sociales. Justement cette réalité est la cause des distinctions essentielles entre la typologie, et, en général, les caractéristiques de l'habitation urbaine, liée aux deux formations économiques et sociales du féodalisme et du capitalisme. Les études, faites jusqu'à ce jour, ont démontré que c'est au milieu du XIXe siècle environ, qu'il faut chercher la limite temporelle approximative du début du reflet sur l'habitation de ce processus important dans la vie économique et politique du pays, qui était lié à la naissance et au développement des relations capitalistes, et au grand mouvement de la Renaissance Nationale. C'est exactement cette limite qui, dans la typologie de l'habitation urbaine albanaise, sépare deux grands groupes d'habitations, qui sont liés respectivement à chacune des formations économiques et sociales.

L'habitation urbaine albanaise relative à la formation féodale de la société, dans la période mentionnée plus haut, se fait remarquer par une série de traits, parmi lesquels les plus évidents sont: la typologie riche et différentes étendues, son évolution relativement lente, le lien étroit entre cette typologie et l'habitation rurale, spécialement dans les variantes simples, etc. Ces traits l'expliquent par le morcèlement économique féodal, les rythmes de développement, relativement lents, l'engagement d'une partie de la population dans l'économie agricole, l'économie familiale relativement close, etc.

La naissance et le développement des rapports capitalistes, dans notre pays, l'a naissance et le renforcement des nouvelles couches de la bourgeoisie, qui amena d'importants changements dans la structure de classe de la société urbaine de l'époque, eut une influence directe sur la caractère et la typologie de l'habitation. Les différentes couches de la société bourgeoise, différaient essentiellement de celles prédécesseurs par le mode de vie, qui exigeait forcément sa matérialisation dans les habitations, en tant que catégorie de construction liée directement à la nature de la société, dans le large sens du mot. Presque dans toutes nos villes, plus ou moins, selon l'échelle de développement de chacune, se font sentir des efforts de refléter dans l'habitation les nouvelles conceptions. Sans nier complètement les réalisations précédentes, mais en s'appuyant puissement sur elles, ces conceptions ont donné lieux à un développement relativement rapide vers les réalisations, qui se distinguaient essentiellement de celles traditionnelles. De même que dans chaque processus historique dans le cas précis, on n'assiste pas à une rupture irrévocable simultané avec les conceptions anciennes, dans tous les centres. Etant en face d'un processus dialectique de croissance, le passage s'effectue de façon et par degrés différents dans des centres différents, conformément à la puissance économique des nouvelles couches de la bourgeoisie, et à l'échelle des réalisations de l'habitation traditionnelle.

Justement, en ayant à la base les causes sus-mentionnées, durant la seconde moitié du XIXe siècle, et plus tard dans l'habitation urbaine albanaise, se font observer deux phénomènes importants, qui de façons différentes reflètent la tendance générale à matérialiser les conceptions nouvelles dans l'habitation. Le premier phénomène est lié à un vaste et important processus de reconstruction de types anciens. De pair avec ce phénomène, on se heurte à un autre phénomène parallel au premier, à celui de la naissance d'une nouveau type d'habitation, liée directement aux exigences des différentes couches de la nouvelle bourgeoisie. Soulignons que la naissance du nouveau type, laquelle ne touche pas de façon égale tous les centres urbains, n'a pas été accompagnée de la renonciation à la construction de types anciens, dont certains, qu'on vient de citer, continuent à être construits avec modifications, de pair aux cas de conservation de compositions antérieures. La poursuite des recherches sur le second phénomène est re-

DO NOT COPY

lativement difficile, à cause du manque de datation, mais on ne doit pas le nier. Les deux processus importants, celui des reconstructions et celui de la naissance du nouveau type constituent des rapports différents dans le temps et dans l'espace. Au début, le premier processus est assez large et cède graduellement sa place au second, c'est à dire à la vaste propagation de la construction d'habitations nouvelles, selon les conceptions de l'époque.

Les reconstructions avaient des étendues différentes, conformes aux types différents. Il faut en chercher les causes principalement dans deux circontances. Primo, les modifications furent subies par les types ouverts, et avant tout, celui de l'habitation à varangue, déjà condamnée historiquement. Secondo, se soumirent aux modifications les anciens types, qu'on peut appeler anachroniques, telle l'habitation de Tirana, liée étroitement aux restes de conceptions patriarcales. Tandis que l'habitation à porche et celle de Gjirokastër, sentent le flux des nouvelles conceptions, mais en passant.

Dans les processus de reconstruction, les nouvelles conceptions se font évaloir, surtout, par la fermeture des espaces ouvertes, par la tendance de l'écart des habitations à volumes inhabitées du rez-de-chaussée, lorsque cela était réalisable, par l'élargissement de l'éclairage des pièces habitées, par l'égalité de traitement des parties extérieures et de celles intérieures, en simplifiant le traitement intérieur et en élaborant encore plus le traitement extérieur, en introduisant largement la technique des ossatures de bois etc.

Les changement dans la typologie de l'habitation traditionelle, peuvent être suivis dans ses trois parties composantes principales et notamment dans la composition, le traitement architectonique et la technique de construction. La composition des habitations traditionnelles, liées à la formation féodale de la société, en général, pour des raisons compréhensibles, n'est pas encore touchée des changements, que subirent ces habitations. Pourtant le degré de changements de composition sur certains types d'habitations est plus sensible, parce qu'elles répondaient à une échelle de développement relativement basse, même à l'intérieur du cadre de l'économie féodale.

Les plus grands changements de composition, on les relève chez le groupe d'habitations présentant du point de vue de la composition, des solutions particulières. Dans la typologie de l'habitation albanaise, le plus grand nombre de ces solutions, qui présentent le plus d'intérêt, est possédé par Berat; par conséquent lorsqu'on parle de ce groupe, pratiquement, on a présent à l'esprit, avant tout, ce centre-ci. La reconstruction quasi intégrale du rez-de-chaussée, fut souvent accompagnée, particulièrement dans les habitations de composition à étendue longitudinale, de modifiactions importantes dans la formulation planimétrique originale, où l'on sent clairement l'influence des nouvelles conceptions de compositions, qui s'exprimèrent de façon évidente dans l'habitation de Korçë de cette époque-là.

Le domaine, où les nouvelles conceptions trouvèrent un reflet relativement large, fut celui des différents éléments architectoniques, qui furent l'objet d'un nouveau traitement distingué.

Les causes de ces nouveaux traitements se trouvaient dans les modifications de composition de l'habitation, mais il ne manque pas les cas, où, sans porter atteinte à la composition, les nouveaux traitements touchent uniquement les éléments architectoniques, et généralement ceux de la vue principale. Si l'on regroupe les éléments architectoniques de la vue extérieure et intérieure, on s'apperçoit que la vue extérieure est celle qui est touchée le plus, en comparaison avec les éléments de l'intérieur, Ces traitements font en sorte que différemment, aux habitations précédentes, spécialement aux deux types évolués, on va vers l'égalité de traitement architectonique des vues extérieures, particulièrement de celle principale, et des vues intérieures.

Quant à la vue extérieur, la tendance principale consiste à cacher les éléments de la construction au moyen de crépis, de façades, par la fermeture des avants-toits, etc. Au cours de cette période, la fenêtre commence à jouer un rôle de très grande importance dans la formulation architectonique de l'habitation et, en particulier, de la vue principale. Alors que chez les types anciens, la fenêtre aux petites dimensions, à la formulation simple et en nombre limité, accentuait les trois clos de l'habitation; maintenant avec les grandes espaces, la disposition harmonique dans la composition de la vue principale et le rythme de choix, elle devient un élément de premier ordre dans l'appréciation de l'habitation.

Les reconstructions, particulièrement celles des habitations des trois quartiers de Berat, en excluant celles à varangue, ont amené une large application de la saillie de l'étage habite en forme de bow-window. Dans certains autres cas, la partie centrale de l'étage habité sort au delà du plan de face, en forme d'encorbellement fermé, en donnat à la composition une accentuation, distinguée au centre, qui se distingue même par le traitement du toit, parfois à fronton. Le bow-window, très répondu à Berat, aux quartier sur terrain en pente, qui est très limité, a un sens saisissable, mais il se trouve dans certains cas, même à Gjirokastër et plus rarement à d'autres centres, pour permettre la création de nouvelles pièces, aux dépends des vastes volumes originaux, aux cas de reconstructions, ou même de nouvelles constructions, en tant que manière économique d'élargir la surface habitable.

En général, au cours de cette période, on constate la tendance à la simplification du traitement de l'intérieur de l'habitation, tendance qui s'accentue particulièrement pendant les deux dernières décennies du siècle passé. On relève ceci dans l'ornementation simple et la marche vers l'atrophie du complexe placard-mafil.

Le commencement de l'usage de meubles, donnait la dernière poussé non seulement à ce complexe mais aussi aux armoires, appliquées au mur, et aux dressoirs, qui deviennent déjà des éléments formels décoratifs, pour tomber en désuétude vers le début du XXe siècle. L'élaboration de la vue extérieure et la simplification de l'intérieur amène graduellement leur égalité de traitement architectonique, en tant que trait d'importance de l'architecture nouvelle.

Les derniers composants, où apparaissent encore les con-

DO NOT COPY

ceptions nouvelles, sont ceux qui se lient à la technique de construction. On relève là, avant tout, la large entrée en usage de murs à ossature de bois. On dit bien large entrée en usage de cette technique parce que la technique d'ossature en bois était connue même auparavant et appliquée par les maîtres populaires sur les quatre anciens types de l'habitation albanaise. Les causes de la propagation de cette technique doivent être cherchées tout d'abord dans la large application de la saillie du front de l'étage habité en forme de bow-window, qui exigeait, absolument, de légères constructions de murs. A part cela, les murs à ossature de bois, différemment à ceux de pierres, permettent la construction de grandes espaces de fenêtres en file.

Les circonstances sociales furent les facteurs fondamentaux des nouvelles manifestations, elles créèrent les conditions de recherche des nouvelles voies, vers l'adaptation des types anciens, et ultérieurement la création d'un nouveau type. Les maîtres albanais, munis d'une expérience étalée sur plusieurs siècles, saisirent rapidement les exigences de l'époque et faisant preuve d'aptitudes remarquables, obtinrent des résultats, vraiment réussis, parce qu'ils étaient de bons connaisseurs du mode de vie, ainsi que de l'art de construction en général.

Le processus de construction, qui toucha à la typologie traditionnelle de l'habitation urbaine, lié à la formation féodale de la société, comme on vient de l'expliquer, ne fut pas uniforme avec tous les types, et ne fut pas étendu de façon égale, sur tout les centres urbains; et dans le temps aussi les débuts de ce processus ne furent pas sentis partout pareils.

Des quatre types de l'habitation traditionnelle, l'habitation à varangue fut celle, qui se soumit à un puissant processus de reconstruction, dont l'essence peut être résumée dans l'intention de passer de l'habitation ouverte à celle fermée.

L'habitation à varangue, qui a l'étendue la plus large dans la typologie traditionnelle, se caractérise, sur le plan de la composition, par la place importante accordée aux vestibules ouverts de façon égale aux deux étage de l'habitation. Le type d'habitation à varangue et généralement la fonction de la varangue, dans les conditions d'accentuation des traits urbains du mode de vie, devenaient inacceptables, parce que déjà ils ne se justifiaient pas. Le besoin de pièces nouvelles et l'aisance avec laquelle elles pouvaient être aménagées, dans la structure de la varangue, accélérèrent sensiblement le phénomène de construction, à l'intérieur de son volume, des pièces habitées ou intermédiaires.

Pour des raisons compréhensibles les reconstructions des volumes habités ne furent pas entreprise à la même époque, elles débutent dès le milieux du XIXe siècle environ, sans arriver à inclure toutes les habitations à varangue, dont on conserve encore de ce jour assez d'exemples en différences partiels, ou plus rarement intacts. Ce sont précisément les différentes époques de traitement nouveau de la varangue, qui expliquent leurs formulations différentes architectoniques.

De pair avec la varangue, le porche de rez-de-chaussée aussi devient objet de changement, mais différemment à la première, il reste tel, encore pour un certain temps, ou dans quelques cas une ou deux volumes de front, au rez-de-chaussée se transforment en pièces habitées, le porche demeurant intact. Généralement, chez les habitations à varangue, traitées de nouveau, au cours des premières décennies de notre siècle, devient objet de modifications le rez-de-chaussée tout entier, lequel, comme on le sait déjà, était inhabitable à l'origine. Ce changement de grande importance du caractère de l'habitation à varangue transforme radicalement celle-ci quant au contenu.

Parallèlement à la varangue, la maison du feu, la pièce la plus primitive de l'habitation, devient très tôt objet de modifications.

De même que l'habitation à varangue, l'habitation de Gjirokastër aussi par exploits remarquables pour l'époque, durant la période de la seconde moitié du XIXe siècle et les premières décennies de notre siècle, subit des changements. Mais, tandis que l'habitation à varangue, par son propre caractère ainsi que par la nature économique des centres où elle fut le plus répandue, à Shkodër et Berat, subit des changements nombreux et importants les changements de l'habitation de Gjirokastër sont moins nombreux. Malgré cela, l'habitation de Gjirokastër ne reste pas, non plus, à l'écard du flux des conceptions nouvelles. Les habitations anciennes commencent, même ici, à subir des changements, dont on doit tout d'abord mentionner la fermeture de la varangue par le rideau caractéristique à charpente de bois, aux multiples fenêtres. En même temps qu'elle en général, on traite de nouveau même les fronts des pièces de l'étage supérieur, on ferme les avant-toits, etc. Différemment au type d'habitation à varangue, l'habitation de Gjirokastër, tout en gardant les schémas traditionnels de composition, continue à être construite, en faisant siennes quelques conceptions nouvelles comme l'abandon des vestibules ouverts, la simplification de la décoration, l'introduction des traits nouveaux dans les éléments architectoniques, spécialement la vue extérieur, etc. Vers la fin du siècle passé, on rencontre aussi des habitations où l'on a partiellement supprimé les volumes des caves au rez-de-chaussée, en construisant à leur place des pièces habitables. Dans les habitations de cette période-là, même la saillie du front de l'étage supérieur en forme de bow-window, partiellement ou complètement, commence à prendre une propagation limitée. Le même phénomène apparait aussi dans une partie d'habitations reconstruites.

Concernant l'habitation de Gjirokastër, il est à souligner aussi la chute de ses traits défensifs, au cours de cette période, en tant que reflet des conditions nouvelles.

L'habitation à porche, largement propagée dans l'Albanie Centrale et particulièrement dans la ville d'Elbasan et de Kavajë, ne devint pas objet de changements importants. Cependant, même l'habitation à porche ne demeura pas tout à fait au dehors des phénomènes nouveaux, dans la conception de l'habitation. Premièrement, il est à prendre en considération l'exploitation de la surface du porche consistant dans la

DO NOT COPY

construction d'une ou plus de pièces habitées. L'intérieur des volumes habitables également, et principalement celui de la maison du feu, subit souvent de nouveaux traitement, en faveur de la création d'une commodité plus grande.

L'habitations de Tirana, l'un des types à réalisations, qui demeurent même dans les variantes évoluées voisines de l'habitation rurales en raison de la nature même et du degré de développement économique de la ville de Tirana, au cours de la seconde moitié du XIXe siècle, subit de nouveaux traitements à rythmse lents. Ils touchent surtout les pièces habitées, dont on élargit les fenêtres et l'on élabore l'intérieur, en même temps qu'on ferme les vestibules ouverts. Ces débuts du XXe siècles, et particulièrement la proclamation de Tirana, capitale d'Albanie en 1920, donnèrent une nouvelle poussée au nouveau traitement des habitations anciennes de ce type. Elles sont maintenant radicalement touchées dans la composition et dans le traitement architectonique intérieur et extérieur. La maison du feu, à développement accentué vertical, se sépare en deux, la partie supérieur s'incluant fonctionnellement dans la composition de l'étage correspondant. Le traitement extérieur se fait conformément aux formes de l'époque, où les décorations sur le crépi jouent un rôle de premier ordre. Dans ces cas, l'habitation de Tirana prend une vue tout à fait nouvelle, du point de vue de la composition et du traitement.

La grande vague de reconstructions, qui touche plus ou moins la typologie entière de l'habitation urbaine et toutes nos villes, marque une phase importante dans l'histoire de l'évolution des traits de l'habitation urbaine, en exprimant clairement le caractère évolutif de cette catégorie, en liaison étroite avec les conditions économiques et sociales. Le phénomène important et assez répandu de la reconstruction, de la typologie ancienne, qu'on trouvait convenable, principalement pour des raisons économiques, rendait naturel, à côté d'elle, le commencement des recherches pour la réalisation d'un type nouveau. A ce dernier, ayant dans l'essence de son caractère la satisfaction des exigences vitales des couches d'artisans et de commerçants, qui avaient déjà réussi à créer le marché intérieur national, était réservé une vaste étendue, différemment à la typologie traditionnelle variée et l'on peut dire, à traits locaux accentués.

La naissance du type nouveau trouva le terrain le plus approprié, dans la ville de Korçë. Les premières réalisations concrètes ont commencé notamment vers le milieu du XIXe siècle. La ville de Korçë, centre relativement sans importance jusqu'au XVIIe siècle, plus tard, et surtout après la destruction de Voskopojë, connaît un essor impétueux et se transforme en un centre proprement artisanal et commercial. Disposant, tout au tour, d'une vaste zone bien peuplée, qui s'occupait d'agriculture et d'élevage, liée, par des routes de caravanes, à l'Albanie Centrale, à la Macédoine et à l'Epire, Korçë cristalise de façon relativement rapide le caractère d'un centre de production et d'échange, et réussit à devenir, durant le XIXe siècle, une ville importante de l'Albanie du Sud.

La voie de reconstruction des habitations anciennes ne trouvait pas de terrain dans ce centre, soit à cause des résultats modestes des habitations traditionnelles, soit en raison de la croissance impétueuse des couches d'artisans et de commerçants, qui ne pouvaient se contenter de solutions médiocres, et exigeaient à matérialiser, au plus vite, leur position et le caractère de la classe qu'ils représentaient, dans l'habitation.

Donc, la ville de Korçë remplissait toutes les conditions pour avoir la priorité dans la naissance et l'évolution du type nouveau, qui, dans tout son caractère et son traitement, remplissait toutes les conditions, pour se qualifier d'habitation proprement urbaine, liée au bas stade de développement des rapports capitalistes.

Tout comme la société féodale, la nouvelle formation de la société bourgeoise dans notre pays, qui conserverait encore pour longtemps des restes de la société féodale, se distingue par une différenciation accentuée de classe entre les couches de la société des villes, qui allait devenant plus accentuée. Justement ce fait doit être considéré comme le facteur essentiel de cette morphologie riche de l'habitation albanaise de Korçë, qui englobe un nombre relativement élevé de variantes et de sous-variantes. L'habitation de Korçë se fait valoir par ses schémas de composition bien constitués et rationnels, où l'attention est attirée par le salon central et les volumes habitables à ses côtés. Les différentes variantes, en conservant cette conception, s'accroissent quantitativement, aussi bien à l'intérieur du même étage, qu'en passant de l'habitation à un étage à celle de deux, en excluant l'étage de la cave, qui en tant que caractéristique locale de Korçë, connaît un développement partiel ou complet, comme les étages habités. L'escalier de l'étage, supérieur, est construit, d'habitude, au fond du salon. Dans le salon de l'étage supérieur, en guise d'encorbellement fermé, s'élargit, au-delà du front, un volume en forme de bow-window ou supporté par deux ou quatre piliers. Cet élément, assez répandu à Korçë, met assez en relief la vue principale, en donnant un mouvement accentué aux volumes de construction.

La nouvelle habitation ne doit pas être considérée comme un phénomène tout à fait détaché des anciennes traditions, mais comme sa négation dialectique.

On trouve des conceptions, et même de composition de type anciens, dans la nouvelle habitation aussi. En demuerant dans le cadre de la création populaire, elle hérita des traits positifs, qui la caractérisent, dans des réalisations conformes aux nouvelles conditions de vie.

Le début du XXe siècle enregistre une propagation assez large du type nouveau dans toutes les villes de notre pays. Naturellement, dans les centres où le développement eut un essor naturel, il ne pouvait devenir dominant; au contraire, dans les centres qui connurent un développement rapide, comme Tirana, le type nouveau trouva un terrain très convenable.

La naissance et le développement des rapports capitalistes dans notre pays, à part les reflets dans la typologie et le caractère de l'habitation urbaine, s'expriment aussi dans l'urbanisme de cette période-là. Mais il faut souligner que, tandis

que les changements de l'habitation sont rapides et d'une étendue relativement vaste, les nouvautés dans l'urbanisme viennent de façon limitée, donc connaissent une petite étendue et même unique, notamment dans la ville de Korçë.

Sans nier les réalisations réussies, particulièrement dans les villes ou quartiers, sur terrain en pente, l'urbanisme moyenâgeux présentait des insuffisances évidentes, qui étaient liées à cette phase de développement de la société albanaise, conditionnée des limitations du système féodal. Le début de la naissance des rapports capitalistes eut des reflets retardés, ou bien plus exactement assez limités dans l'urbanisme, parce que, dans assez de villes, les anciens schémas urbains étaient consolidés, depuis longtemps, tandis que les nouvelles constructions ne constituaient pas un volume trop grand. Une certaine inertie, dans ce sens, vue la nature contradictoire et arriérée même de la société de ce temps-là, fait que, même aux cas de constructions nombreuses comme à Shkodër, l'ancienne tradition se continue.

Dans le domaine de l'urbanisme, tout comme dans l'habitation, c'est justement à Korçë qu'on rencontre, pour la première fois, dans notre pays, l'exécution de la planification, dans la construction des quartiers habités. Ce phénomène apparaît en une période relativement ancienne, même pour les Balkans, dont les débuts datent du milieu du XIXe siècle environ.

Dans les quartiers nouveaux de la ville de Korçë, ces conceptions s'expriment dans des réalisations avancées pour l'époque. A la base de l'urbanisme se trouve le système du réseau quadratique, qui est formé de parcelles de construction, résultant de l'intérruption d'un système de rues. Aux bords des rues, ou plus loin d'elles, on construit les habitations, l'une à côté de l'autre, avec de petites cours. Les rues, couvertes de pavés, ont des trottoirs et, près d'eux, de petits escarpements pour le déchargement des eaux des précipitations atmosphériques. Cette conception constituait une nouveauté, avec des changements essentiels par rapport à l'urbanisme traditionnel. Cette conception d'urbanisme commence à être mise en pratique même dans le centre artisanal et commercial de la ville, au Bazar, en même temps que dans la nouvelle zone habitée.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Fatbardha SHKUPI

TIPARI POPULLOR I ZBUKURIMORES SË BANESËS SHKODRANE

DO NOT COPY

Që nga Shkodra deri në Gjirokastër trualli i zbukurimores (ornamentikës) shfaqet i bashkësuar në një tip të vetëm kombëtar, por brenda së tërës dallohen sipas krahinave tipare si dhe veçori të mjeshtrave që shprehen te secili sipas aftësisë e mënyrës vehtiake. Kjo veprimtari nuk u zhvillua e shkëputur nga rrymat e artit botëror veçanërisht të vendeve të ndryshme fqinje ballkanike.

Pavarësisht prej këtyre rrymave çdo ksomlë (ekzemplar) me vlerë e zbukurimit në vendin tonë është e pa përsëritshme, e kryer në shkallë të lartë artistiko-mjeshtërore, në një krijimtari të singertë e vetëvetishme e të pa huajtur, e cila diti të ndërthurte brenda larmisë së llojeve të gjitha motivet popullore të trashëguara brez pas brezi.

Në krahinën e Gollobordës, të cilin e mbikqyrëm tërësisht, u njohëm me veprimtarinë e mjeshtrave të shquar që nga shekulli i XVIII deri në ditët tona. Sipas dëshmive të banorëve dhe vrojtimeve tona, veprat e këtyre mjeshtërve i gjetëm në të gjitha qytetet. Prej këtyre qyteteve u përqëndruam në Shkodër ku na tërhoqi pasuria e rrallë e zbukurimores së brendive. Shkodra si qytet i lashtë ka qënë gjithmonë qendër e një zhvillimi ndërtimor e artistik të shquar që nga koha e bashkësive të mjeshtërive në mesjetë, përkatësisht në shekujt XIII-XV[1]. Veprat e artit kudo gjatë bregdetit në këto kohra i kryenin «punishtet e fushës« të cilat përfshinin: Tivarin, Durrësin, Beratin e Janinën.[2] Pas pushtimit otoman shumica e artistëve u strehua në Dalmaci, Itali e Francë ndërsa pjesa tjetër u tërhoq në Stamboll nga pushtuesi për ndërtimet e mëdha të njohura.[3] Megjithatë një bërthamë artistësh mbeti e strukur ndërmalet e Tërnovës, Okshtunit, Leiçanit e Zabzunit në veri, në shkrepat e Oparit, Kolonjës, Mokrës, Lunxherisë e Konicës në jug, si përfaqësuese e punishteve të malit.[4]

Pas një kohe Shkodra filloi të rimëkëmbej me kamje. Një grup familjesh feudale e tregëtare gjatë shekullit XVIII nisi të lidhte marrëdhënie me qendra të fuqishme si Raguza, Venediku, Sicilia e Marsilia, të ndihmuara nga vetë pashallarët me të cilët ata përpjestonin fitimet.[5] Kjo shtresë pasanikësh kishte kërkesat e veta për një jetë më sqimtare prandaj lindi nevoja e zbukurimit të banesave të vjetra në brendi. Për këtë qëllim feudo-borgjezia shkodrane thirri në ndihmë mjeshtrat e «punishteve të malit» të cilët filluan t'i ndërtojnë asaj dhomat e mira të paisura me trapazane e nime (mindere) shoqet e të cilave i hasim pothuaj në të gjitha shtëpitë e Kosovës, të Ma-

1. Z. Shkodra, **Esnafët në jetën qytetare ballkanike të shekujve XVII-XVIII** në «Studime Historike», Nr. 1, Tiranë, 1975, f. 160-162; F. Shkupi, **Dekoracioni i arkitekturës popullore në qytetin e Shkodrës,** në «Monumentet» 12, Tiranë, 1976, 195-219.
2. R. Sokoli, **Miho Tivarasi,** në «Shqipëria e Re», 1969, f. 28.
   E. Çelebi, **Sejjahatnamesi,** Istambul 1314.
   L. Mile, **Sur le caractére du pouvoir d'Ali Pacha de Tépéléne,** në **«Edition du comitê National Albanais des études balcaniques»,** Tirana, 1969, f. 9.
3. Z. Shkodra, **Kontribut për historinë e diasporës shqiptare, kundrime shoqërore ekonomike,** në «Studime Historike», Nr. 3, Tiranë 1971.
4. **Kopje defterit emëror të vilajetit të Dibrës 1467.** (Përkthim në ark. e I.H. Tiranë).
5. Z. Shkodra, **Esnafët shqiptarë,** Tiranë, 1972, f. 297-304. S. Naçi, **Pashallëku i Shkodrës nën sundimin e Bushatllinjve,** Tiranë, 1964.

qedonisë, Greqisë Veriore dhe vendeve të tjera të së quajturës Turqi Evropiane, ku gjendeshin shtresa shoqërore të ngjashme, me kushte të njëjta kamjeje.[6] Brendi të bukura të kësaj kohe kemi gjetur në të gjitha lagjet e qytetit sidomos në banesat e rrugëve Alqi Kondi, Ali Kelmendi, Musa Luli e Vasil Shanto dhe në lagjen Perlat Rexhepi, në muzeun qendror, në muzeun e Luigj Gurakuqit, dhe në Shtëpinë e Pionierit.

Sigurisht shtresat e varfëra nuk ishin në gjendje të përballonin shpenzime të tilla për paisjen e banesave, prandaj dhe veprimtaria artistike e zbukurimit të ndërtesës, u përqëndrua në një sferë të ngushtë ku hynte shtresa e kamur. Sipas të dhënave qyteti i sotëm nisi të rizgjerohej në shekullin e XVII; banesat e tij në fillim u ndërtuan të thjeshta, ndërsa më vonë u pasuruan me tavane, rafte, shtresa mbajtëse (musandra) e tymtarë (oxhakë) të plazmuar sipas krijimeve vehtiake të veçanta të cilat i dhanë qytetit larmi të re.[7]

Zbukurimet e para të ushtruara në banesën popullore gjatë shekullit XVIII qenë disa rozeta yllore, të njohura në artin e Mesdheut dhe disa rafte e arka të daltuara fort cekët me përfytyrime të shtangëta palmash, tufëzash e shenjash si ylli me gjashtë cepa, selvitë e kafshët e kundërvëna. Raftet e mureve ngjanin me arkat e detit të quajtura në Dalmaci «tip Adriatik» për shkak të artizanëve shqiptarë e dalmatë që i daltonin ato gjatë bregdetit të Adriatikut lindor dhe në Venedik. Fryma e përpunimit të tyre dhe ashpërsia e daltës që gdhendi ato selvi dhe vazo me lule, me motive të botës bizante-islamike, s'kishin asgjë të përbashkët me arkat e dasmës të rilindjes Veneto-fiorentine (casse di nozze) të prodhuara në Itali gjatë shekujve XVI-XIX, me hijeshinë por dhe njëllojshmërinë e daltës europiane.[8]

Fundi i shekullit XVIII e fillimi i shekullit XIX përputhen me kohën e prishjes së bashkësive të mjeshtrive në Europë dhe reformat e Tanzimatit në Turqi, të cilat shkatërruan bashkësitë e Stambollit e të Selanikut.[9]



Fig. 1

Rrjedhimisht një shumicë artizanësh u përfshi në rreshtat e të papunëve. Mes tyre kishte shqiptarë, vllehë, maqedonë, grekë, bullgarë, të cilët filluan të ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre. Kjo periudhë sipas nesh është koha e zhvillimit më të madh të artit të zbukurimit shqiptar.

Kthimi i mjeshtrave piktorë e skulptorë vendas të përmendur, solli si pasojë lindjen e grupeve të reja të punës mjeshtërore dhe rradhët e tyre nisën të shtohen me gjak të freskët. Kjo lëvizje ndodhi në

6. H. Balducci, **Architettura turca in Rodi,** Milano-Pavia, 1932.
B. Kolev; I. Budinov, **Koprivshtica,** Sofia 1957.
U. W. Goknil, **Architettura Ottomana,** Milano, 1965.
D. Kostov, **Arbanasi,** Sofia, 1948.
7. E. Riza, **Banesa popullore në Shkodër gjatë shekujve XVIII-XIX,** në «Monumentet» 4, 1972, f. 142.
8. G. Bazin, **Histoire de l'art, Paris,** 1953, f. 193 (arkat fiorentine) M. Jevric – Izložba **umetnička skrinj u Jugosllavie ot. XIII do XIX stoleca,** në «Muzei Primenenie Umetnosti», Beograd 1960-61, 145-147. (Arkat tip Adriatik).
O.M. Dalton, **Byzantin art and archeology,** Oxford, 1911, f. 685-712. Simbolet, selvitë, dhe demonomahia – lufta kundër demonëve).
9. G. Marçais, **L'art musulman,** Paris, 1962.
Z. Shkodra, **Vep. cit,** 318-322.

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

Motivet trashëgimore: të zbatuara nga mjeshtrat, të cilat përfaqësojnë një pasuri të çmuar përfytyrimesh si ylli, rrathët, dielli, rrota, helika, kryqi grepç (svastika), hëna, shqiponja, gjarpëri, zogu, dyfishvizat e ndërprera, sharrëzat, gishtëzat, rombet, etj. si motive fillestare të ndërthurrura me qindra trajta të krijuara më vonë.

Paraqitjet e veçanta dalluese të cilat për secilin mjeshtër shihen;

Në Mënyrën e daltimit të zbukurimit bimor si trandafilat, shermashekët, zambakët, lule delet, lulja e diellit e lloje lulesh të kopështit si trandafili i egër, gjeorgjina, lule bora, (eglantina, manjolia, hortencia), fijet e lisit, gjethet e dafinës, bisqet, tufëzat, gjethet e blinit, anaket, ku dallohet dora e mjeshtrit.

2. Në mënyrën e vizatimit të zbukurimit gjeometrik si rrathë, rombe, katrorë, valëzime, dhëmbëzime, palëza, meandra, margaritarë.

3. Në mënyrën e zbatimit të pjesëve të zbukuruara mbi dyer, flegra dritaresh, rozeta tavanesh, trapazane e shtresambajtëse.

4. Në bashkëtrajtimin e veprave me tipare vehtiake, i cili kuptohet në ndërthurjen e tavaneve, trapazanëve e tymtarëve, ku motivet trashëgimore, paraqitjet e veçanta bimore e gjeometrike dhe pjesët e mbërthyera pasqyrojnë një tërësi të unjisuar, dalluese për sejcilin mjeshtër në një mjedis. Duke i krahasuar me kthinat pasuese të punuara prej së njëjtës dorë ndihet lidhja në mes pjesëve të kryera në banesa të tjera si zhvillime të së njëjtës përbërje nëpër mjedise të ndryshme.

5. Në bashkëhijeshinë e përgjithshme të brendisë që përfshin veç pjesëve zbukuruese të gjitha sendet përbërëse ndërtimore: punimi i dyerve, dritareve, tavanit, shtrojes, nimëve, tavlave (sergjenëve), trapazanit e shtresambajtësve, tymtarit, kamareve ku kemi mundur të vërenim tipare si veçuese ashtu dhe përgjithësuese me qytetet e tjera të Adheut.

6. Në mënyrën e daltimit të mjeshtrave dibranë e cila krijonte dregza mbi sipërfaqen e drurit, që i jepnin zbukurimit fuqi dhe përshtypjen e një skulpture të arritur me goditjet e para, ndryshe nga zbukurimorja europiane e drugdhendjes e cila i rrafshonte dregzat me limë druri e kartë brerëse. Në disa raste zbukurimi sajonte plotime të larta (reliefe), të rrumbullakta me kthesa të forta, si i kemi parë në tavanet e punuara nga mjeshtër Dana. Në raste të tjera daltimet stërholloheshin me vijëza të mprehta, si në brenditë e mjeshtër Isufit dhe merrnin trajtë të theksuar gërryese në vepra e mjeshtër Saliut, por zbukurimorja shkodrane në tërësi skalitej cekët, për të shlyer ndërgështetimin e rënduar të mjediseve artistike.[16]

7. Në teknikën e punimit që gjatë shekullit XIX kryhej me dalta shpatull gjëra dhe të imta. Në brenditë haseshin rrallë tejshpime (traforime) të cilat zbatoheshin më tepër në ikonabartësit e Jugut.

Veglat e punës që gjetëm në familjet e pasardhësve të mjeshtrave, si atë të mjeshtrit Tërnovas Ha-

16. F. Shkupi – **Vep. cit.** f. 198-205.

DO NOT COPY

një kohë kur pashallëku i Shkodrës kishte fituar një farë pavarësie nga porta e lartë.[10] Kështu që pjesa më e madhe e fuqisë punëtore të çliruar nga Stambolli erdhi në Shkodër. Veprat e para të shekullit XVIII u kryen në trajta gjeometrike të shtangëta, me tulipanë e zambakë, pas të cilëve filluan krijimet e përsosura lulëzore që mbushën mbarë shekullin e XIX me larminë e tyre zbukurimore. Në këtë qytet gjetëm rrotull dyqind brendi me daltime të shkallës së parë e të dytë dhe njëzetenëndë tymtarë të mbetur pa prishur që i përkasin kohës nga fillimi i shekullit XIX deri në fillim të shekullit XX. Shembujt më të bukur (fig. 1) mund të krahasohen si ngritje artistiko-mjeshtërore me veprat më të njohura të botës islamike[11], kurse shembujt më pak të përkryer i afrohen daltimeve të brendive të Manastirit të Rilës. Brenditë me vlera mesatare si ato të Trevnës e Koprivshticës janë fare të pakta. Kjo gjendje pohon vlerat e vërteta të mjeshtrave shqiptarë.[12] Zbukurimorja e qytetit të Shkodrës, vepër arti burimisht shqiptare, shfaqet me dukuri të afërta dhe në Tiranë, Krujë, Elbasan, Berat, Korçë e Gjirokastër.

Mjeshtrat gdhendës Dibranë të brendive në të gjitha këto qytete janë stërvitur në vend duke bashkëpunuar me mjeshtrat e shquar të punishteve të Oparit, Janinës e Lunxhërisë që krijuan ikonostasët, madhështorë, përsosmëria e të cilëve nga pikëpamja teknike e shkathtësia artistike dëshmon për doket e lavdishme që trashëguam në këtë fushë. Mjeshtrit u shfrytëzuan vazhdimisht nga sipërmarrësit, të cilët përvetësonin shuma të mëdha në kurriz të tyre duke i paguar vetëm me dy deri me tre grosh në ditë.

Zbukuruesit dibranë e oparakë e vazhduan mjeshtërinë e tyre deri në prag të pavarësisë. Pas kësaj kohe në Shkodër filluan të ndërtoheshin shtëpitë e vogla me pamje të zbukuruar me plotime të çimentuara (reliefe).

Shumë studiues që u morën me çështjen e zbukurimores turko-ballkanase si N. Mucopolos, V. Han, S. Tomoski, K. Mijatiev, Mavrodinov, T. P. Vukanoviç, U. Fogt Göknil, H. Balduci, H. Turhan, E. Esin, G. Palikrusheva, etj. kanë shprehur mendime nga më të ndryshmet lidhur me artin e zbukurimit, mje-



Fig. 2

shtrat si dhe stilet e ndikimet, por asnjeri prej tyre deri sot nuk e vështroi këtë art ndërballkanas si një njësi më vehte me shkollat e veta shqiptare, maqedone, greke, rumune e bullgare me tipare dalluese krahinore. Asnjeri nga studiuesit e mësipërm nuk ka dashur të përmendë ndihmën e madhe të popullit shqiptar të përfaqësuar nga punishtet e Dibrës, Oparit e Lunxherisë, të cilat sipas të dhënave arkivore kanë krijuar vepra të shkëlqyera në trojet e Ballkanit e të Turqisë, duke arritur nga Gjermania e deri në Aleksandri e Iran.[13]

Është shkruar gjithashtu për shkollën e Mijakut pa theksuar lidhjen thelbësore me Gollobordën fqinje me të cilën e ndan një lum i vetëm si kufi politik ashtu dhe me Çermenikën, Mokrën e Oparin që ndodhen disa kilometra më tutje duke nxjerrë përfundime të padrejta nga pikëpamja historike.[14] Është injoruar shtegëtimi i matjanëve drugdhendës e gurskalitës në Gollobordë e Rekë gjatë shekullit XVIII. Si pasojë e shtegtimit mjeshtrat matjanë që zakonisht daltonin orendi filluan të kryenin punën e ndërtuesve duke i përshtatur brendive të banesave artin e zbukurimit.[15]

Vetvetishmëria e rrymës popullore vihet në dukje me anë të disa shenjave dalluese kryesore siç janë:

10. **Historia e Shqipërisë,** Tiranë, 1965, vol. I, f. 435.
11. F. Shkupi, **Vep. cit.,** f. 198-200.
H. T. Daglioglu, **Les plafonds des vieilles maisons de l'Ankara** në «la Turquie Kemaliste», Ankara, août, 1938, 2-4.
12. K. Mijatiev, **Rilskij Monastir,** Sofija, 1957.
B. Kolev–I. Budinov, **Vep. Cit.**
13. Z. Shkodra – **Vep. cit.,** Të dhëna gojore nga familjarët e mjeshtrave dibranë e matjanë.
14. S. Tomoski – **Makedonaska narodna arkitektura,** Skopje 1960.
15. Të dhëna gojore nga Burgajeti i Matit.

DO NOT COPY



Fig. 5



Fig. 6

së Burgu, përbëheshin nga sharra, mengeneja (morseta), sverdelli (trapani), zdrugqenishi, sqepari, sharrë-korniza, lima, zdrugu i planjët, gjonia, peshorja e ujit (terezia) dhe sharra rrethore. (Fig. 2).

8. Në lëndën e drurit e cila përbëhej kryesisht nga pisha sepse rrethi i Shkodrës ishte i pasur me pyje pishash; në ndonjë rast përdorej bushi me arrën, por pisha me zhdërvjelltësinë e saj u krijonte mundësi për një daltim të shkathët, të rrafshët e të cekët sipas kërkesës dhe kushteve.

9. Në shkëlqimdhënien (vernikun) me lëndë natyrore që kryhej mbi zbukurimet e drunjta duke i lyer pas larjes së sipërfaqeve me ujë finje, me një masë të lëngëshme e cila përgatitej me rrëshirë të shkrirë në vajguri e të përzier me vaj ulliri. 1 masë rrëshirë të kokrizuar (rëshirë pishe ose dyll blete), 5 masa vajguri, 2 masa vaj ulliri.

Për shkëlqime metalike të bardha: 3 masa rrëshire, 1/2 lëng zhive të përziera. Kurse varaku i verdhë blihej i gatshëm.

Për shkëlqime allçije (Stuko relief): 1 masë të bardhë veze, 3 masa ujë gëlqereje.

Tymtarët, Tek të cilët zbatohej plazmimi me lëndë të bardhë, ndërtoheshin prej dërrase ose tulle të lidhur nga brenda me thurrje të hekurta në trajtë gjysmë rrethi, kurse në tavanet e kësaj natyre thurrjet e hekurta vendoseshin si peta të shtrira. Mbi këtë plang ushtrohej plazmimi i bardhë për të cilin shërbente si lëndë allçija dhe shkumsi të tretur në një përzierje me lëng gëlqereje e qumështi të gatuar me lesh dhie. Zbatimi i zbukurimit në pjesët e rrafshëta kryhej me anë të shumëfishoreve (kallëpe) kurse drethkat e plota me zbatim të drejtë për drejtë. Kështu lindën tymtarët e përkryer të shekujve XVIII-XIX dhe tavanet e bardha të derdhura në allçi.

Banesa qytetare shkodrane u ruajt si shëmbyll fillestar, po për arësye të fuqizimit ekonomik të borgjezisë filloi pasurimi i saj me zbukurime në brendi; ashtu si ndodhi gjatë ndërtimtarisë së vendeve fqinje ku jetonin shtresa shoqërore me kushte të njëllojta ekonomike.

Zbukurimorja e re e shekullit XIX në dhomat e mira, u zbatua mbi tavane trapazane, tymtarë, rafte muresh e piktura në të thatë (a seco).

Motivi yll

Duke filluarme motivet trashëgimtare po përmendim banesën Nr. 15 të rrugës Musa Luli të ndërtuar gjatë shekullit XVIII dhe të zbukuruar në fillim të shekullit XIX nga mjeshtri Jashar Xhafa. Në këtë banesë gjenden dy tavane në trajtë ylli prej të cilëve po përshkruajmë atë me përkulje të gungët (me kazan) (fig. 3). Të tetë cepat e yllit të ndërthurrur me copëza, krahaskëmbehen me tetë trekëndësha ndërsa në mes ndryjnë një rozetë me rathë bashkëqendrorë të daltuar me zbukurime gjethesh lisi e lule zhabine të renditura në dredhëse të vazhduara. Të katër trekë-

DO NOT COPY



Fig. 7

ndëshat anësorë me mbështetëse harkore janë daltuar me tufëza. Rreth gungës rrëshqet një lajle e pikturuar me lulëzime e lulembajtëse me karafila. Rozeta përshkohet prej tri rathësh bashkëqendrorë nga mezi i të cilëve shkëputet një lulonjë e qarkuar me kinda, rreth së cilës rrëshqet drethka e lulëzuar e shoqëruar me kufizë pikëzash, margaritarësh e shkoptha, ku renditen lulet e pranëvëna.

Sipërfaqja brenda cepave të yllit është e zbukuruar me përjashtim të trekëndëshave ndërmjetës të rrethuar me dhëmbëza. Te ky rikrijim i yllit si motiv, i pasuruar me zbukurime në tetë cepat e brendashkruar në rreth, mjeshtri ngriti në art shenjën e thjeshtë popullore duke i mveshur trajta të larmishme ku ndihet përvoja e gjatë si dhe njohja e artit europian,[17] sepse ai bënte pjesë në grupin e mjeshtrave rekas që daltonin ikonostaset si Pjetër Filipi nga Gajra bashkë me Osman Sallakun, Hasan Tetën e Sulejman Boriçin. Tavani i dytë i banesës, gjithashtu yllor, ka ngjashmëri të plotë me mënyrën e daltimit të mjeshtrit Osman Sallaku në disa brendi të Krujës e Tiranës, si dhe me tavanet e gdhendura të Hasan Tetës në Elbasan e Berat.[18]

Trashëgiminë e tavaneve yllore me tetë cepa e vazhdoi në Shkodër grupi i dytë i mjeshtrave të daltës të cilët bënin pjesë në punishten e Jashar Xhafës. Ata punuan gjatë mezit të shekullit XIX. Në muzeun etnografik të qytetit, me çardak të mbyllur, gjendet njera nga brenditë më të bukura të daltuara prej mjeshtrit Isuf Haxhiu ku dallohen trapazani i dhëmbëzuar dhe tavani yllor me tetë cepa. (fig. 4). Fusha e tij përshkohet nga rripa të rrezatuar mbi të cilët janë mbërthyer tetë trekëndësha të ndërthurur me degëzime fijesh lisi që paraqesin helika tufëza e dredhëse. Në qendër gjendet rozeta tetëkëndore e rrethuar me kufizë që paraqet një yll të dytë më të vogël. Të katër këndet janë daltuar gjithashtu me drethka.

Në banesën Nr. 52/3 të rrugës «Lidhja e Prizrenit», e cila u rindërtua nga fundi i shekullit XIX, mjeshtri Mahmut Metani i cili i përkiste grupit të tretë të mjeshtrave daltoi njërin nga tavanet me paraqitje yllore (fig. 5). Mbi yllin prej tetë cepash janë zbukuruar vetëm tetë trekëndëshat barabrinjës të fushës, të katër këndet dhe rozeta rrethore e brendashkruar në tetëkëndor e cila përshkohet me tu-



Fig. 8



Fig. 9

17. Për artin Europian shih A. André – **Histoire de l'art. Etudes des styles du mobilier,** Paris, 1970, f. 94-97.
18. Të dhëna gojore nga rrethi i Dibrës dhe Elbasanit.

DO NOT COPY

fëza gjethesh të lakuara si rrathë të pranëvënë, kurse pjesët e tjera me poçe lulesh e tufëza dredhëse.

Motivi yll shihet në vathët dhe unazat e grave arbëre të varrezës së Dalmacës (fig. 6)[19] që i përkisnin shekujve VI-VIII të erës sonë të punuar në argjend si dhe në Bukël të Mirditës[20], ndërsa në një rrasë guri të skalitur të shekullit XII nga kalaja e Drishtit duket një yll me tetë cepa (fig. 7). Këtë motiv e shohim të daltohet si yll me 15 majucë të brendashkruar në rreth te një gur varri nga Trebishti i Gollobordës, ku në mes të figurës vizatohet një rreth i dytë me pesë pika që lëshon 15 rreze në drejtim të majucave (fig. 8)[21]

Mbi arkat e nuseve të Dibrës ndeshet i trajtuar me 16 cepa, 8 nga të cilët janë si kreshta, 8 me kulli në trajtë kristalesh diamanti si në një arkë nga Ostreni i Vogël, e shekullit XIX (fig. 9). Lloji i trajtimit të motivit na kujton tavanin e muzeut etnografik dhe të disa banesave në Shkup, Elbasan e Berat. Në të kundërt disa nga studiuesit e huaj nuk përmendin se në shumicën e rasteve këto motive



Fig. 11

janë zbatuar prej mjeshtrave shqiptarë: dibranë, kosturiotë, oparakë, lunxhas e koniciotë, në Stamboll, Brusë, Selanik, Dramë, Kavallë e Serez.[22].



Fig. 10



Fig. 12

19. H. Spahiu, **Gjetje të vjetra nga varreza mesjetare e kalasë së Dalmacës,** në «Iliria» I, Tiranë, 1971, 262, Tab. V, fig. 10.
20. S. Anamali — **Një varrezë e mesjetës së hershme në Bukël të Mirditës** në «Iliria» I, 225, Tab. VII, fig. 1.
21. Sipas R. Vulkanesku — **(Les signes juridiques dans la région carpato-balcanique,** në «Revue des études Sud-Est Européennes», II, 1964, f. 17. Ai përfaqësonte gjurmën e bashkësisë fisnore të grupit të punës për kujtim të besimeve bujqësore që adhuronin diellin.
22. S. Tomoski, **Vep. cit.,** Tavan yllor i një banese shkupiane. f. 53. fig. 37b. G. Bazin — **Vep. cit,** 15 (për motivin yll). Për mjeshtrat shqiptarë që punuan në Turqi shih J. G. Hahn — **Albanesische studien,** Jena, 1854, f. 146-162, ndërsa për ndërtimet e tymtarëve të njëjtë me ato të Elbasanit në Arbanas, Stamboll, Janinë, Dramë, Serez, shih F. Nopcsa — **Bauten, Trachten und Geräte Nord Albaniens,** Berlin-Leipzig, 1925, f. 68-69, 89.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 13



Fig. 15



Fig. 16



Fig. 14



Fig. 17

Shenjesa e yllit sipër brerores së rrezatuar ka qënë emblemë e Konstandinit të madh që rridhte nga një familje prijsash paionë të Ilirisë së Veriut dhe e quante vehten «të ardhur nga një dinasti diellore».[23]

23. M. Guarducci, **s. v. Sole,** në «Enciclopedia italiana Treccani». XXXII Roma 1936; 53-54.

DO NOT COPY

Motivi i rrathëve bashkëqendrorë

Rozetat e tavaneve të Shkodrës riprodhojnë rrathë bashkëqendrorë të shoqëruar me drethka lajle e tufëza të cilat krijonin helika të emërtuara nga mjeshtrat «lule përdredhëse» të lidhura me kordele, trëndafila e zambakë.

Në banesën Nr. 4 të rrugës «Musa Luli» tavani i daltuar nga Jashar Xhafa ruan një rozetë të përbërë prej tri rrathësh të tilla të shoqëruara me lulëzime. Në rrethin e skajmë shihen gjethe (tetë) si rreze pranë tufave me lule. Në atë të mezit shihet një kufizë bedenash rrotull bisqeve të lidhura fjongo, ndërsa në qendër me drethka të përthyera (fig. 10). Tavani i mësipërm që ishte më i vjetri i llojit të vet në Shkodër, u mbulua më vonë me piktura nga mjeshtri shkodran Gaspër Piktori.

Në një banesë të shekullit XVIII, e cila pësoi ndryshime nga mezi i shekullit XIX, mjeshtri Isuf Haxhiu, Cufa, daltoi një tavan me rozetë rrethore të zbukuruar në tufëza të rrethuara me buzina gjethesh si freskore. Gjatë kufizës ai zhvilloi drethkën meandrike që rrethonte tufa gjethesh të mbërthyera mbi fushën e përshkuar me listela rombe, kjo banesë gjendet në rrugën «Halit Bajraktari» Nr. 19. (fig. 11). Nga mbarimi i shekullit XIX pas largimit të usta Cufës, drejtimin e grupit të punës e mori Ramë Selim Mitku i cili ndërtoi disa banesa me rëndësi në krahun e Çinarit gjatë rrugëve «Ali Kelmendi» dhe «Nexhip Luli». Në njerën nga këto banesa (banesa No 24) mjeshtri krijoi dy brendi të hijshme me tavane e trapazane të gdhendura me gjethe lisi majuce. Ai skaliti një trajtë të re rozete me tri rrathë, bashkëqëndrorë. Tek e para renditi tufëza gjethesh me harpa e dredhëse, tek e dyta vendosi tufëzat freskore, ndërsa në të tretin ushtroi helikën shumë fletëshe (fig. 12).

Motivi i rrathëve bashkëqendrorë njihej nga ilirët që në lashtësi. Në qytetin e Durrësit mbi një buzëm varri të shekullit II-III të skalitur në gur arenar, në faqen e majtë, shihet një patere me rrathë bashkëqendrorë (fig. 13). Motive të njëjta hasim në varrezat e shekullit XIX të krahinës së Dibrës si në Ostren të Madh ku zakonisht rrathët dyfish vizohen me gërryerje mbi gur. (fig. 14). Këto rrathë duken dhe mbi ballin e tymtarëve të gurtë të shekullit XX të këtij fshati. (fig. 15).

Në djepat e Matit, po të shekullit XX rrathët shfaqen të gërryera me gishtëza mbi faqet anësore brenda fushave katrore të shoqëruar me katër pikëza në këndet, (fig. 16) që paraqesin diellin dhe katër shpërfytyrimet e hënës. Në qytetin e Peshkopisë, ruhet një nga brenditë më tërheqëse të krahinës, që sipas stilit të daltimit i përket grupit të



Fig. 18



Fig. 19

mjeshtrit të shquar rekas Pjetër Filipit i cili gjatë fillimit të shekullit XIX kreu disa vepra zbukuruese në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni. Ajo paraqet tri rrathë bashkëqendrorë, në të parin janë ushtruar thurrjet e kapërthyera, në të dytin drethka të dyfishta me gjethe lisi cerr të valëzuar e lule sahati dhe në të tretin një luleqerthull me tufëza si rreze. Të trija këto trajta janë të mirënjohura në veprat e tij. (fig. 17).

Në tërësi rozetat me rrathë bashkëqëndrorë vendosen mbi fusha të përshkruara me rreze dielli. Nga

DO NOT COPY

mezi dhe fundi i shekullit të XIX ato marrin trajta të stërholluara ku daltimet rrëshqasin të qarta me vizatim të përcaktuar. Motivet e mësipërme të njohura dhe në vende të tjera[24] në i gjejmë nëpër banesat e Elbasanit, të Krujës, Tetovës e Dibrës së Madhe.[25]

Motivi me diell

Tavane me paraqitje diellore tetëkëndore ose rrethore filluan të zbatoheshin nga mezi i shekullit XIX në dhomat e mira të Shkodrës. Në banesën Nr. 26 të rrugës «Skënderbej», të ndërtuar nga fundi i shekullit XVIII, mjeshtri Jashar Xhafa me grupin e tij ngriti në katin e dytë përballë çardakut dhomën plota na jep me bardhësinë e saj përshtypjen e diellit me rreze të mbështetura mbi rrethin e drunjtë që kufizonte gungën. (fig. 18).

Mjeshtri Ramadan Dibra e vazhdoi më tutje këtë mënyrë punimi. Gjatë shekullit XIX ai kreu disa tavane të bukura në trajtë rrezesh. Mbi njerin prej tyre, të vendosur në paradhomën e katit të dytë të banesës 52/3 të rrugës «Lidhja e Prizrenit», mjeshtri trajtoi një fushë tetëkëndore të cilën e vizoi me 40 listela si rreze, në mes vendosi një rozetë rrethore të daltuar me bisqe dredhëse të fuqishme të kufizuar me kordon mbi një mbështetëse tetëkëndore të ndarë me sharrëza. (fig. 19).

Nga fundi i shekullit XIX grupi i tretë i mjeshtrave të daltës krijoi një numër tavanesh me rreze të valëzuar, të kufizuara me rrypa gishtëzash e laj-



Fig. 20



Fig. 21

e miqve me tavan të gungët në mes e tymtar të plazmuar me zbukurime. Brenda kubesë vendosi rozetën e lulëzuar, kurse fushën katrore të tavanit ai e përshkoi me 50 listela të drunjta si rreze. Në këtë mënyrë pjesa rrethore e gungët e mveshur me suva dhe e zbukuruar me drethka e tufëza gjethesh rrethlesh, si në banesën Nr. 17 të rrugës «Naim Gjylbegu» të punuar nga mjeshtri shkodran Isa Bushati dhe në banesën Nr. 109 të rrugës «Ali Kelmendi» të punuar nga mjeshtri Sylejman Metani.

Po përmendim njerin nga më të bukurit e kësaj ndërkohe, i cili ndodhet në banesën Nr. 55/2 të

24. H. T. Daglioglu – **Vep. cit.**
E. Esin – **An eigtenth centuryjale viewedd in the line developement forms, in turkic architecture** në «Atti del II: Congr. intern. di arte turca», Venezia, 26-29 Sept 1963, Napoli, 1965, f. 105-110.
25. G. Palikrusheva, K. Tomoski, **Les tekkès en Macedoine aux XVIII/s** në «Atti del II Congr. Intern. di arte turca», f. 203-207.

DO NOT COPY



Fig. 23



Fig. 25



Fig. 22



Fig. 24

rrugës Kukaj. Aty mjeshtri Mahmut Metani zbatoi nga fundi i shekullit XIX motivin diellor ku trajta katrore përthyhet prej fushës rrethore me 37 rreze, ndërmjet të cilave janë pikturuar zbukurime lulesh dielli të shoqëruara me gjethe të rreshtuara si verore. Zemra e tavanit paraqet rozetën e daltuar me tri rrathë. I pari është thurrur me drethka meandrike, tek i dyti spikatin tetë tufëza të lakuara si rrathë të pranëvënë. Në qendër lëviz helika dhjetëfletëshe. Të katër këndet janë daltuar me degë të valëzuara. Pjesët e drunjta janë praruar, kurse fusha ruan ngjyrën e vesë së hapur me lule çiklamine e të blerta. (fig. 20). Mund të themi se tavani i mësipërm u mbajt si vepra më e bukur e usta Mahmutit. Në banesën Nr. 4 të rrugës «Ali Demi» mbi ballëzinat e trapazanit, dhe në tre banesa të rrugës Skënderbej, mbi dyer e rafte shihet dielli i vizatuar me valëzime rrezatuese.

Paraqitjen e diellit me rreze e shohim që në sendet e zbukurimit prej bronxi të varrezës së Buklit në Mirditë. Ndër të tjera një kapse e shekullit VII përmban rrethin e gjerë brenda të cilit rreshtohen 16 petale rreze të ngulitura në rreth të dytë ku vizatohet luledelja, ndërsa anash kufizohet me buzinë prej 19 bedenash[26]) (fig. 21).

Kjo shenjë dalluese u ruajt gjatë shekujve në djepa, orendi e gurë varresh si vulë e fisit që adhuronte kultin e diellit të përhapur tek ilirët. Buzme varresh mbi kryet e të cilëve qe skalitur dielli gjenden dhe në Gollobordë. Në rastin tonë te varri në Ostren të madh, i shekullit XIX, dielli paraqitej si rrotë guri me 16 rreze në mes të së cilës shiheshin dy rrathë bashkëqendrorë, dukuri e njëjtë me tavanin në Shkodër të rrezatuar me rozetë qendrore rrathësh të brendashkruar (fig. 22). Të tilla pamë në Steblevë, mbi një tavan dhe në Leiçan e Gjinevec, mbi dyer të mbërthyera me copëza si rreze.

Veç Gollobordës motivi diellor haset dhe në disa qytete e fshatra të tjerë i zbatuar mbi orendi ose qëndisje. Në Mat diellin e vizatojnë të qarkuar nga trekëndësha bashkëqendrorë dhe kufiza rrethore me gishtëza mbi faqet e djepeve, dhe në ditët tona.

26. S. Anamali – **Vep. cit.,** 225, Tab. VII, fig. 5.

DO NOT COPY



Fig. 26



Fig. 27

(fig. 23). Po kështu diellin e thurin me bizë vajzat e Dibrës, të Matit e Korçës (fig. 24).

Në një kullë të fshatit Ostren i Madh ndodhet një tavan i daltuar prej dorës së mjeshtrit Ramazan Tola në shekullin e XX. Është sajuar me rreze të ngulura mbi kufizën vezake të rozetës së rrethuar me bedena që mbyllin drethka me gjethe blini e katër lulime. (fig. 25).

Motivi i helikës

Në mes të shënjesave të cilat ndikuan gjerësisht në zbukurimoren shqiptare veçanërisht në atë shkodrane dallohet motivi i helikës të cilin fillimisht e gjetëm në një banesë të vjetër, të rindërtuar në prag të shekullit XIX nga punishtja e mjeshtrit Jashar Xhafa[27]. Tavani i njerës nga kthinat ka trajtën e yllit me tetë cepa në mesin e të cilëve janë mbërthyer tetë trekëndësha të daltuar me drethka, në qendër gjendet rozeta rrethore e zbukuruar me bisqe shtjellëse, ndërsa në të katër këndet ndodhen trekëndësha të zbukuruar. Mbi njërin nga trekëndëshat e yllit janë skalitur dy bisqe të dredhura të kundërvëna që paraqesin helika me nga tri gjethe shtjellëse në kahe të ndryshme, të cilat sillen rrotull dy burbuqeve. Në mes tyre renditen tri gjethe lisi ndën të cilat duket lule zhabina e zambaku me tri gjethe të shoqëruara anash me drethka e burbuqe të rrethuara me bedena të dhëmbëzuara (fig. 26). Krahas tavanit në kthinë gjenden një trapazan i daltuar me pesë harqe sipër e katër poshtë, dy rafte murore, dy dyer me motive popullore dhe tymtari i plazmuar në stuk të bardhë.

Shenja e helikës gjendet mbi tavanet, raftet shtresambajtëse, trapazanet dhe orenditë e lëvizëshme me dy e më shumë fletë që u daltuan në Shkodër prej mjeshtrave dibranë, dhe shoqërohet me lajle sipas mënyrës së secilit mjeshtër.



Fig. 28

27) Banesa gjendet në rrugën «Shyqyri Bushati» Nr. 21. Në krahun e majtë të banesës ndodhen mjedise të zbukuruara sipas mënyrës së shekullit XVIII.

DO NOT COPY



Fig. 29



Fig. 30



Fig. 31



Fig. 32



Fig. 33



Fig. 34

DO NOT COPY



Fig. 35



Fig. 36



Fig. 37



Fig. 38

Nga mezi i shekullit XIX mjeshtri Isuf Haxhiu me grupin e tij krijoi një numër të madh zbukurimesh me helika qendërmbledhëse (centripetale) dhe jashtahedhëse (centrifugale). Në një banesë të datuar nga mbishkrimi i pamjes kryesore në vitin 1866[28], mjeshtri zbatoi një nga brenditë më kureshtare. Zbukurimi i banesës është kryer njëkohësisht me ndërtimin. Brendia e saj është pasuruar me tavan të daltuar me katër trekëndësha që paraqesin tufëza e helika, një trapazan të lartë, raftin e murit të zbukuruar me poça lulembajtëse dhe një tymtar të derdhur me plazmime allçije që paraqet dy diej mbi krye të shatores. Në njerin nga trekëndëshat mjeshtri ka vizatuar brenda rrethit në mes bisqesh me 9 gjethe shtjellëse që ndrynin lulen e pjeshkës, një helikë të hapur jashtahedhëse të shoqëruar me drethka që kufizoheshin nga tri rreshta bedenash, litartha e sharrëza. (Fig. 27).

Më tej mjeshtrit e brezit të tretë kryen gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX e fillimit të shekulli XX, rozeta tavanesh me trajta helike në mes të rrathëve bashkëqendrorë të përshkuar me lajle. Nga fundi i shekullit XIX njeri nga mjeshtrat e grupit të Sulejman Metanit daltoi shtjellësen më të fuqishme në një rozetë tetëkëndore të qarkuar me bedena, ku lëviznin 22 gjethe lisi të thelluara me vlloja e dhëmbëza që nguliteshin mbi kufizën e rrethit.[29] (fig. 28).

Shenja e helikës lidhej ngushtë me besimin e diellit, të hyjve e qiellit në tërësi. Për të parën herë ajo u pikturua dhe u vizatua mbi qeramikën neoli-

28) Banesa Nr. 9 e rrugës «11 Janari».
29) Banesa Nr. 5 në rrugën Musa Luli. Zbukurimi është i njëkohëshëm me ndërtimin e banesës.

NDREQJE GABIMESH

Faqe	Kollona	Rreshti	Si është shkruar	Si duhet të lexohet
70	II	10	Zhulliri	Shulliri
71	I	5	Pllashunjës	Pllashnjës
71	I	30	Gjënakotës	Gjonakatës
72	II	18	Qerabashit	Qeribashit
95	I	14	baha	baxha
107	Citimi 14		Makedonaska	Makedonska
109	I	2	Sverdelli	Svordelli
109	II	16	trashëgimtare	trashëgimore
114	II	10	përshkruara	përshkuara
114	Citimi 24		centuryjale	century jale
121	Fig/51	është vendosur së	prapthi	
122	I	3	një buzë	një buzëm
144		2	deri në vitin 1972	deri në vitin 1912
144		37	Drishti, T. Riza E.	Drishti, T. Riza.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Çmimi 10 lekë